# DOKUMENTAT STANDARDE TË TENDERIT PËR

# PROCEDURËN E KUFIZUAR MBI KUFIRIN E LARTE MONETAR

# SHËRBIME[1]

**OBJEKTI: "SHËRBIM LAVANDERIE", NDARË NË 2 LOTE**

**Loti 1:** "Shërbim i lavanderisë për pacientët e hospitalizuar në Spitalin Rajonal "Memorial", Fier"

**Loti 2:** "Shërbim i lavanderisë dhe hotelerisë në Spitalin Rajonal Fier

[1] Në rastet e mosparashikimeve konkrete në këtë set dokumentash, Autoriteti/Enti kontraktor do t'i referohet parashikimeve të legjislacionit dhe rregullave të prokurimit publik në fuqi.

## NJOFTIME

### NJOFTIMI PARAPRAK I INFORMACIONIT/ NJOFTIMI PERIDIOK I INFORMACIONIT

*(Për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor nëse aplikohet)*

**1.1 Emri dhe adresa e Autoritetit/Entit Kontraktor**;

Emri ______________________________________________

Adresa ______________________________________________

1.2 **Lloji i Autoritetit/Entit Kontraktor:**

| | |
|---|---|
| Institucion qendror ☐ | Institucioni i pavarur ☐ |
| Njësi e autoriteteve vendore ☐ | Të tjera ☐ |

1.3 **Kategoria e Autoritetit/Entit Kontraktor:**

| | |
|---|---|
| Autoritet/ent kontraktor që prokuron për nevoja të veta ☐ | Organ Qendror blerës ☐ |
| I deleguar ☐ | Të tjera ☐ |

**1.4 Emri dhe adresa e personit të kontaktit**:

Personi (at) përgjegjës për prokurimin: ____________________________________________
Tel/faks ______________________________________________________________________
E-mail ______________________________________________________________________

**1.5 Objekti i kontratës/marrëveshjes kuadër dhe kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP):**
______________________________________________________________________________

**1.6 Lloji i procedurës së prokurimit:** ___________________________

**1.7 Tipi i kontratës**:__________________________________________

**1.8 Fondi limit i përllogaritur për këtë kontratë/marrëveshje kuadër/Fondi limit i përllogaritur për këtë objekt siç është planifikuar në parashikimin buxhetor të Autoritetit/Entit Kontraktor**
(*në rastin e marrëveshjeve kuadër ose kontratave shumëvjecare*) :
____________________________________________________________________

**1.9 Kohëzgjatja e përafërt e kontratës/marrëveshjes kuadër :**_________________________________

**1.10 Përshkrimi i shkurtër i kontratës/marrëveshjes kuadër dhe/ose Lotit (eve), nëse përdoren:**

______________________________________________________________________________

______________________________________________________________________________

**1.11. Lloji i Marrëveshjes Kuadër, nëse është rasti:**

______________________________________________________________

**1.12 Kohën e përafërt për zhvillimin e procedurës së prokurimit:**

__________________________________________________________

**1.13 Informacion tjetër që konsiderohet i dobishëm nga autoriteti/enti kontraktor:**_____________________________________________________________

_________________________________________________________

**Shënim:**

**Nëse ky njoftim paraprak i informacionit përdoret si një ftesë për ofertë, është i nevojshëm informacioni i mëposhtëm:**

**1.12 Përshkrimi specifik i shërbimeve që do të jenë objekt i kontratës**

_____________________________________________________

______________________________________________________________________________

______________________________________________________________________________

**1.13 Të përcaktohet nëse kontrata do të jepet përmes procedurës së kufizuar, pa shpallje të mëtejshme të një thirrje për oferta dhe operatorët e interesuar ekonomikë janë të ftuar të shprehin interesin e tyre.**

_____________________________________________

*(Për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor )*

## NJOFTIMI I KONTRATËS

### Seksioni 1: Autoriteti/Enti Kontraktor

### 1.1 Emri dhe adresa e Autoritetit/Entit Kontraktor

| | |
|---|---|
| Emri: | Operatori i Blerjeve te Perqendruara |
| Adresa: | Blv. "Dëshmorët e Kombit", Nd. 3, 1001, Tiranë |
| Tel/Faks: | |
| E-mail: | info@obp.al |
| Adresa e ueb-faqes: | www.opb.al |
| Personi/at përgjegjës për prokurimin: (emri, e-mail) | Irena Bendo<br>irena.bendo@obp.al |

### 1.2 Lloji i Autoritetit/Entit Kontraktor:

Institucion qendror

Institucioni i pavarur ☐

Njësi e autoriteteve vendore ☐

Të tjera x

### 1.3 Kategoria e Autoritetit/Entit Kontraktor:

Autoritet/Ent kontraktor që prokuron për nevoja të veta ☐

Organ Qendror blerës X

I deleguar ☐

Të tjera ☐

**1.4. Kontratë në bazë të një marrëveshje të posaçme midis Shqipërisë dhe një shteti tjetër:**

**Po** ☐ **Jo** **X**

**1.5 Kontratë që bashkëfinancohet nga një organizatë ndërkombëtare ose një institucion financiar ndërkombëtar:**

**Po** ☐ **Jo** **X**

**1.6 Kontratë e rezervuar :**

**Po** ☐ **Jo** **X**

## Seksioni 2: Objekti i Kontratës: "Shërbim Lavanderie", ndarë në 2 Lote

**2.1 Numri i referencës së procedurës: REF-10329-06-20-2024**

**Numri refrences Loti 1 : REF-10332-06-20-2024**

**Numri refrences Loti 2 : REF-10334-06-20-2024**

**2.2 Kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (CPV): 42716000-8**

**2.3 Lloji i "Kontratës Publike për Shërbime"**

**2.4 Kontrata në bazë të Marrëveshjes Kuadër:**

Po X Jo ☐

**2. 5 Lloji i Marrëveshjes Kuadër:**

**Me një Operator Ekonomik** ☐

**Me disa Operatorë Ekonomikë** **X**

**Të gjitha kushtet janë të përcaktuara** Po **X** Jo ☐

**2.6 Marrëveshje kuadër me një operator ekonomik:**

Në rastin e Marrëveshjes Kuadër me një Operator Ekonomik, kur janë përcaktuar të gjitha kushtet, më poshtë të jepen arsyet e përzgjedhjes

- Në zbatim të nenit 52/4 të ligjit nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", në nenin 64 të VKM-së nr.285 datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", përcaktohet se: *"Kontratat e bazuara në marrëveshjet kuadër të lidhura me disa operatorë ekonomikë, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, duhet të akordohen brenda kufijve dhe kushteve të parashikuara në marrëveshjen kuadër. Meqenëse këto marrëveshje kuadër vlerësohen si kontrata, nuk lejohet të bëhen ndryshime të kushteve të tyre, pasi kjo do të konsiderohej shkelje e kontratës. Nëse nevojat e autoritetit kontraktor ndryshojnë, atëherë autoriteti kontraktor duhet të prokurojë një marrëveshje kuadër të re"*
- kushtet.

Bazuar në pikën 11 germa i) të VKM 531 date 07.09.2023 "Për Krijimin, krijimin e Shoqerise Aksionare Shteterore "Operatori i Blerjeve te Perqendruara" SH.A. për kryerjen e procedurave të veçanta të Prokurimit Publik, në emër dhe për llogari të Kryeministrisë, Ministrive dhe Institucioneve të Varësisë", ku përcaktohet se: *"Operatori i Blerjeve te Perqendruara, si organ qendror blerës, zhvillon procedurat në fushën e prokurimit të mallrave, shërbimeve dhe puneve, si më poshtë vijon:… "i" sherbim lavanderie*

**2.7 Marrëveshje Kudër me disa operatorë ekonomikë:**

**Numri i operatorëve ekonomikë, me të cilët do të lidhet Marrëveshja Kuadër:** 1 (një) Operator Ekonomik, per secilin lot.

**2.8 Kushtet që duhet të zbatohen në rastin e rihapjes së konkurrimit:**

| | |
|---|---|
| Kushtet që do zbatohen në rastin e rihapjes së konkurimit dhe/ose përdorimi i mundshëm i blerjes elektronike | Nuk do të ketë rihapje të konkursit.<br>Kontrata/ kontratat do të lidhen sipas kerkesave te Autoritetit Kontraktor të përcaktuara në pikën 2.9 të DT, me operatorin ekonomik të suksesshëm.<br>Dhënia e kontratës/ kontratave do të behet nga Autoriteti Kontraktor i përcaktuar në pikën 2.9 të DT.<br>Marrëveshja kuadër do të zbatohet me dërgimin e ftesave për ofertë tek operatori ekonomik, palë në marrëveshjen kuadër.<br>Ne rast te lindjes se nevojes konkrete per te lidhur nje kontrate brenda marrëveshjes kuader, autoriteti kontraktor duhet që të dërgojë “ftesën për ofertë” tek kontraktuesi, duke specifikuar listën me sasitë përkatëse të artikujve.<br>Autoriteti kontraktor i kerkon operatorit ekonomik fitues, te japë oferten e tij.<br>Komunikimi ndërmjet autoritetit kontraktor dhe operatorit ekonomik, behet ne forme te shkruar ose elektronike (email, fax, etj.) dhe ne çdo rast duhet te dokumentohet dhe te behet pjese e dosjes se procedures.<br>Sasitë e parashikuara dhe të kerkuara janë vetëm sasi orientuese dhe NUK e kushtëzojnë Autoritetin Kontraktor për t’i blerë ato. |

**2.9 Autoriteti Kontraktor/Autoritetet kontraktore ose Enti/Entet kontraktore që do të jenë palë në Marrëveshjen Kuadër:** Organi Qendror Blerës, Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Perqendruara në emër dhe për llogari të autoriteteve kontraktore si vijon:

- Spitali Rajonal “Memorial”, Fier;

- Spitali Rajonal Fier;

**2.10 Përshkrimi i shkurtër i kontratës / Marrëveshjes Kuadër**

1. Fondi limit/vlera e pritshme e kontratës: : 237,781,000 (dyqind e tridhjetë e shtatë milion e shtatëqind e tetëdhjetë e një mijë) lekë pa Tvsh **Ose 2,370,934.29 (dy milion e treqind e shtatedhjete mije e nenteqind e tridhjete e kater pike njezet e nente)** Euro pa tvsh.
2. Në rastin kur, objekti i prokurimit përbëhet nga disa shërbime, **shumatorja e çmimeve për njësi është: Nuk Aplikohet.**

3. Burimi i financimit: **Buxheti i Shtetit.**

4. Kodi Output: 1234567

5. Tipi:

| | | |
|---|---|---|
| Investime ☐ | Kodi: ______ | Vlera: _____ |
| Shërbime X | Kodi: 602 | Vlera: **: 237,781,000** |

**2.11 Kohëzgjatja e kontratës ose afati i zbatimit të kontratës:**

Kohëzgjatja **në muaj □□□ ose ditë □□□**

Ose

Fillon më □□/□□/□□□□ mbaron më □□/□□/□□□□

**2.11.1. Kohëzgjatja e Marrëveshjes Kuadër:**

| |
|---|
| **Kohëzgjatja në muaj: (nga nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër)**<br><br>**Loti 1 - 24 (njëzet e katër) Muaj (nga nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër)**<br><br>**Loti 2 - 36 (tridhjete e gjashte) Muaj (nga nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër)** |

**2.12 Vendi i kryerjes së shërbimeve :**

**Loti 1 në ambjentet e Spitalit Rajonal "Memorial" Fier;**

**Loti 2 në ambjentet e Spitalit Rajonal, Fier;**

**2.13 Ndarja në Lote:**

**Po** **X** **Jo** □

*Nëse po,*

**2.14 Përshkrimi i shkurtër i Loteve:**

Shërbim i lavanderisë për pacientët e hospitalizuar në Spitalin Rajonal "Memorial", Fier", me afat të marrëveshjes kuadër 24 (njëzet e katër) muaj, me fond limit të marrëveshjes kuadër**: 84 109 000** (tetëdhjetë e katër milion e njëqind e nëntë mijë) **lekë pa TVSH** ose **838,657.89 (teteqind e tridhjete e tete mije e gjashteqind e pesedhjete e shtate pike tetedhjete e nente) Euro (pa TVSH);**

**Loti 2 me objekt:** ""Shërbim i lavanderisë dhe hotelerisë në Spitalin Rajonal Fier", me afat të marrëveshjes kuadër 36 (tridhjetë e gjashtë) muaj, me fond limit të marrëveshjes kuadër: 153 672 000 (njëqind e pesëdhjete e tre milion e gjashtëqind e shtatëdhjetë e dy mijë) **lekë pa TVSH** ose **1,532,276.39 (nje milion e peseqind e tridhjete e dy mije e dyqind e shtatedhjete e gjashte pike tridhjete e nente) Euro (pa TVSH);**

**2.14.1 Një ofertues mund të aplikojë për:**

□ një Lot,

□ disa Lote,

**X** të gjitha Lotet.

Për secilin Lot duhet të paraqitet një ofertë e veçantë.

**2.14.2 Numri maksimal i Loteve për ofertues:**

Specifikoni numrin maksimal të Loteve që mund t'i jepen një ofertuesi __________

**2.14.3 Kriteret/rregullat që duhet të zbatohen për të përcaktuar Lotet që do t'i jepen ofertuesit:**

Specifikoni kriteret për të përcaktuar Lotet që do të jepen, kur ofertuesi shpallet fitues i më shumë Loteve sesa numri maksimal i lejuar në pikën 2.14.2.

***<u>Shënim:</u>*** *Operatori ekonomik ofertues në më shumë se një Lot, duhet të ketë kapacitetet ekonomike – financiare (nënpika 1 e seksionit 2.2, të kritereve të veçanta për kualifikim) si dhe kapacitetet teknike (nënpikat 1 dhe germa c), e pikes 4 të seksionit 2.3, të kritereve të veçanta për kualifikim), sa shuma e loteve për të cilat ka ofertuar, të marra së bashku. Në këtë rast, operatori ekonomik ofertues në më shumë se një Lot, duhet të paraqesë një deklaratë ku të listohen dokumentet e paraqitura në përmbushje të kritereve kumulative për Lotin konkret. Në rast se dokumentacioni i deklaruar dhe i dorëzuar në përmbushje të kritereve kumulative nuk plotëson kapacitetet ekonomike - financiare dhe kapacitetet teknike për të gjitha Lotet ku operatori ekonomik ka ofertuar, do të kualifikohet vetëm në atë Lot ku oferta e tij është ekonomikisht më e favorshme.*

**2.14.4 Kombinimi i Loteve në një kontratë/kontrata të përbashkëta (Kur të njëjtit ofertues mund t'i jepet më shumë se një Lot):**

**Po** □ **Jo** □

Nëse po, specifikoni grupin e Loteve që mund të kombinohen

______________________________________________________________________________

______________________________________________________________________________

**2.15 Pranohen variantet:**

**Po** □ **Jo** **X**

**2.15.1 Pranohet nënkontraktimi:**

**Po** □ **Jo** **X**

**Nëse lejohet nënkontraktimi, specifikoni përqindjen e lejuar për nënkontraktim:**
*(nuk lejohet nënkontraktimi në një masë më të madhe se 50 % e vlerës së kontratës)*
______________________________________________________________________________

**2.15.2 Autoriteti/Enti Kontraktor do të kryejë pagesa direkte tek nënkontraktori:**

**Po** □ **Jo** **X**

**Shënime të tjera** *(nëse vlerësohen të nevojshme nga autoriteti/enti kontraktor)*

_______________________________________________________________________________

________________________________________________________________________

**2.16. Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera:**

**Po** □ **Jo** **X**

Specifikoni nëse autoriteti/ enti kontraktor kërkon që detyra/punë/aspektet kritike të kontratës të përmbushen nga vetë operatori ekonomik ose nga ndonjë prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve ekonomikë, për të cilin ofertuesi nuk lejohet të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera.

**Nëse po, të specifikohet detyra, puna, aspekte kritike, që nuk lejohet mbështetja:**

_________________________________________________________________

**2.17 Gjatë procesit të prokurimit në fushën e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK) përdoren standardet e përgatitura nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit:**

**Po** □ **Jo** **X**

**2.18. Gjatë procesit të prokurimit në fushën e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK), në rast se standardet nuk janë të zbatueshme, merret një miratim paraprak nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit:**

**Po** □ **Jo** **X**

**Seksioni 3:Informacione juridike, ekonomike, financiare dhe teknike**

**3.1 Sigurimi i ofertës:** (*e zbatueshme në rastin e procedurave të prokurimit me një vlerë më të lartë se sa prokurimi me vlerë të vogël).*

Në rastin e kontratave sektoriale, enti kontraktor, në bazë të diskrecionit të tij, mund të kërkojë sigurimin e ofertës edhe për procedurat nën kufirin e lartë monetar.

Operatori Ekonomik paraqet Formularin e Sigurimit të Ofertës, sipas Shtojcës 5.

Shuma e kërkuar e sigurimit të ofertës është 4,755,620 (kater milion e shtateqind e pesedhjete e pese mije e gjashteqind e njezet) Lekë pa TVSH, ose 47,418.68 **(dyzet e shtate mije e katerqind e tetembedhjete pike gjashtedhjete e tete) Euro.**

Në rastet e paraqitjes së ofertave për Lote të veçanta, vlera e sigurimit të ofertës për secilin Lot do të jetë si më poshtë:

Shuma e Sigurimit të ofertës për **Lotin 1** është: 1,682,180 (një milion e gjashtëqind e tetëdhjetë e dy mijë e njëqind e tetëdhjetë) Lekë ose 16,773.15 (gjashtembëdhjetë mijë e shtateqind e shtatedhjete e tre pike pesembedhjete) Euro;
Shuma e Sigurimit të ofertës për **Lotin 2** është: 3,073,440 (tre milion e shtatedhjete e tre mije e katerqind e dyzet) Lekë pa TVSH, ose 30,645.52 (tridhjete mije e gjashteqind e dyzet e pese pike pesedhjete e dy) Euro;

**3.1.2** Autoriteti/ enti kontraktor pranon vlerën e pagesës së sigurimit të ofertës nga ofertuesi, në vlerë monetare në llogarinë e autoritetit/entit kontraktor :

Credins Bank
SWIFT:CDISALTRXXX
NR.LLOGARIE: 00002032030

**3.1.3** Autoriteti/enti kontraktor pranon pagesën e vlerës së sigurimit të ofertës nga ofertuesi edhe në formën:

i. garancisë bankare X
ose
ii. nga shoqëri sigurimi të licencuara nga autoritetet kompetente□

**3.2 Periudha e vlefshmërisë së ofertës: 150** *(shprehur në ditë)*

**Seksioni 4: Procedura**

**4.1 Lloji i procedurës:** E Kufizuar mbi kufirin e lartë monetar

**4.2. Është përdorur njoftimi paraprak / periodik i informacionit:**

**Po** □ **Jo** **X**

Nëse Po, numri i referencës është ______________________

**4.2.1.Aplikohet shkurtimi i afatit për pranimin e ofertave** *(e aplikueshme për procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar).*

**Po** **X** **Jo** □

**4.3 Procedurë e rishpallur:**

**Po** **X** **Jo** □

Nëse është një procedurë e rishpallur, ju lutemi plotësoni të dhënat identifikuese të procedurës së anuluar:

a) Numri i referencës në sistemin e prokurimit elektronik të procedurës së anuluar të prokurimit : **REF-** REF-92513-12-29-2023

b) Objekti i prokurimit të procedurës së anuluar të prokurimit **: "Shërbim Lavanderie Për Spitalin Rajonal Memorial, Fier"**

c) Fondi limit i procedurës së anuluar të prokurimit: 84,109,000 **(tetedhejte e kater milion e njeqind e nente mije) Lekë (pa TVSH), ose 811,471** (teteqind e njembedhjete mije e katerqind e shtatedhjete e nje) Euro **pa TVSH.**

**4.4 Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:**

A) **Oferta ekonomikisht më e favorshme, bazuar në kosto** □

Sipas rëndësisë:

çmimi □ pikët□□

_______□□ pikët □□

_______ □ □ pikët □□

_______ □□ pikët □□

Autoriteti/ Enti Kontraktor duhet të specifikojë pikët për secilin kriter të përcaktuar të vlerësimit.

**OSE**

B) **oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim X**

**Në rastin e marrëveshjes kuader, kur do të përdoret kriteri i vlerësimit të çmimit për njësi, për qëllime krahasimi, vlerësimi i ofertave të paraqitura do të bëhet në bazë të shumatores së çmimeve për njësi** (*Kjo, metodë vlerësimi nuk do të përdoret nga autoritetet/entet kontraktore kur sasitë janë të llogaritshme në bazë vjetore, sipas eksperiencës së mëparshme, dhe kur marrëveshja kuadër përdoret për prokurimin e mallrave dhe shërbimeve të vazhdueshme. Në këtë rast, çmimi i ulët do të vlerësohet me vlerën totale më të ulët të ofruar).*

**4.4 Ulja e numrit të kandidatëve të kualifikuar që do të ftohen**

**4.4.1 Do të aplikohet ulja e numrit të kandidatëve të kualifikuar që do të ftohen:**

| | | | |
|---|---|---|---|
| **Po** | □ | **Jo** | **X** |

Nëse Po:

Numri minimal i kandidatëve që do të ftohen është: ___________________

Numri maksimal i kandidatëve që do të ftohen është (sipas rastit): ___________________

**4.4.2 Kriteret dhe rregullat që do të zbatohen për uljen e numrit të kandidatëve:**

___________________________________________________________________________

___________________________________________________________________________

___________________________________________________________________________

___________________________________________________________________________

**4.5 Afati i fundit për paraqitjen dhe hapjen e ofertave:**

Data: 22/07/**2024***(d/m/v)* **ora 11:00**

Vendi: www.app.gov.al , Operatori i Blerjeve te Perqendruara.

**Kur oferta kërkohet të paraqitet në mënyrë elektronike, ofertuesit duhet ta paraqesin atë në mënyrë elektronike në faqen zyrtare të APP, www.app.gov.al.**

**Informacioni mbi ofertat e paraqitura në mënyrë elektronike i transmetohet të gjithë atyre Operatorëve Ekonomikë që kanë paraqitur oferta, me kërkesë të tyre.**

**4.6 Gjuha (ët) në të cilat mund të hartohen ofertat:**

| | | | |
|---|---|---|---|
| **Shqip** | **X** | **Anglisht** | **X** |

**Seksioni 5: Informacione shtesë:**

**5.1 Dokumente me pagesë** *(zbatohet vetëm për procedurat që nuk zhvillohen me mjete elektronike):*

**Po** ☐ **Jo** **X**

*Nëse po*

**Monedha** _________ **Çmimi** _______

Ky çmim mbulon kostot aktuale të kopjimit dhe shpërndarjes së Dokumenteve të Tenderit (DT) tek Operatorët Ekonomikë. Operatorët Ekonomikë të interesuar kanë të drejtë të konsultojnë DT përpara blerjes së tyre.

**5.2 Informacione shtesë (vendi, zyra, mënyra e blerjes së dokumenteve të tenderit (**kur është e aplikueshme)

**Operatori ekonomik fitues, për nënshkrimin e një kontrate publike duhet të ketë:**

- Kopje të Certifikatës Elektronike të Fiskalizimit, për tatimpaguesit që përdorin Platformën Qendrore të Faturave.
- Kopje të Certifikatës Elektronike të Fiskalizimit dhe kopje të vlefshme të kontratës së lidhur me Kompaninë e Çertifikuar për zgjidhjen softuerike në përdorim, për tatimpaguesit që lëshojnë fatura përmes zgjidhjes softuerike.

Data e dorëzimit të këtij njoftimi **20/06/2024**

[*Për t'u plotësuar nga Autoriteti /Enti Kontraktor*]

**FTESË PËR SHPREHJE INTERESI**

**Procedura e Prokurimit**: ______________________________

(*shënoni emrin e Autoritetit /Entit Kontraktor*) fton për paraqitjen e kërkesave për pjesëmarrje në procedurën për kryerjen e shërbimeve  në vijim:

……………………………………………………………………………………………………………
……………………………………………………………………………………………………………
…………………………………………………………………………………

(jepni një përshkrim të saktë të shërbimeve të kërkuara)

**Kërkesat për pjesëmarrje duhet të paraqiten në:**
*[jepni adresën e saktë*]

**Afati i fundit për paraqitjen dhe hapjen e kërkesave për pjesëmarrje:**

[Përcaktoni datën dhe orën]

[*Për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor në Marrëveshjen Kuadër në rihapjen e procesit të mini-konkurrimit*]

# FTESË PËR OFERTË

(*Shënoni emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor*) fton për paraqitjen e ofertave në procedurën për kryerjen e shërbimeve në vijim:

…………………………………………………………………………………………………………………
…………………………………………………………………………………………………………………
……………………………………………………………………………………

(jepni një përshkrim të saktë të shërbimeve dhe sasisë konkrete të kërkuar:

**Vendi i kryerjes së shërbimit**: (jepni një përshkrim të shkurtër*)*____________________

**Koha e realizimit tëshërbimit/eve**: Shërbimi duhet të realizohet ____________

**Ofertat duhet të paraqiten në:**
………………………………………………………………………………………*[jepni adresën e saktë*]

**Afati i fundit për pranimin e ofertave:**

……………………………………………………………………………………………………

**[Përcaktoni datën dhe orën]**

Kriteret për përcaktimin e ofertës fituese ________________________________________

Forma e komunikimit:

Forma shkresore□ Forma elektronike (e-mail, faks, etj.) □

**NJOFTIMI I SHKURTUAR I KONTRATËS**

*(Për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor, për publikim në Buletinin e Njoftimeve Publike)*

**1. Emri dhe adresa e Autoritetit/Entit Kontraktor:**

Emri Operatori i Blerjeve te Perqendruara
Adresa: Blv. "Dëshmorët e Kombit", Nd. 3, 1001, Tiranë
Tel/Faks:
E-mail info@obp.al
Ueb-faqe www.obp.al

**2. Lloji i procedurës së prokurimit: "Procedurë e Kufizuar mbi kufirin e lartë monetar"- Marrëveshje kuadër me disa operatorë ekonomikë, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara.**

**3. Numri i referencës së procedurës: REF-10329-06-20-2024**

**Numri refrences Loti 1 : REF-10332-06-20-2024**

**Numri refrences Loti 2 : REF-10334-06-20-2024**

**4. Objekti i kontratës / Marrëveshjes Kuadër: "Shërbim lavanderie", ndarë në 2 (dy) Lote si më poshtë:**

**Loti 1 me objekt: "Shërbim i Lavanderisë për pacientët e hospitalizuar në pavionet e Spitalit Memorial Fier";**

**Loti 2 me objekt: "Sherbimi i Lavanderisë dhe Hotelerisë për Spitalin Rajonal Fier"**.

**5. Fondi limit**: 237,781,000 (dyqind e tridhjetë e shtatë milion e shtatëqind e tetëdhjetë e një mijë) **Lekë (pa TVSH) Ose 2,370,934.29 (dy milion e treqind e shtatedhjete mije e nenteqind e tridhjete e kater pike njezet e nente)** Euro pa tvsh.

- **Loti 1 me objekt: "Shërbim i Lavanderisë për pacientët e hospitalizuar në pavionet e Spitalit Memorial Fier"**, me fond të marrëveshjes kuadër, në vlerën prej: **84,109,000 (tetëdhjetë e katër milion e njëqind e nëntë mijë) Lekë (pa TVSH)** ose **838,657.89 (teteqind e tridhjete e tete mije e gjashteqind e pesedhjete e shtate pike tetedhjete e nente)** **Euro (pa TVSH);**

- **Loti 2 me objekt: "Sherbimi i Lavanderisë dhe Hotelerisë për Spitalin Rajonal Fier"**, me fond të marrëveshjes kuadër, në vlerën prej: 153 672 000 (njëqind e pesëdhjete e tre milion e gjashtëqind e shtatëdhjetë e dy mijë) **leke pa TVSH ose 1,532,276.39 (nje milion e peseqind e tridhjete e dy mije e dyqind e shtatedhjete e gjashte pike tridhjete e nente)** **Euro (pa TVSH);**

**6. Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose afati për zbatimin e saj:**

**Për Lotin 1:** Do të jetë nga momenti i nënshkrimit te kontratës/kontratave, sipas kërkesës se Autoritetit Kontraktor, brenda afatit 24 (njëzet e katër) muaj sipas Marrëveshjes Kuadër.

**Për Lotin 2:** Do të jetë nga momenti i nënshkrimit te kontratës/kontratave, sipas kërkesës se Autoritetit Kontraktor, brenda afatit 36 (tridhjete e gjashte) muaj sipas Marrëveshjes Kuadër.

**7. Afati i fundit për paraqitjen dhe hapjen e ofertave: 22/07/2024 Ora:11:00**

[*Për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor në Marrëveshjen Kuadër*]

**PLANIFIKIMI I**

**KONTRATAVE NË MARRËVESHJEN KUADËR**

☐ Shërbime:

Numri i përafërt i kontratave të planifikuara për t'u dhënë në bazë të Marrëveshjes Kuadër _____

| **Numri i kontratës** | **Titulli i kontratës** | **Përshkrimi i shkurtër i kontratës** |
|---|---|---|
| **01** | __________ | _______________ |
| **02** | __________ | _______________ |
| **03** | __________ | _______________ |
| **…** | __________ | _______________ |

Shënim: *Ky planifikim është i përafërt bazuar në nevojat që mund të ketë autoriteti/enti kontraktor dhe orientues për palët në proces.*

(*Për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor* )

**NJOFTIMI PËR NDRYSHIMIN E DOKUMENTAVE TË TENDERIT**

1. **Emri dhe adresa e Autoritetit/Entit Kontraktor**

Emri ____________________________________________

Adresa ____________________________________________

Tel/Faks____________________________________________

E-mail ____________________________________________

Ueb-faqe____________________________________________

2. **Kontaktet e personit (ave) përgjegjës për prokurimin:**

Emri ____________________________________________

E-mail ____________________________________________

**3. Lloji i procedurës së prokurimit: _________________________**

**4. Lloji i kontratës /Marrëveshjes Kuadër: ___________________**

**5. Numri i referencës për procedurën / Lotin:__________________**

**6. Objekti i kontratës / Marrëveshjes Kuadër: _________________**

**7. Kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP):_________**

**8. Fondi limit :_____________________________________________**

**9. Justifikimi, argumentet përkatëse dhe referencat ligjore për nevojën e ndryshimit të dokumenteve të tenderit:**

**______________________________________________________________________________________**

**______________________________________________________________________________________**

**10. Nëse shtyhet afati i fundit për pranimin e ofertave, të shënohet afati i ri i përcaktuar:___________**

**Shënim:**

**Këtij njoftimi duhet t'i bashkëngjitet shtojca e ndryshimeve në dokumentet e tenderit.**

*(Për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)*

**NJOFTIMI PËR MODIFIKIMIN E MARRËVESHJES KUADËR/KONTRATËS GJATË ZBATIMIT**

**1. Emri dhe adresa e Autoritetit/Entit Kontraktor:**

Emri ____________________________________________

Adresa ____________________________________________

Tel/Faks____________________________________________

E-mail ____________________________________________

Ueb-faqe____________________________________________

**2. Kontaktet e personit (ave) përgjegjës për prokurimin:**

Emri ____________________________________________

E-mail ____________________________________________

**3. Lloji i procedurës së prokurimit:** ______________________________

**4. Lloji i kontratës /Marrëveshjes kuadër:**______________________________

**5. Numri i referencës për procedurën / Lotin:**_________________________

**6. Objekti i kontratës / Marrëveshjes Kuadër :**_______________________

**7. Kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP):**_______________

**8. Fondi limit:** ____________________________________________

**9. Situata sipas parashikimeve të nenit 127 të LPP dhe argumentet përkatëse për ta përdorur atë:**

______________________________________________________________________________________

______________________________________________________________________________________

______________________________________

**10. Përshkrimi i modifikimit të kontratës/Marrëveshjes Kuadër, përfshirë natyrën dhe sasinë ose vlerën e shërbimeve:**

______________________________________________________________________________________

______________________________________________________________________________________

___________________________________________________________________________________

**11.Vlera totale e kontratës së nënshkruar/marrëveshjes kuadër:** ______________________________

**12. Vlera e ndryshuar (nëse është rasti):**______________________________________

**13. Kohëzgjatja e kontratës / Marrëveshjes Kuadër:** ________________________

**Dhe afati i ri (nëse është rasti):** ____________________________

**14. Emri dhe adresa e operatorit/ëve Ekonomikë:**

Emri____________________________

NIPT: ________________________

Adresa ___________________________

Kontaktet __________________________

**15. Data e nënshkrimit të modifikimit :**______________________

**16. Burimi i financimit:** ________________________________

**17. Informacion tjetër që vlerësohet i nevojshëm nga autoriteti/enti kontraktor**_______________________________________________________________________________
_________________________________________________________________________________

# DOKUMENTET E TENDERIT

**Përmbajtja:**

**Seksioni I:** **<u>Udhëzime për Operatorët Ekonomikë (Udhëzime)</u>**

Teksti në Seksionin I nuk mund të modifikohet nga Autoriteti/Enti kontraktor ose operatorët ekonomikë, përveç informacionit të plotësuar sipas Njoftimit te Kontratës.

**Seksioni II:** **<u>Shtojcat</u>**

Seksioni II përfshin Shtojcat, të cilët duhet të plotësohen nga Operatori Ekonomik dhe të paraqiten si pjesë e Kerkeses per pjesemarrje dhe /ose ofertës së tij, si dhe Shtojcat që duhet të plotësohen nga autoriteti/enti kontraktor si, specifikimet teknike, kriteret e përzgjedhjes së ofertuesve, shërbimet dhe grafiku i ekzekutimit.

**Seksioni III.** **<u>Termat dhe Kushtet e Kontratës (TKK)</u>**

Seksioni III përmban Kushtet e Përgjithshme dhe të Veçanta që do të zbatohen për të gjitha Kontratat, Formularin e sigurimit të kontratës, si dhe formularë që duhet të nënshkruhen nga të dy palët si, draftet e marrëveshjeve kuadër, sipas llojeve të tyre.

**Seksioni IV:** **Ankimi dhe Njoftimet për mbylljen e procesit**

Seksioni IV përfshin formularët standard që përdoren nga operatorët ekonomikë, në procesin e ankimit pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe njoftimet që duhet të plotësohen nga autoriteti/enti kontraktor në përfundim të procesit të prokurimit.

# Seksioni I: Udhëzime për Operatorët Ekonomikë

## A. TË PËRGJITHSHME

**1. Objekti i prokurimit**

1. Objekti i procedurës së prokurimit, si dhe numri i kontratave (Loteve) dhe objektet e tyre përcaktohen në njoftimin e kontratës.

2. Përveç nëse specifikohet ndryshe më poshtë, përkufizimet dhe interpretimet në këto Dokumente të Tenderit do të jenë sipas përcaktimeve të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) dhe Kushtet e Përgjithshme të Kontratës (KPP).

Kjo procedurë përbëhet nga dy faza kryesore:

**Faza 1 - Parakualifikimi:** Kandidatët do të paraqesin dokumentet e kërkuara në DT. Autoriteti / Enti Kontraktor do të shqyrtojë dokumentet e paraqitura nga Kandidatët dhe do të vlerësojë nëse ky dokumentacion plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

**Faza 2 - Ftesa për oferta**: Autoriteti / Enti Kontraktor i dërgon ftesë për ofertë Kandidatëve të cilët kanë përmbushur kërkesat e parakualifikimit, me anë të së cilës i fton këta Kandidatë të paraqesin një ofertë teknike dhe ekonomike. Ofertat do të rishikohen dhe vlerësohen nga Autoriteti / Enti Kontraktor për të përcaktuar ofertën fituese.

**2 Operatorët Ekonomikë të përshtatshëm**

2.1 Operator Ekonomik është çdo person fizik ose juridik ose ent publik apo grup personash/entesh, sipas Udhëzimeve për Operatorët Ekonomikë (këtu e më tej referuar si "Udhëzimet").

2.2 Në rastin e një bashkimi operatorësh ekonomikë (BOE):

Të gjithë operatorët, anëtarë të këtij bashkimi do të kenë përgjegjësi të përbashkët dhe solidare.

BOE i bashkëlidh Kerkeses per pjesemarrje dhe Ofertës së tij një marrëveshje ndërmjet palëve ku caktohet dhe autorizohet edhe Përfaqësuesi, i cili do të ketë autoritetin të përfaqësojë BOE gjatë procedurës së prokurimit dhe, në rast se BOE shpallet fituese e Kontratës, edhe gjatë zbatimit të Kontratës.

2.3 Operatori Ekonomik duhet të konsultohet me të gjitha udhëzimet, formularët, termat dhe specifikimet në Dokumentet e Tenderit. Mosdhënia nga operatori ekonomik e të gjithë informacionit ose dokumentacionit të kërkuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor në Dokumentet e Tenderit do të çojë në refuzimin e Kerkeses per Pjesemarrje dhe /ose Ofertës.

**3. Sqarimi i Njoftimit të Kontratës dhe Dokumenteve të Tenderit**

3.1 Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për njoftimin e kontratës dhe dokumentet e tenderit nga autoriteti/enti kontraktor, i cili duhet t'i përgjigjet çdo kërkese për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 6 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të kerkeses per pjesemarrje dhe/ose ofertave.

Autoriteti/Enti kontraktor duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e kërkesës për pjesëmarrje/ ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t'ua komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit.

**4. Ndryshimi i Dokumenteve të Tenderit**

4.1 Në çdo kohë para afatit të fundit për paraqitjen e kërkesës për pjesëmarrje/ofertave, Autoriteti/Enti Kontraktor mund t'i ndryshojë Dokumentet e Tenderit duke hartuar një shtojcë, me këto ndryshime.

4.2 Çdo shtojcë do të jetë pjesë e Dokumenteve të Tenderit dhe do të publikohet në të njëjtën mënyrë siç është bërë publikimi i Dokumenteve tëTenderit.

4.3 Nëse ndryshimi i Dokumenteve të Tenderit bëhet në gjysmën e parë të afatit për pranimin e kërkesave për pjesëmarrje, autoriteti apo enti kontraktor mund të zgjasin afatin për pranimin e tyre. Nëse dokumentet e tenderit ndryshohen në gjysmën e dytë të afatit për paraqitjen e kërkesave për pjesëmarrje, autoriteti/enti kontraktor zgjat afatin e fundit për paraqitjen e tyre me të paktën 10 ditë për procedurat mbi kufirin e lartë monetar dhe me të paktën 7 ditë për procedurat nën kufirin e lartë monetar.

## B. PËRGATITJA E KËRKESËS PËR PJESËMARRJE DHE OFERTAVE

**5. Shpenzimet e ofertimit**

Operatori Ekonomik përballon të gjitha shpenzimet që lidhen me përgatitjen dhe paraqitjen e kërkesës për pjesëmarrje/ofertës së tij, dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk ka detyrime apo përgjegjësi për këto shpenzime, pavarësisht nga zhvillimi apo rezultati i procedurës.

**6. Gjuha e Ofertës**

Kërkesa për pjesëmarrje/Oferta, si dhe të gjitha korrespondencat dhe dokumentet në lidhje me procedurën e prokurimit do të paraqiten në gjuhën/gjuhët e specifikuar në njoftimin e kontratës. Dokumentet mbështetëse dhe literatura e printuar që janë pjesë Kërkesës për Pjesëmarrje ose të Ofertës mund të jenë në një gjuhë tjetër me kusht që ato të shoqërohen nga një përkthim zyrtar i fragmenteve përkatëse në gjuhën e specifikuar në njoftimin e kontratës.

**7. Dokumentet përbërëse të Kerkeses per pjesemarrje/ Ofertës**

Kërkesa për pjesëmarrje / Oferta do të përmbajë të gjitha dokumentet mbështetëse siç kërkohet nga Autoriteti/Enti kontraktor.

**8. Formularët e tenderit**

1 Operatori Ekonomik paraqet Formularin e Ofertës Ekonomike në përputhje me formularin e paraqitur në Seksionin II: Të gjithë Formularët shoqërues duhet të plotësohen pa ndonjë ndryshim; nuk do të pranohet asnjë zëvendësues. Të gjitha vendet bosh duhet të plotësohen me informacionin e kërkuar.

2 Për procedurat e prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore, origjinali i kërkesës për pjesëmarrje/ofertës duhet të shtypet ose të shkruhet me bojë që nuk fshihet. Të gjitha fletët e kërkesës për pjesëmarrje/ofertës duhet të lidhen së bashku dhe të numerizohen. Të gjitha fletët e kërkesës për pjesëmarrje /ofertës, përveç literaturës së pandryshueshme dhe të printuar duhet të pajisen me inicialet ose të nënshkruhen nga Personi (at) e Autorizuar. Çdo ndryshim në kërkesën për pjesëmarrje /ofertë duhet të jetë i lexueshëm dhe i nënshkruar nga Personat e Autorizuar.

**9. Ofertat Alternative**

Përveç nëse përshkruhet ndryshe në njoftimin e kontratës dhe dokumentet e tenderit propozimet alternative ose kohët alternative për përfundimin, nuk do të merren parasysh.

**10. Përllogaritja e Ofertës Ekonomike**

1 Çmimet e ofruara nga Operatori Ekonomik në Formularin e Ofertës Ekonomike do të jenë në përputhje me kërkesat e specifikuara në njoftimin e kontratës dhe dokumentet e tenderit.

2 Operatori Ekonomik duhet të plotësojë Formularin e Ofertës Ekonomike bashkangjitur me këto DT, duke përcaktuar shërbimet që do të kryhen dhe çmimin e tyre.

3 Të gjitha çmimet duhet të kuotohen në Monedhën sipas Njoftimit të Kontratës, duke përfshirë edhe tatimet dhe taksat që zbatohen, pa përfshirë TVSH-në. Nëse çmimet kuotohen në valutë të huaj siç përcaktohet në Njoftimin e Kontratës, atëherë ato duhet të konvertohen në Lekë shqiptare (Lekë) sipas kursit të  këmbimit të caktuar nga Banka Qendrore e Shqipërisë në ditën

e dërgimit për publikim të Njoftimit të Kontratës dhe duhet të ruhen në atë kurs deri në skadimin e periudhës së vlefshmërisë së ofertës.

4 Ofertuesi duhet të shënojë në Formularin e Ofertës, çmimet totale të Ofertës për të gjitha Shërbimetpa TVSH. Vlera e TVSH-së, kur aplikohet, i shtohet çmimit të dhënë dhe përbën vlerën totale të Ofertës.

5 Në rastin e një Marrëveshje Kuadër ku NUK përcaktohen të gjitha kushtet, çmimet për kontratat bazuar në Marrëveshjen Kuadër nuk janë të fiksuara, ato janë objekt i ndryshimit pas një mini – konkurrimi midis Operatorëve Ekonomikë, palë në Marrëveshjen Kuadër.

**11. Monedhat**

Monedha (at) e ofertave dhe monedha (at) e pagesës do të jenë siç specifikohet në njoftimin e kontratës.

**12. Periudha e vlefshmërisë së Ofertës**

1 Ofertat do të jenë të vlefshme për periudhën e specifikuar në Njoftimin e Kontrates pas afatit të paraqitjes së Ofertave të përcaktuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor; Oferta për një periudhë më të shkurtër nuk është e vlefshme dhe do të refuzohet.

2 Sigurimi i Ofertës mund të paraqitet në njërën nga format e mëposhtme:

a) Pagesa nga ofertuesi, në vlerë monetare, në llogarinë e autoritetit/entit kontraktor

b) Garanci bankare

c) Garanci sigurimi

Dokumentet e mësipërme duhet të jenë të vlefshme gjatë gjithë periudhës së vlefshmërisë së Ofertës.

3 Periudha e vlefshmërisë së Ofertës fillon nga momenti i hapjes së ofertave. Në çdo rast, të paktën 5 ditë para përfundimit të afatit të vlefshmërisë së ofertave, Autoriteti/Enti Kontraktor mund t'i kërkojë Ofertuesit me shkrim të zgjasë periudhën e vlefshmërisë, deri në një datë të caktuar. Ofertuesi mund ta refuzojë këtë kërkesë me shkrim, pa humbur të drejtën për rimbursim të Sigurimit të Ofertës, kur ka një të tillë. Ofertuesi që bie dakord të zgjasë periudhën e vlefshmërisë së Ofertës njofton Autoritetin/Entin Kontraktor me shkrim dhe paraqet një sigurim oferte të zgjatur, nëse ka pasur një të tillë. Oferta nuk mund të modifikohet. Nëse Ofertuesi nuk i përgjigjet kërkesës së bërë nga Autoriteti/Enti Kontraktor në lidhje me zgjatjen e periudhës së vlefshmërisë së Ofertës, ose nuk e pranon kërkesën në fjalë, ose nuk paraqet një sigurim të zgjatur të ofertës, kur kërkohet, atëherë Autoriteti/Enti Kontraktor e refuzon Ofertën.

4 Nëse autoriteti/enti kontraktor nuk i ka bërë një kërkesë me shkrim operatorit ekonomik për të zgjatur periudhën e vlefshmërisë së ofertës, sipas parashikimit të paragrafit të parë të kësaj pike, atëherë operatori ekonomik nuk mund të penalizohet për këtë, pra sigurimi i ofertës së tij nuk konfiskohet.

**13. Formati dhe Nënshkrimi i Kerkeses per Pjesemarrje dhe Ofertave**

Në përgjigje të Njoftimit të Kontratës, çdo Operator Ekonomik paraqet kërkesën për pjesëmarrje sipas formularëve standard në këtë DT e cila do të nënshkruhet nga personi/at i autorizuar për këtë qëllim. Kur të ftohet nga autoriteti/ enti kontraktor për të paraqitur një ofertë sipas formularëve standard në këtë DT, Oferta do të nënshkruhet nga personi/personat përgjegjës të autorizuar për këtë qëllim.

**14. Konfidencialiteti**

Autoriteti /enti kontraktor duhet të ruajë konfidencialitetin sipas përcaktimeve të nenit 16 të LPP-së

## C. PARAQITJA, HAPJA DHE SHQYRTIMI I KËRKESAVE PËR PJESËMARRJE /OFERTAVE

**14. Kerkesa per Pjesemarrje/Oferta**

1 Operatori ekonomik paraqet kërkesë për pjesëmarrje/ofertën duke përdorur formularet e paraqitur në Seksionin II dhe III. Formularër duhet të plotësohet pa asnjë ndryshim të formatit të tij, dhe nuk do të pranohen zëvendësime. Të gjitha hapësirat boshe do të plotësohen me informacionin e kërkuar.

**15. Dokumente që provojnë kualifikimet e operatorit ekonomik**

Për të provuar kualifikimet e tij për realizimin e Kontratës, Operatori Ekonomik do të japë informacionin e kërkuar në Seksionin II: Shtojcat .

2 Mosparaqitja e informacionit, i cili është thelbësor për të vlerësuar kualifikimet e operatorit ekonomik, do të rezultojë në skualifikimin e operatorit ekonomik.

**16. Paraqitja, e kërkesës për pjesëmarrje/Ofertës**

1 Në procedurat e prokurimit që zhvillohen me mjete elektronike, operatori ekonomik ngarkon kërkesën për pjesëmarrje/ofertën në Sistemin e Prokurimit Elektronik sipas udhëzimeve në manualet përkatëse.

2 Sa i takon procedurave të prokurimit, që zhvillohen në rrugë shkresore, operatori ekonomik paraqet vetëm kërkesën origjinale për pjesëmarrje/Ofertës të mbyllur në një zarf jotransparent, të vulosur dhe të firmosur me emrin dhe adresën e operatorit ekonomik dhe të shënuar: "**Kërkesë për pjesëmarrje/Ofertë; Njoftimi Nr. __.“MOS E HAPNI, ME PËRJASHTIM TË RASTEVE KUR ËSHTË I PRANISHËM KOMISIONI I VLERËSIMIT TË OFERTAVE, JO PËRPARA ------------- d/m/v, në orën-----------”**

**17. Afati i fundit për paraqitjen e kërkesës për pjesëmarrje /Ofertës**

Kërkesa për pjesëmarrje/Oferta duhet të merret dhe hapet nga autoriteti/ enti kontraktor jo më vonë se data dhe ora e përcaktuar në njoftimin e kontratës/Ftesë për Ofertë.

**18. Tërheqja, Zëvendësimi dhe Modifikimet**

1. Operatori Ekonomik mund ta tërheqë, zëvendësojë ose modifikojë kërkesën për pjesëmarrje/Ofertën , në çdo kohë deri përpara afatit të fundit të pranimit të saj.

2. Në procedurat e prokurimit të cilat zhvillohen në rrugë shkresore, ofertuesit mund të modifikojnë ose tërheqin kërkesëspër pjesemarrje/Ofertënme kusht që modifikimi ose tërheqja të bëhet para skadimit të afatit përfundimtar për paraqitjen e tyre. Si modifikimet ashtu edhe tërheqjet duhet t'i komunikohen Autoritetit /entit Kontraktor me shkrim, para datës së afatit fundit për paraqitjen e tyre. Zarfi që përmban deklaratën e Ofertuesit duhet të shënohet: "MODIFIKIM Kërkesë për pjesëmarrje/Oferte” ose "TËRHEQJE Kërkesë për pjesërmarrje/Oferte

**19. Kualifikimi i operatorëve ekonomikë**

1 Për një pjesë të kritereve të pranimit të kërkuara në dokumentat e tenderit, Operatori Ekonomik duhet të paraqesë Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit si një provë paraprake në formën e një deklarate, ku shprehet se Kërkesa e tij është në përputhje me Kërkesat Teknike, kushtet dhe kriteret e përcaktuara në Njoftimin e Kontratës dhe në Dokumentet e Tenderit.

2. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

3. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e kërkuar për të gjitha kriteret për të cilat nuk lejohet vetdeklarim.

4. Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjithë dokumentacionin e paraqitur si pjesë e Kërkesës për pjesërmarrje/Ofertës. Në rast të verifikimit të përmbajtjes së dokumentacionit të paraqitur, ose të Vetëdeklarimeve, kur përmbajtja e tyre nuk rezulton të jetë e vërtetë, Operatori Ekonomik është në kushtet e parashikuara në nenin 78, pika 1, gërma (a) të Ligji për Prokurimin Publik (LPP) .

## D. NJOFTIMI I OPERATORËVE EKONOMIKË

**20. NNjoftimi i kualifikimit apo përzgjedhjes**

1 Autoriteti/enti kontraktor njofton operatorët ekonomikë për rezultatet e fazës së parë të procedurës. Ky njoftim përfshin, minimalisht: emrat e operatorëve ekonomikë të kualifikuar apo operatorëve ekonomikë të përzgjedhur për tu ftuar për të paraqitur oferta.

2.Njoftimi që duhet t'i dërgohet operatorëve ekonomikë do të deklarojë arsyet specifike për refuzimin e kërkesës së tyre për pjesërmarrje..

**Ftesa për ofertë**

Autoriteti/ enti kontraktor do të ftojë të paraqesin ofertë për kontratën vetëm ata operatorë ekonomikë që janë kualifikuar në fazën e parë.

## DH. PARAQITJA DHE HAPJA E OFERTAVE

**21. Paraqitja e Ofertave**

Ofertat do të paraqiten vetëm nga operatorët ekonomikë që kanë marrë një ftesë për ofertë nga autoriteti/ enti kontraktor.

**22. Afati i fundit për paraqitjen e Ofertave**

Oferta duhet të paraqitet brenda afati të përcaktuar nga autoriteti/enti kontraktor. Nëse autoriteti/enti kontraktor zgjat afatin kohor për pranimin e ofertave, operatorët ekonomikë, mund të paraqesin ofertat e tyre brenda afatit të zgjatur.

**Oferta duhet të përfshijë dokumentat e mëposhtëm:**

a) Formularin e Ofertës Ekonomike.

b) Dokumentat që lidhen me objektin e prokurimit (*skica, katalogje, kampione* etj)

___________ ,

___________ ,

c) (Opsion) ofertën alternative teknike (nëse parashikohet)

Një Ofertues duhet të paraqesë vetëm një ofertë.

## E. SHQYRTIMI I OFERTAVE

**23. Përgjegjshmëria e ofertave**

1. Një ofertë e përgjegjshme/vlefshme është ajo që plotëson kërkesat e Dokumenteve të Tenderit pa devijime materiale, rezerva ose mospranim, siç përcaktohet më poshtë:

(a) "**Devijim**" është shmangia nga kërkesat e specifikuara në Dokumentet e Tenderit;

(b) "**Rezervim**" është përcaktimi i kushteve kufizuese ose mospranimi i plotë i kërkesave të specifikuara në Dokumentet e Tenderit; dhe

(c) "**Mospranim**" është mosparaqitja e një pjesë ose e të gjithë informacionit ose dokumentacionit të kërkuar në Dokumentet e Tenderit.

2. Nëse një ofertë nuk i përgjigjet kërkesave të Dokumenteve të Tenderit, ajo refuzohet.

## F. VLERËSIMI I OFERTAVE

**25 Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese**

1 Autoriteti/Enti Kontraktor përcakton ofertën ekonomikisht më të favorshme në bazë të kritereve të përcaktimit të ofertës fituese që janë përcaktuar në Njoftimin e Kontratës dhe në Dokumentet e Tenderit si më poshtë.

**Opsioni 1) Oferta Ekonomikisht më e Favorshme, bazuar në kosto:**

Lidhur me kriteret e vlerësimit, duhet përcaktuar qartë pesha specifike e secilit kriter, përkatësisht numri i pikëve për secilin kriter dhe mënyra se si do të llogariten pikët për ofertuesit e njëpasnjëshëm.

Të gjitha kriteret e vendosura për vlerësimin e ofertave janë objektive dhe shprehen në shifra. Në çdo rast, kur ka më shumë se një kriter, pesha specifike e kriterit të çmimit nuk duhet të jetë më pak se 50 pikë. Pikët maksimale që mund të marrë një Ofertë do të jenë 100.

Formula me të cilën llogariten pikët e ofertuesve, në çdo rast duhet të jetë:

Po= Pk1+Pk2+Pk3+.....

Ku:

Po - janë pikët totale të ofertës së vlerësuar

Pk1/Pk2/Pk3/... - janë pikët për secilin kriter të vlerësuar

Pikët për secilin kriter llogariten sipas formulës:

Pk1= Vmink1 x Pmaxk1/Ok1

Pk1 _____ Pikët e kriterit që vlerësohet

Vmink1 Vlera më e ulët e kriterit që vlerësohet

Pmaxk1 Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

Ok1 Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

**Opsioni 2) – Oferta Ekonomikisht më e Favorshme, Bazuar në Çmim:**

Kontrata do t'i jepet ofertuesit i cili ka ofruar çmimin më të ulët të ofertës së kualifikuar.

**SHENIM:** Autoriteti/Enti Kontraktor do të zgjedhë vetëm një nga Opsionet si kriter i vlerësimit. Përdorimi i të dy opsioneve në DT e bën procedurën të pavlefshme.

2. Autoriteti/Enti Kontraktor do t'i japë kontratën Operatorit Ekonomik, Oferta e të cilit ka rezultuar të jetë ekonomikisht më e favorshme.

3. Autoriteti/Enti Kontraktor përdor si kritere vlerësimi nje nga kriteret e përcaktuara në Njoftimin e Kontratës.

**26. Vlerësimi i ofertave dhe korrigjimi i**

1. Autoriteti/Enti Kontraktor kontrollon ofertat e paraqitura nëse kanë gabime aritmetike. Nëse ofertat rezultojnë me gabime aritmetike, autoriteti/enti i korrigjon këto gabimesi më poshtë:

**gabimeve aritmetike dhe ofertave anomalisht të ulëta**

**(a)** Nëse ka një mospërputhje midis çmimit për njësi dhe çmimit total, që rezulton nga shumëzimi i çmimit për njësi me sasinë, çmimi për njësi do të mbizotërojë dhe çmimi total do të ndryshohet përkatësisht.

**(b)** Nëse ka ndonjë mospërputhje në çmimin total, kur totali është shuma ose diferenca e nën-totaleve, çmimi nën-total mbizotëron dhe çmimi total korrigjohet bazuar në të.

**(c)** Nëse ka ndonjë mospërputhje midis fjalëve dhe numrave, shuma me fjalë do të mbizotërojë. Përjashtim nga ky rregull është situata kur shuma ka të bëjë me gabimin, i cili do të korrigjohet sipas pikave (a) dhe (b) më lart, prandaj në këtë rast shuma në numër mbizotëron dhe ajo me fjalë do të korrigjohet.

**(d)** Nëse ekziston një mospërputhje midis fjalëve dhe shifrave, shuma me fjalë do të mbizotërojë, përveç nëse shuma e shprehur me fjalë lidhet me një gabim aritmetik, rast në të cilin shuma në shifra do të mbizotërojë në bazë të (a) dhe (b) më sipër.

Në çdo rast, Ofertat me gabime aritmetike refuzohen kur:

- vlera absolute e të gjitha korrigjimeve është më shumë se 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar;

- vlera absolute e të gjitha korrigjimeve është më pak se 2%, por korrigjimi nuk pranohet nga ofertuesi.

2. Kur autoritetet /entet kontraktore vërejnë se oferta është anomalisht e ulët, i kërkojnë operatorit ekonomik të paraqesë brenda tre ditëve pune, shpjegime të çmimit ose kostove të propozuara në ofertë, në përputhje me nenin 93 të LPP-së dhe vlerësojnë informacionin e dhënë, në konsultim me ofertuesin dhe në përputhje me dispozitat e këtij neni.- Në rast kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 93 të LPP-së, oferta konsiderohet anomalisht e ulët kur zvogëlohet më shumë se 25% të fondit limit të përllogaritur.

- Në rast kur janë të vlefshme tre ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 93 të LPP-së, oferta konsiderohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më pak se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme.

Nëse një ose disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit, para se të marrë një vendim për kualifikimin e tyre ose jo, në përputhje me nenin 93 të LPP-së.

Në çdo rast, ofertuesi ka detyrimin të justifikojë dhe dokumentojë me prova me shkrim, shpjegime për elementin / elementet specifike të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 93 të LPP-së.

3 Formula që duhet zbatuar, për të vlerësuar një ofertë anomalisht të ulët, në rastin kur ekzistojnë tre ose më shumë oferta të vlefshme, është si më poshtë:

**O - Oferta**

**MO – Mesatarja e ofertave të vlefshme**

**N - Numri i ofertave të vlefshme**

**PR (Zm) – Zbritje e mundshme**

**MO = O1 + O2 + O3 + … On / N**

**PR = 85 % Mo**

**Vlera e ofertave të vlerësuara < .. PR ......... rrjedhimisht oferta është anomalisht e ulët**

4 Nëse një Operator Ekonomik nuk pranon korrigjimin e gabimeve aritmetike, ose nëse Ofertuesi nuk arrin të japë një justifikim për të bindur Autoritetin/Entin Kontraktor, në rast të një oferte anomalisht të ulët, Oferta e tij do të refuzohet.

5. Procesi i hedhjes se shortit

Nëse dy ose më shumë oferta kanë të njëjtin çmim më të ulët ose kanë të njëjtat pikë, atëherë fituesi përcaktohet me short, në prani të ofertuesve. Ofertuesit njoftohen për datën dhe kohën e hedhjes së shortit. Mospjesëmarrja e ofertuesve gjatë procesit të hedhjes së shortit nuk përbën arsye për skualifikim.

## G. DHËNIA E KONTRATËS

**27. Njoftimi i Fituesit**

Brenda afatit të vlefshmërisë së Ofertës, Autoriteti/Enti Kontraktor njofton Operatorin Ekonomik të suksesshëm se, Oferta e tij është pranuar, dhe është shpallur fituese.

**28. Nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër/ Kontratës**

1 Pas konfirmimit të fituesit/ve Autoriteti/Enti Kontraktor përgatit, nënshkruan dhe fton Operatorin/ët e suksesshëm Ekonomik të nënshkruajë Marrëveshjen kuadër/Kontratën.

2 Autoriteti/Enti Kontraktor i kërkon fituesit një sigurim për realizimin e Kontratës. Shuma e mbulimit për realizimin e kontratës do të jetë 10% e vlerës së Kontratës. Formulari i Sigurimit të Kontratës, dorëzohet para nënshkrimit të Kontratës.

Sigurimi për realizimin e kontratës mund të paraqitet në një nga format e mëposhtme:

a) garanci bankare

b) garanci nga shoqëri sigurimi.

## I. ANKESAT

**29. Procedura e ankesës**

.1 Çdo Operator Ekonomik, i cili ka interes për objektin e prokurimit dhe rrezikon të dëmtohet nga vendimmarrja e autoritetit/entit kontraktor mund të paraqesë ankesë njëkohësisht pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në lidhje me Dokumentet e Tenderit, kualifikimin dhe /ose përzgjedhjen e operatorëve ekonomikë për t´u ftuar për të paraqitur oferta, sipas parashikimeve në LPP dhe aktet nënligjore.

2 Autoriteti/Enti Kontraktor mund t'i kërkojë Komisionit të Prokurimit Publik që të lëshojë masa të ndërmjetme për mospezullimin e procedurës së prokurimit.

## E. ANULIMI I PROCEDURËS

**30 Anulimi i procedurës**

1 Autoriteti / Enti kontraktor publikon Njoftimin për Anulimin e Procedurës së Prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç publikon Njoftimin e Kontratës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesave, ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin.

2 Autoriteti kontraktor publikon vendimin e anulimit vetëm pas kalimit të afateve të ankimimit sipas parashikimeve të nenit 110 të LPP.

3. Autoriteti/ enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:

a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë përkatëse në procedurat me faza;

b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;

c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;

d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit ose entit kontraktor ka ndryshuar;

e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;

Gjithashtu, Titullari i autoritetit/entit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 te LPP dhe nenin 75 te VKM 285/2021.

4. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të pikes 3, autoriteti/ enti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.

## SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1. Formulari i Kërkesës për pjesëmarrje

Shtojca 2. Ftesa për Ofertë për kandidatët e përzgjedhur faza II

Shtojca 3. Formulari i Ofertës Ekonomike

Shtojca 4 Lista e Çmimeve të Shërbimeve

Shtojca 5. Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca 6. Lista e Informacionit Konfidencial

Shtojca 7. Formulari i Specifikimeve Teknike

Shtojca 8. Formulari i Shërbimeve dhe Grafikut të ekzekutimit

Shtojca 9. Formulari i Termave të Referencës

Shtojca 10. Formulari i Kritereve Përzgjedhjes së Ofertuesve

Shtojca 11. Formulari i Përmbledhës i Vetdeklarimit

Shtojca 12.Formulari i Njoftimit të skualifikimit

Shtojca 13. Formulari i Njoftimit të Fituesit (Paraprak)

Shtojca 14. Formulari i Njoftimit të Fituesit (Në përfundim të afateve të ankimit)

Shtojca 15. Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër (Paraprak)

Shtojca16.Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër (Në përfundim të afateve të ankimit)

**Shtojca 1**

*(Shtojca për t'u paraqitur nga Operatori Ekonomik)*

**FORMULARI I KËRKESËS PËR PJESËMARRJE**

Emri i **Operatorit Ekonomik**____________________

Drejtuar: *[Emri dhe adresa e autoritetit /entit kontraktor]*

* * *

Procedura e prokurimit: *[lloji i procedurës]*

Numri i procedurës / referenca e Lotit

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Botimi (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike [Data]

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, në, të nënshkruarit paraqesim shprehjen tonë të interesit për të marrë pjesë në këtë procedurë.

**Emri i Përfaqësuesit të Ofertuesit**

**Nënshkrimi**

**Vula**

**Shtojca 2**

*(Shtojcë për tu plotësuar nga autoriteti /enti kontraktor vetëm për operatorët ekonomikë të kualifikuar/ përzgjedhur bazuar në kerkesen per pjesemarrje)*

## FORMULAR I FTESËS PËR OFERTË

[Datë]

Drejtuar: *[Emri dhe adresa e operatorit ekonomik të kualifikuar /përzgjedhur]*

_______________________________________________

Procedura e prokurimit________________/

Numri i procedurës / referenca e Lotit ______________

Në referencë të procedurës së lartpërmendur ju bëjmë me dije se [emri dhe adresa e kandidatit të përzgjedhur], pas vlerësimit të dokumentacionit të paraqitur në fazën e parë Ju jeni kualifikuar për fazën ofertuese të kësaj procedure prokurimi.

Për këtë arsye, ju kërkojmë të paraqisni pranë [këtij autoriteti/enti kontraktor]

Emri ________________________________________________

Adresa ________________________________________________

Ofertën tuaj, duke marrë në konsideratë si më poshtë:

**Afati i fundit për paraqitjen dhe hapjen e ofertës është:**

Data (d/m/v) Ora: _____________________________

Adresa ______________________________________________________________________________

Kur oferta kërkohet të paraqitet me mjete elektronike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin ofertën në formë elektronike në ueb-faqen zyrtare të APP, **www.app.gov.al.**

**Informacioni mbi ofertat e paraqitura me mjete elektronike i transmetohet të gjithë atyre Operatorëve Ekonomikë që kanë dorëzuar oferta, në bazë të kërkesës së tyre.**

**Gjuha (ët) e hartimit të ofertës është:**

Shqip ☐ Anglisht ☐

Tjetër __________________________

**Kriteret e përzgjedhjes së fituesit**

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit janë si më poshtë:

A) **oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto** □

Sipas rëndësisë:

Çmimi □ pikët□□

_______□□ pikët □□

_______□ □ pikët □□

______ □□ pikët □□

Autoriteti/enti kontraktor duhet të specifikojë pikët për cdo kriter vlerësimi të përcaktuar.

**OSE**

B) **oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim** □

**Në rastin e Marrëveshjes Kuadër, kur do të përdoret kriteri i vlerësimit të çmimit për njësi, për qëllime krahasimi, vlerësimi i ofertave do të kryhet në bazën e shumës së çmimeve për njësi (***Kjo metodë e vlerësimit nuk do të përdoret nga autoritetet/entet kontraktore në rastet kur sasitë janë të vlerësueshme në bazë vjetore sipas përvojës së mëparshme dhe kur Marrëveshja Kuadër është përdorur për prokurimin e mallrave dhe shërbimeve të vazhdueshme. Në rast të tillë çmimi më i ulët do të vlerësohet me vlerën totale më të ulët ofruar).*

Mbetemi në pritje të marrjes së ofertës suaj.

**[Drejtuesi i autoritetit /entit kontraktor]**

**Shtojca 3.**

*(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik i ftuar për të paraqitur ofertën)*

**FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE**

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor**]

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i [**Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

**a)** Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[*shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE*]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.

**b)** Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit/Entit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Shërbimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Shërbimeve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.

**d)** Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:

1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
2. Njoftimin e kontratës;
3. Kriteret e përzgjedhjes;
4. Specifikimet teknike, grafiku i ekzekutimit;
5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
7. Listat e Çmimeve të Shërbimeve.

**e)** Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ------------- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

| | |
|---|---|
| **Emri i përfaqësuesit të ofertuesit** | |
| **Nënshkrimi** | |

| | |
|---|---|
| **Vula** | |
| **Datë __________________** | |

**Shtojca 4.**

*(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)*

**LISTA E ÇMIMEVE TË SHËRBIMEVE**

**LOTI 1 ME OBJEKT: "SHËRBIM I LAVANDERISË PËR PACIENTËT E HOSPITALIZUAR NË PAVIONET E SPITALIT MEMORIAL FIER"**

**Data**: ___________________________________

**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:**

**___________________________________**

**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë** (në rast BOE): ________________________________________________

**Monedha**: ___________

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të rregullohen në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë shërbimet në Formularin e Shërbimeve dhe grafikut të ekzekutimit duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për Shërbime Shërbimet pa çmim do të konsiderohen si shërbime të pa ofruar dhe do të çojnë në refuzimin e ofertës.

**Lista e Çmimeve**

| *1* | *2* | | *3* | *4* | *6* | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **Artikulli** | **Përshkrimi i shërbimit** | **Njësia** | **Sasia për dy vite** | **çmimi për njësi** | **Çmimi total për sherbim** | **Afati** |
| 1. | Shërbimi i lavanderisë dhe hotelerisë për pacientët e hospitalizuar në pavionet e Spitalit Memorial Fier | **Kg** | **241,000** | | | **24 (njëzet e katër) Muaj** |
| | **Çmimi Neto pa TVSH** | | | | | |
| | **TVSH (%)** | | | | | |

| | | |
|---|---|---|
| | **Çmimi total me TVSH:** | |
| | **Emri i përfaqësuesit të ofertuesit** | |
| | **Nënshkrimi** | |
| | **Vula** | |
| | **Datë _________________** | |

**Shtojca 4.**

*(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)*

**LISTA E ÇMIMEVE TË SHËRBIMEVE**

**LOTI 2 ME OBJEKT: "SHERBIMI I LAVANDERISË DHE HOTELERISË PËR SPITALIN RAJONAL FIER"**

**Data**: ___________________________________

**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:**

**___________________________________**

**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë** (në rast BOE): ______________________________________________

**Monedha**: ____________

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të rregullohen në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë shërbimet në Formularin e Shërbimeve dhe grafikut të ekzekutimit duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për Shërbime Shërbimet pa çmim do të konsiderohen si shërbime të pa ofruar dhe do të çojnë në refuzimin e ofertës.

**Lista e Çmimeve**

| *1* | *2* | | *3* | *4* | *6* | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **Artikulli** | **Përshkrimi i shërbimit** | **Njësia** | **Sasia për 36 Muaj** | **çmimi për njësi** | **Çmimi total për sherbim** | **Afati** |
| 1. | Sherbimi i Lavanterise dhe Hotelerise ne Spitalin Rajonal Fier | **Kg** | **456 000** | | | **36 (tridhjete e gjashte) Muaj** |
| | **Çmimi Neto pa TVSH** | | | | | |
| | **TVSH (%)** | | | | | |
| | **Çmimi total me TVSH:** | | | | | |

| | | |
|---|---|---|
| | **Emri i përfaqësuesit të ofertuesit** | |
| | **Nënshkrimi** | |
| | **Vula** | |
| | **Datë _________________** | |

**Shtojca 5.**

[ *Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)*

[*Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve*]

## FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: *[Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]*

Në emër të: *[Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]*

* * *

Procedura e prokurimit *[lloji i procedurës]*

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[objekti]*

Publikimi *(nëse zbatohet):* Buletini i Njoftimeve Publike *[Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se*

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

*Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra]* si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [*emri i autoritetit/entit kontraktor*] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërmbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentet e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës se prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentet e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [*njoftimin e kontratës*].

**[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]**

**Shtojca 6**

*(Shtojce për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)*

**Lista e Informacionit Konfidencial**

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial )

| Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial | Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale | Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni | Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni |
|---|---|---|---|
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |

**VËMENDJE**

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

**Përfaqësuesi i Ofertuesit**

**Nënshkrimi**

**Vula**

**Shtojca 7.**

**LOTI 1 ME OBJEKT: "SHËRBIM I LAVANDERISË PËR PACIENTËT E HOSPITALIZUAR NË PAVIONET E SPITALIT MEMORIAL FIER"**

[ *Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor*]

**FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE**

Duke patur parasysh natyrën spitalore, është e domosdoshme dhe e rëndësishme, që materiali i butë për t'u larë, duhet të tërhiqet sa me shpejt nga pavionet ose sallat e operimit, bazuar në manualet e kujdesjeve spitalore dhe rregullave të higjienës (selektimi sipas ndotjes së materialit të butë në thasët me ngjyrë). Mos largimi në kohë i këtij materiali, do të çonte në rritjen e infeksioneve spitalore me efekt final uljen e përformacës së ofrimit të shërbimit ndaj pacientëve, rritjen e ditëqendrimit, rritjen e përdorimit të medikamenteve (kryesisht antibiotikeve). Volumi i konsiderueshëm i materialit që është në përdorim në SRMF, kërkon që operatori i kontraktuar, për ofrimin e këtij shërbimi, duhet të bëjë investime si në strukturën e lavanderisë, ashtu edhe në personel.

**Pjesa I – Normativat bazë për Shërbimin e Lavanderisë**

Bazuar në udhëzimin e "Ministrisës së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale" nr.141 datë 08.03.2024, prot në SRMF nr.551 datë 16.04.2024, lënda*: "Për përcaktimin e normativave të shërbimit të personelit shëndetësor në institucionet shëndetësore publike me shtretër"* si dhe në nevojat  e Spitalit Rajonal "Memorial" Fier, konkludon si më poshtë:

Referuar standardeve dhe protokollove për shërbimet spitalore, në vijim janë të detajuar Iloji i materialit të butë që do të kete per secilin pacient dhe qe do te lahet si dhe materiali i bute per personelin mjeksor.

- **Materiali i butë i pacientit**
  - Carqafë shtrati (i poshtëm, i sipërm, zarf)
  - Batanije
  - Jorgan
  - Këllëf dysheku
  - Jastëk
  - **Këllëf jastëku**
  - Bizhame pacienti
  - Rrobdishane pacienti
  - Pantofla pacienti
- **Materiali i butë i personelit shëndetësor.**

- Përparëse mjeku (të bardha)
- Kostumet e Personelit Mjekësor (inferrnier/ndihmës)
- Kostume te stafit

Ndërrimi i shtratit të pacientit do të bëhet çdo tre ditë ose dy herë në javë, si dhe në çdo rast që kërkohet nga kryeinfermieri i pavionit/shërbimit, si pasojë e shtrimit te pacientëve të rinj (me hapjen e kartelës klinike), ose në rastet kur ndryshimi i shtratit bëhet i domosdoshëm për të ruajtur dhe mbrojtur shëndetin e pacientit,

Në tabelën në vijim, jepet e detajuar shpeshtësia e ndërrimit të çarçafëve, në shërbimet e Spitalit Rajonal Memorial Fier.

Tabela nr.1- Shpeshtësia e ndërrimit të çarçafëve

| Nr | Shërbimi | Shpeshtësia e Ndërrimit të Carcafëve |
|---|---|---|
| 1 | Kirurgjitë (të gjitha kirurgjitë që kryhen në Memorial” | 1 x ditë të operuarit |
| | | I x 3 ditë & para-operacionit dhe pas ditës së dytë te operimit |
| 2 | Shërbimi i Reanimacionit | 1 x ditë |
| 3 | Shërbimi i mjekësisë interne, Pneumologjisë, Kardiologjisë, Infektivi | 1 x 3 ditë |
| 4 | Neurologii | I x 3 ditë |
| 6 | Shërbimi i Urologjisë | 1 x 3 ditë |
| 5 | Urgiencat | Sa herë të jetë e nevojshme |

Tabela nr.2 -Baza mazeriale (materiali i butë i nevojshmëm) :

| Nr. | Emërtimi | Komente |
|---|---|---|
| 1 | Dyshekë | Për të gjithë shtretërit |
| 2 | Kellefe dysheku | Për të gjithë shtretërit. |
| 3 | Jasteke | Per cdo Shtrat |
| 4 | Kellef  jasteku | Per cdo Shtrat |
| 5 | Çarçaf për shtratin- i poshtëm | Per cdo Shtrat |

| | | |
|---|---|---|
| 6 | Çarcaf për shtratin – i sipërm | 15 Maj deri në 15 Shtator (periudha pranverë- verë) |
| 7 | Çarçaf zarf | Per çdo Shtrat 16 Shtator -14 Maj (periudha vjeshte – dimer) |
| 8 | Batanie | Vetem per postoperatoret dhe urgjencat (sipas nevojave) |
| 9 | Jorgan | 16 Shtator -14 Maj |
| 10 | Robdishane pacienti per kirurgjine e adulteve | Për të gjitha kirurgjitë |
| 11 | Bizhama pacienti | Për të gjithë pacientët |
| 12 | Pandofla pacienti per adultet | Per te gjithe pacientet |

Tabela nr.3- Uniformat e standartizuata për personelin shëndetësor

| **Nr** | **Emërtimi** | **Njësia** | **Specifikimet Teknike** | **Dimensionet** | **Lloji i materialit** | **Nr. I personelit plan** |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Përparëse mjeku (Unisex) | copë | Me menge te gjata, me kopsa mc perçina, dhe dy xhepe anash, me ngjyren e bardhë, me logon MSHMS dhe emërtesën e instutucionit, logon e SRMF, pjesa e mbrapme me të çarë. | S,M,L,<br>XL,XXL | Perzierje 65% pambuk dhe 35 % poliester | |
| | | | | | rje ne $60^0$ | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 2 | Kostume Infermieri<br>(Bluze me Pantallona unisex) (gjate dimrit vishet bluze e bardhë e mengët e gjata poshtë kostumit | copë | Bluza me jake V te trashë, me menge të shkurtra (tre cerekshe) dhe dy xhepa anesore poshtë , me ngjyren sipas llojit të sherbimit, dhe me logon MSHMS dhe emertesen e Institucionit.<br>• Infermier pavioni: Ngjyra Bojeqielli i hapur<br>• Mjek dhe Infermier në Urgjencë,Mjek dhe Infermier Blloku Operator: Ngjyra Blu e erret<br>• Mjek dhe Infermier Reanimacioni: Ngjyra Jeshİle e erret<br>• Teknik Lahoratori Bluza ngjyre e bardhë dhe pantallonat ngjyre blu e erret<br>• Teknik Imazherie - Bluza dhe Pantallonat, ngjyrë gri | S,M,L,<br>XL,XXL | Perzierje 65% pambuk dhe 35 % poliester | |
| 3 | Kostume<br>Sanitare (bluze dhc pantallona unisex) gjatë dimrit vishet bluza e bardhë me mengë të gjata poshtë kostumit | copë | Bluza me jake V te trashe, me menge te shkurtra (tre cerekshe) dhe dy xhepa anesore poshte, me logon MSHMS dhe emertesen e institucionit. Bluza dhe pantallonat me ngjyrë vishnje të ërrët, sipas modelit. | S,M,L,<br>XL,XXL | Perzierje 65% pambuk dhe 35 % poliester | |
| 4 | Kostume<br>Personeli<br>Ndihmës (Barrelambajtës) | copë | Bluza me jakë V te trashë, me menge te shkurtra (tre cerckshe) dhe dy xhepa anesore, poshte 180 gr/$m^2$ , me logon MSHMS dhe | S,M,L,<br>XL,XXL | Perzierje 65% pambuk dhe | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | Bluze dhe pantallona unisex (gjatë dimrit vishet bluze e bardhë me mëngë të gjata poshtë kostumit) | | emertesen e institucionit. Bluza dhe pantallonat me ngjyrë të bardhë. | | 35 % poliester | |
| 5 | Kostum Fizioterapeut<br>(gjatë dimrit vishet bluze tute me mëngë të gjatë) | copë | Bluze me tre komca (T-shirt polo), me mëngë të shkurtra, me logon e MSHMS në të dhjathtë të tshirt, dhe emertesën e instituconit,në ngjyrë të bardhë. Pantallonat (tuta) ngjyrë blu e errët ose e zetë. | S,M,L,<br>XL,XXL | Perzierje 65% pambuk dhe<br>35 % poliester | |

- **Kostum Fizioterapeut**

Perzierje 65% pambuk dhe 35 % poliester. Bluze me tre komca (T-shirt polo), me mëngë të shkurtra, me logon e MSHMS në të dhjathtë të tshirt, dhe emertesën e instituconit, në ngjyrë të bardhë. Pantallonat (tuta) ngjyrë blu e errët ose e zetë.
(gjatë dimrit vishet bluze tute me mëngë të gjatë)

- **Kostum Recepsionist/Informacioni**

Pantallona të zeza, këmishë e bardhë me shallë me logon e MSHMS. (gjatë dimrit vishet xhaketë e zezë ose triko e zezë)

- **Kordinator me pacientin**

Pantallona të zeza, tshirt polo ngjyrë gri me tre komca, me logon e MSHMS në të majtë(gjatë dimrit vishet xhaketë e zezë ose triko e zezë)

- **Badge**

Tabela nr.5 – Norma e zëvëndësimit të uniformave të personelit shëndetësor:

| Nr. | Emertimi | Frekuenca e zevendësimit | Sasia totale në vit |
|---|---|---|---|
| 1 | Përparëse mjeku | 1- vit | 200 |

| | | | |
|---|---|---|---|
| 2 | Kostume personeli mjeksor (infermier) | 1- vit | 500 |
| 3 | Kostume sanitare | 1- vit | 60 |
| 4 | Fizioterapist | 1- vit | 4 |
| 5 | Teknik imazherie | 1- vit | 40 |
| 6 | Koordinator | 1- vit | 20 |
| 7 | Arketar + recepsionist | 1- vit | 20 |
| 8 | Kujdestar + barrelambajtës | 1- vit | 14 |
| 9 | Kostume ekipi salle | 1- vit | 200 |

## PJESA II – SPECIFIKIMET TEKNIKE DHE MENAXHIMI I PROCESIT TË LAVANDERISË

- Operatori ekonomik privat që do të kontraktohet, duhet të ofrojë një shërbim, i cili do të përfshijë:

- Grumbullimin e materialit të butë të papastër në të gjitha pavionet e Spitalit Memorial Fier sipas grafikëve të përcaktuar, rregulloreve dhe protokolleve të higjenës dhe manualeve të kujdesit spitalor;
- Larjen e materialit te butë;
- Tharjen e materialit të butë,
- Hekurosjen dhe paketimin e materialit te butë;
- Shpërndarjen e materialit të butë në të gjitha shërbimet dhe pavionet e Spitalit Memorial Fier ,sipas grafikëve të përcaktuar;
- Shtrimin e shtratit të pacientit;

Shërbimi do të ofrohet gjatë gjithë javës prej ditës së hënë deri ditën e diel (operatori ekonomik privat, duhet të sigurojë edhe materialin e butë për mbulimin e nevojave në pavione, dhe shtrimin e shtratit të pacientit gjatë fundjavës) si dhe lënien e bazës materiale rezerve për nevoja të shërbimit gjatë shtrimeve të reja natën, urgjencave, por edhe sipas grafikut të përcaktuar për nderrimin periodik të materialit të butë në shërbimet përkatëse, dhe sipas kërkesës së Kryeinfermierëve të pavionit në rast të ndërrimit të materialit të butë kur bëhët i domosdoshëm për pacientë të vecantë.

- Në kontratën e shërbimit të lavanderisë dhe hotelerisë, ndër të tjera duhet të ketë disa elementë kryesorë, si:

I. Larjen e materialeve të buta.
II. Specifikimet Teknike të materialit të butë.
III. Etapat e Menaxhimit të proçesit të Lavanderisë.

**Viti I**

| Nr | Përshkrimi i shërbimit | Sasia totale e materialit të butë (në kg) |
|---|---|---|
| 1 | Shërbimi i lavanderisë dhe hotelerisë për pacientët e hospitalizuar në pavionet e Spitalit Memorial Fier | 115,000 |

**Viti II**

| Nr | Përshkrimi i shërbimit | Sasia totale e materialit të butë (në kg) |
|---|---|---|
| 1 | Shërbimi i lavanderisë dhe hotelerisë për pacientët e hospitalizuar në pavionet e Spitalit Memorial Fier | 126,000 |

Cilësojmë se i gjithë materiali i butë që do të përdoret, duhet të përmbajë logon dhe emërtimin e Spitalit Rajonal Memorial Fier.

Materialet të jenë shoqëruara me çertifikatë analize

Materialet ti përgjigjen standarteve STASH në fuqi dhe standarteve europiane CE

Operatori fitues duhet të plotesojë kushtin teknik paraqitjen e mostrave për çdo artikull pas lidhjes se kontrates.

Shërbimi për pacientët në të gjithë SRMF ofrohet në numrin prej 150 shtretër dhe shërbimi për mjekët roje në 7 shtretër .Ky është numri i shtretërve mbi të cilën llogaritet aktiviteti spitalor, si dhe pacientët hospitalizohen dhe marrin shërbimin e duhur.
Nga sa më sipër numri total i shtretërve që duhet të pajisen me bazë material dhe që duhet të jenë të mbuluar nga shërbimi i lavanderisë është si më poshtë :

Tabela nr.1 – Numri i shtretërve në Spitalin Rajonal Memorial Fier

| Përshrkimi i Shtratit | Nr. Total | Komente |
|---|---|---|
| Shtretër për pacientët e hospitalizuar | 150 | 144 shtretër për pacientët e hospitalizuar + 6 shtretër për shërbimin e urgjencës |
| Shtretërit për Mjekët Roje | 7 | |
| **Totali i shtretërve** | **157** | |

**Shënim:** *Mbasi të jetë lidhur kontrata me OE dhe gjatë procesit të marrjes në dorëzim të bazës materiale nga SRMF, do të ngrihet një komision i cili duhet të bëj peshimet e të bazës materiale për të saktësuar peshën e secilit zë. Ky proces duhet të bëhet në prezencën e OE dhe do të firmoset nga të dyja palët. Peshat e bazës material do të përdoren në fund të cdo muaji për llogaritjen e kg dhe faturimin mujor.*

- Specifikimet për materialin e butë që do të përdoret në Spitalin Rajonal Memorial Fier paraqiten si më poshtë vijon:

| Materiali i butë | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| **Nr** | **Emërtimi** | **Njësia** | **Specifikimet Teknike** | **Dimensionet** | **Lloji i materialit** |
| 1 | Dyshek | Copë | Të përshatëshëm për shtretër spitalor | ○ 195 x 87 cm<br>○ 200 x 60 cm<br>○ 193 x 60 cm | Të përshatëshëm për shtretër spitalor |
| 2 | Këllëf dysheku (mbulesë) | Copë | 280 - 300 gr/m2 material pambuku, ngjyrë e bardhë, i qepur nga të katër anët me llastik për t'u fiksuar tek dysheku spitalor. Logo SRMF | 260x150 cm | Pambuk 100%, lahet në temperaturë 90° |
| 3 | Jastëk | Copë | Mbushje uniforme me fibra sintetike, ngjyrë e bardhë me mbulesë dyshe | 50x80 cm<br>Pesha min.1000 gr | Larje në të thatë |
| 4 | Këllëf Jastëku | Copë | Nga njëra anë ka një të çarë si xhep, për të lejuar futjen e jastëkut ngjyrë e bardhë 160 – 180 gr/m2. Logo SRMF. | 60x90 cm | 75% pambuk x 25% Polyester, lahet në temperaturë 60° |
| 5 | Çarçafë shtrati i poshtëm | Copë | 160 – 180 gr/m2, me qepje nga të katërta anët. Ngjyrë e bardhë, Logo SMF | 170x270 cm | 75% pambuk x 25% polyester, lahet në temperaturë 60° |
| 6 | Çarçafë shtrati i sipërm | Copë | 160 – 180 gr/m2, me qepje nga të katërta anët. Ngjyrë e bardhë, Logo SRMF | 160x260 cm | 75% pambuk x 25% polyester, lahet në temperaturë 60° |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 7 | Çarçafë zarf | Copë | 160 – 180 gr/m2 dy fletësh, me qepje nga të tre anët, i çarë në fund për të mundësuar futjen e jorganit ose të batanijeve në formë zarfi. Ngjyrë e bardhë. Logo SRMF | 190x150 cm | 100% pambuk, ngjyrë e bardhë, lahet në temperaturë 90° |
| 8 | Batanije | Copë | Material 100% lesh me ngjyrë sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktor. | Pesha 1.1-1.2 kg.Përmasat 140x180cm | Larje në 40° |
| 9 | Jorgan | Copë | Me mbushje me vatine, me tegela ndarëse në formë kuadrati, ngjyrë e bardhë. Veshja e jashtme e jorganit të jetë pambuk. Pesha<br>2 - 2.2 kg | 140x180 cm | Larje në të thatë |
| 10 | Robdishane pacienti për kirugjinë e adulteve | Copë | Pambuk i plotë xhaketa me krahë të gjatë me komca në gjatësinë e krahut. Pantallona unisex me komca anësore në gjatësinë e këmbëve. Në ngjyrëshe. Pesha min. 600 gr | Xhaketa 71 cm.<br>Pantallona 120 +-5cm | Përbërje 100% pambuku, me larje në temperaturë 90 ° |
| 11 | Bizhama pacienti | Copë | Pambuk i plotë xhaketa me krahë të gjatë, me jakë ose formë V.<br>Pantallonat unisex me llastik në bel, njëngjyrëshe, pesha 0.6-0.65 kg | Xhaketa 71 cm.<br>Pantallona 120 +-5cm | Përbërje 100% pambuku, me larje në temperaturë 90 ° |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 12 | Pandofla pacienti për adultët | Copë | Lëkurë ngjyrë e bardhë, me vrima për ajrosje me shtresë ortopedike për qëndrimin për kohë të gjatë në këmbë, pesha 0.3-0.4 kg | Numrat nga: 36 – 45 | |

Nisur nga numri total i shtretërve që janë në përdorim në SRMF dhe që janë pjesë e shërbimit të lavanderisë, operatori ekonomik nga momenti i lidhjes së kontratës duhet të furnizojë me bazën e mëposhtme materiale të gjitha shërbimet, brenda një afati kohor që do të përcaktohet nga Autoriteti Kontraktor. Gjithashtu operatori ekonomik duhet të ketë një rezervë minimale prej 10% të artikujve të mësipërme, për të siguruar vijueshmërinë e punës mbas ditës së parë të furnizimit.

**Shënim:** *Mbasi të jetë lidhur kontrata me OE dhe gjatë procesit të marrjes në dorëzim të bazës materiale nga SRMF, do të ngrihet një komision i cili duhet të bëj peshimet e të bazës materiale për të saktësuar peshën e secilit zë. Ky proces duhet të bëhet në prezencën e OE dhe do të firmoset nga të dyja palët. Peshat e bazës material do të përdoren në fund të cdo muaji për llogaritjen e kg dhe faturimin*

- **Specifikimet teknike të Menaxhimit të Proçesit të Lavanderisë**

Operatori ekonomik do të ofrojë shërbimin e tij, nga procesi i lavanderisë deri tek kompletimi me nevojat për inventarin e materialit të butë, shtrimin/ndërrimin e materialeve në shtratin e pacientit/shtratin e mjekut roje.

Sipërmarrësi është i detyruar të disponojë të gjitha kapacitetet larëse dhe dezinfektuese, tharëse, hekurosëse dhe paketuese, por edhe zëvendesimin e materialit të butë, nëse është i dëmtuar apo i amortizuar.

Operatori Ekonomik siguron nevojat për inventar për materialin e butë (inventar në përdorim), për një kompletim të rregullt sipas normave të shtratit që ka SRMF, me emërtimin/siglën përkatëse të institucionit kontraktues. Inventari i materialit të butë, në kuptimin e kësaj kontrate, emërtimi, përmasat, dimensionet, cilësia dhe normat e përdorimit në kohë, do të përfshihen në specifikimet përkatëse.
Sipërmarrësi do të lajë, dezinfektojë, thajë, paketojë të transportojë dhe shpërndajë deri në pavion bazën e materialit të butë si dhe të bëjë shërbimin e plotë deri tek shtrati i pacientit.

Rregullat e shtrimit të shtratit do të bëhen sipas protokolleve të kujdesit infermieror, manualit të kujdesit spitalore, rregullave të higjenës me njoftimin e hapjes së kartelës së re të shtrimit nga kryeinfermierët të shërbimit si dhe sa herë nevojitet nga shërbimi.

Larja dhe dezinfektimi, në repartin e lavanderisë do të bëhet në mënyrë të përqëndruar, duke respektuar të gjitha procedurat dhe protokollet e higjenës, nga marrja në dorëzim e materialit të butë të papastër të ndarë sipas nëndarjeve dhe zonave të rrezikshmërisë (thasët me ngjyrë), tek dorëzimi i materialit të butë, të larë, të hekurosur dhe të paketuar sipas këtyre protokolleve, deri në shtrimin e shtratit të pacientit sipas protokolleve infermierore. Pjesë e këtij procesi

është edhe sigurimi i pastrimit të plotë kimik-mekanik, në temperaturat e duhura dhe i procesit të hekurosjes.

- **Larja** e inventarit të materialit të bute, do të bëhet me këto afate:

  - Çarçafët, këllëfët e jastekut, këllëfët e dyshekut, Robdishane pacienti per kirurgjine e adulteve, pizhamet e pacientit do të lahen 2(dy) herë në javë, për cdo shtrim të ri, si dhe sa herë të jetë e nevojshme nga shërbimi.
  - Jorganët, batanijet, do të lahen minimalisht 1 (një) herë në vit dhe sa herë të jetë e nevojshme nga sherbimi.
  - Jastëkët do të lahen, minimalisht 4 herë në vit dhe sa herë të jetë e nevojshme nga shërbimi.
  - Kostumet josterile të sallave të operacionit, do të bëhet në bazë të operacioneve që kryen shërbimi.
- Përparëset e mjekut, kostumet e personelit infermieror, personelit ndihmës, të sanitareve etj do të lahen 2 (dy) herë në javë dhe sa herë të jetë e nevojshme nga shërbimet/personeli.
- Pandoflat e pacientit do të lahen 1(një) herë në muaj dhe sa herë të jetë e nevojshme nga shërbimi.

- **Ndërrimi i materialit të butë të shtratit, do të bëhet me këto afate:**

- Çarçafë shtrati i sipërm dhe i poshtëm, çarçaf zarf, këllëf jastëku, këllëf dysheku, rrobdishan pacienti, pizhame pacienti, do të ndërrohen jo më pak se 2 (dy) here në javë për çdo shtim të ri, si dhe sa herë kërkohet nga shërbimi.
- Përjashtim në afatet e ndërrimit të materialit të butë të shtratit të pacientit do të bëjnë disa shërbime për shkak të specialitetit që ato trajtojnë kur shihet e arsyeshme nga shërbimi.
- Përgjegjëset e materialeve të buta, mund të ndërrojnë deri në 100 shtretër pacienti në ditë (maksimumi).

Tërheqja dhe dorëzimi i inventarit të materialit të butë në pavione, do të bëhet me grafik të hartuar nga Kryeinfermieria e Përgjithshme. Grafiku është i detyruar të zbatohet nga të dyja palët, dhe në rastet e ndryshimit të tij, miratimi duhet të bëhet me nënshkrim nga të dyja palët.

Përdorimi i inventarit të materialit të butë brenda pavionit, bëhet dhe mbetet nën përgjegjësinë e personelit të sipërmarrësit të kontrolluar nga autoriteti kontraktor, sipas proçedurave të mëposhtme:

- **Etapat e këtij proçesi çdo ditë:**

- Çdo ditë, Kryeinfermieri harton forcën ditore totale për ditën e nesërme për material të butë dhe brenda orës 13:30 e dorëzon pranë **Komisionit Të Monitorimit Të Procesit Të Lavanderisë.**
- **Komisioni i Monitorimit Të Procesit Të Lavanderisë** harton pasqyrën përmbledhëse, bazuar në fletë kërkesat ditore dhe ia dorëzon O.E. për zbatim.
- Punonjësit e shpërndarjes duhet të jenë të pajisur me uniformë si dhe me mjete e shenja dalluese përkatëse të kontraktuesit, me mirëkuptim të SRMF.
- Kontraktuesi do të zëvendësojë çdo punonjës nëse A.K. konstaton se personi kryen veprime të jashtëligjshme gjatë ushtimit të profesionit të tij.

- Punonjësit duhet të sillen me edukatë dhe kortezi, si gjatë zhvillimit të shërbimit dhe gjatë qarkullimit brenda ambjenteve të SRMF.
- Personeli duhet të jetë i pajisur me kontratë të rregullt pune, tu kryhet pagesa e sigurimeve shoqërore e shëndetësore, si dhe të jetë i pajisur me librezë shëndetësore nga Inspektoriati Sanitar Shëndetësor.
- Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të ushtrojë kontroll në ambjentet e lavanderisë dhe depove të materialeve të buta nëpër pavione, në prani të përfaqësuesit të Kontraktorit.
- Operatori i kontraktuar duhet të ofrojë shërbimin e grumbullimit të të gjithë materialit të butë të papastër në bazë të rregullores së parandalimit të infeksioneve nozokomiale, transportimin e tij në lavanderi, seleksionimin, larjen, tharjen, hekurosjen, paketimin, transportimin sërisht mbrapsht në Shërbime (ku materiali i larë nuk duhet të ketë kontakt me materialin e palarë për të shmangur infeksionet), deri në shtrimin e shtratit të pacientit në të gjitha shërbimet e SRMF-së:
- Operatori ekonomik siguron invenatrin e materialit të butë, për një kompletim të rregullt sipas normave të shtratit që ka SRMF, me emërtim dhe siglën përkatëse të SRMF, për secilin artikull: dyshek spitalor, këllëf dysheku , jastëk, këllëf jastëku, batanije, çarçaf shtrati i poshtëm, çarçaf shtrati i sipërm, çarçaf zarf, jorgan vatine, pizhame pacienti, pandofla pacienti dhe personeli, kostumet e sallës, përparëse mjeku, kostume infermieri, sanitare, barrelambajtës, fizioterapeut, teknik laboratori, teknik imazherie.
- Shpërndarja e materialit të butë në të gjithë shërbimet e SRMF-së, sipas grafikëve të përcaktuar nga Kryeinfermieria e Përgjithshme nga ora 07:00 deri në orën 15:00.

- **Proçesi i marrjes në dorëzimi i inventarit në pavion,** do të bëhet me dokument të rregullt të nënshkruar nga kryeinfermjeri/ja i/e pavionit ose personi i autorizuar prej tij, pas numërimit, kontrollit për hekurosjen, cilësinë e materialit të butë të larë në lavanderi (në bazë të kërkesës të sjellë një ditë mëparë në sektorin e hotelerisë). Ky dokument (fletë hyrje-dalje materiali) duhet të jetë në tre kopje, të miratuar nga **Autoriteti Kontraktor** dhe **Sipërmarrësi.**
- Shtrimi i shtratit të pacientit në pavion, si për shtrimet e reja ashtu edhe shtrimet urgjence, nga ora 15:00 deri ne orën 07:00 të mëngjesit të ditës së nesërme do të jetë nën përgjegjësinë e personelit të SMF-së.
- Tërheqja e materialeve të ndotura nga pavioni, do të bëhet nga sipërmarrësi deri në orën 15:00 ose sipas nevojave në rastet veçanta.
- Kontraktuesi duhet të disponojë dy mjete transporti të përshtatshme për transportin e materialeve të buta me kapacitet mbi një ton. Automjetet do të jenë të pajisura me akt kolaudimi dhe siguracion të lëshuara nga organet kompetente Shqiptare.
- Në rast të dëmtimit / konstatimit të mungesave të materialit të butë , për periudhën e lënë nën administrimin e personelit të SMF-së, do të mbahet një proçes-verbal, i cili do të firmoset nga të dyja palët, një kopje e të cilit do të dorëzohet tek personat përgjegjës të ndjekjes së kontratës dhe sipërmarrësi do të bëjë menjëherë zëvendësimet përkatëse.
- Kryeinfermieri i pavionit do të evidentojë dhe konfirmojë në mënyrë të vazhdueshme lidhur me shërbimet që kryhen, cilësinë dhe sasinë e kërkuar, si dhe për çdo parregullsi do informojë Komisioni i Monitorimit Të Procesit Të Lavanderisë.

*Në të gjitha rastet, kur shërbimet kanë nevojë për material të butë shtesë, vetëm pas miratimit të Komisioni i Monitorimit Të Procesit Të Lavanderisë dhe Kryeinfermierisë së Përgjithshme, sipërmarrësi do të proçedojë me dorëzimin e materialit të butë shtesë të kërkuar nga shërbimi, pas miratimit të Sektorit të Monitorimit të Shërbimeve të Kontraktuara.*

• Për raste të gjendjes së jashtëzakonshme, epindemive apo pandemive, lavanderia do të funksionojë sipas kushteve që vendos Drejtoria e SRMF-së.

• Riparimi i inventarit të dëmtuar, bëhet nga sipërmarrësi duke ruajtur përmasat, dimensionet dhe përbërjen fillestare.

• Kontraktuesi do të largojë vetë mbetjet urbane që gjenerohen gjatë ofrimit të shërbimit.

• Sipërmarrësi siguron ujin dhe energjinë elektrike, nëpërmjet kontratave individuale me operatorët përkatës që ofrojnë furnizimin me ujë dhe energji elektrike.

• SRMF-ja do të vendosë në përdorim ambjente, ku sipërmarrësi mund të ushtrojë aktivitetin e shërbimit të lavanderisë. Për mjedisin që do të merren në përdorim, sipërmarrësi duhet të paguajë qeranë sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi. Këto mjedise nuk mund të tjetërsohen. Kur janë të nevojshme të bëhen përshtatje, për shkaqe teknologjike, merret miratimi me shkrim nga SRMF-ja.

• Të gjitha kostot për ofrimin e shërbimit të lavanderisë dhe hotelerisë në SRMF, janë përgjegjësi dhe do të sigurohen nga vetë sipërmarrësi.

• Inventari i materialit të butë i shtratit të pacientëve dhe i veshjeve të personelit mjekësor janë në ngarkim të sipërmarresit dhe administrohen nga ai deri në përfundim të kontratës së shërbimit. Me përfundimin e kontratës së shërbimit, i gjithë inventari i butë në përdorim do të tërhiqet nga OE, vetëm kur të ndërrohet i gjithë stoku fillestar (me lidhjen e kontratës së radhës).

• Mardheniet financiare midis palëve, do të përcaktohen në momentin e lidhjes së kontratës.

- **Afatet e ekzekutimit: 24 (njëzetë e katër) Muaj, nga data e lidhjes së Kontratës.**

Kryerja e Shërbimit të Lavanderisë dhe Hotelerisë në pavionet SRMF

**Shtojca 7.**

**LOTI 2 ME OBJEKT: "SHERBIMI I LAVANDERISË DHE HOTELERISË PËR SPITALIN RAJONAL FIER"**

[ *Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor*]

**FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE**

**Specifikimet teknike të Menaxhimit të Proçesit të Lavanderisë**

1. Operatori ekonomik do të ofrojë shërbimin e tij, nga proçesi i lavanderisë deri tek kompletimi me inventarin e materialit të butë shtrimin/nderrimin e materialeve ne shtratin e pacientit/shtratin e mjekut roje.

2. Sipërmarrësi është i detyruar të disponojë të gjitha kapacitetet larëse dhe dezinfektuese, tharëse, hekurosëse dhe paketuese. Përveç kësaj, sipërmarrësi duhet të sigurojë për zëvendësimin e materialit të butë, nëse është i dëmtuar apo i amortizuar (sipas kohës së tyre të amortizimit dhe sipas nevojes).

3. Sipërmarrësi siguron inventarin e materialit të butë të nevojshëm, për një kompletim të rregullt sipas normave të shtratit që ka Spitali Rajonal Fier , me emërtimin/siglën përkatëse të institucionit kontraktues, datën e futjes së materialit të butë në përdorim në shërbimin mjekësor.

4. Sipërmarrësi do të lajë, dezinfektojë, thajë, paketojë, të transportojë dhe shpërndajë deri në pavion bazën e materialit të butë, si dhe të bëjë shërbimin e plotë deri tek shtrati i pacientit.

5. Rregullat e shtrimit të shtratit do të bëhen, sipas protokolleve të kujdesit infermieror, manualit të kujdesit spitalor, rregullave të higjienës me njoftimin e hapjes së kartelës së re të shtrimit nga K/inferm e shërbimit, si dhe sa herë të nevojitet nga shërbimi.

6. Larja dhe dezinfektimi, në repartin e lavanderisë do të bëhet në mënyrë të përqëndruar, duke respektuar të gjitha proçedurat dhe protokollet e higjienës, nga marrja në dorëzim e materialit të butë të papastër të ndarë sipas nëndarjeve dhe zonave të rrezikshmërisë (thasët me ngjyrë), tek dorëzimi i materialit të butë, të larë, të hekurosur dhe të paketuar sipas këtyre protokolleve, deri në shtrimin e shtratit të pacientit sipas protokolleve infermierore.

7. Procesi i lavanderise do te realizohet ne ambientet e operatorit ekonomik , ambientet te jene te vetat ose me qera **.**

**8**-Operatori i kontraktuar duhet të ofrojë shërbimin e grumbullimit të të gjithë materialit të butë të papastër në bazë të rregullores së parandalimit te infeksioneve nozokomiale, transportimin e tij në lavanderi, seleksionimin, larjen, hekurosjen, paketimin, transportimin sërisht mbrapsht

në Shërbime (ku materiali i larë nuk duhet të ketë kontakt me materialin e palarë për te shmangur infeksionet) , deri në shtrimin e shtratit te pacientit gjate 24 oreve për 7 (shtate) ditët e javes .

**9**- Punësimin e mjaftueshem të personelit për ofrimin e shërbimit:

10-Duke pasur parasysh natyren spitalore, është e domosdoshme dhe e rëndesishme, që materiali i butë per t'u larë duhet të tërhiqet sa më shpejt nga pavionet ose sallat e operimit , bazuar ne manualet e kujdeseve spitalore dhe rregullave të higjenës (selektimi sipas ndotjes së materialit të bute ne thasët me ngjyrë). Moslargimi në kohë i këtij materiali, do të conte në rritjen e infeksioneve spitalore me efekt final uljen e performances se ofrimit të shërbimit ndaj pacientëve, rritjen e ditëqëndrimit

- Grumbullimin e materialit të butë të papastër në të gjitha pavionet e Spitalit Rajonal Fier, sipas grafikëve të përcaktuar, rregullave dhe protokolleve të higjenës dhe manualeve të kujdesit spitalor;
- Larjen e materialit të butë;
- Hekurosjen dhe Paketimin e materialit të butë;
- Shpërndarjen e materialit të butë në të gjithë shërbimet e Spitalit Rajonal Fier, sipas grafikëve të përcaktuar;
- Shtrimin e shtratit të pacientit;
- Sigurimin e materialit të butë për shtratin e pacientit, personelin shëndetësor si dhe për sallat operatore sipas specifikimeve përkatëse

Larja e inventarit të materialit të butë, do të bëhet sipas frekuencave te percaktuara ne tabelen e meposhteme dhe sipas nevojes.

| Nr. | INVENTARI | Kellef dysheku e gomuar | Jasteke | Kellefe Jasteku | Carcafe Shtrati (poshte ) | Carcafe Shtrati (siper ) | Jorgan me Vatine (per periudhen qe perdoret) | Carcafi zarf (per periudhen qe perdoret) | Peshqire | Pizhama | Pandofla personeli /pacienti | Batanije per periudhen qe do te perdoren |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Frek/ ditore | Frek/ ditore | Frek/ ditore | Frek/ ditore | Frek/ ditore | Frek/ ditore | Frek/ ditore | Frek/ ditore | Frek/ ditore | Frek/ ditore | Frek/ ditore |
| 1 | Kirurgjia | 24- here ne vit | 4- here ne vit | 102 here ne vit | 102 here ne vit | 70 here ne vit | 1 here ne vit | 32 here ne vit | 102 here ne vit | 102 here ne vit | 2- here ne vit | 12 here ne vit |

| | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 2 | Pavioni I Patologjise | 12- here ne vit | 4- here ne vit | 102 here ne vit | 102 here ne vit | 70 here ne vit | 1 here ne vit | 32 here ne vit | 102 here ne vit | 102 here ne vit | 2- here ne vit | 12 here ne vit |
| 3 | Infektivi | 12- here ne vit | 4- here ne vit | 102 here ne vit | 102 here ne vit | 70 here ne vit | 1 here ne vit | 32 here ne vit | 102 here ne vit | 102 here ne vit | 2- here ne vit | 12 here ne vit |
| 4 | Pediatria+RNM Pediatri | 24- here ne vit | 4- here ne vit | 102 here ne vit | 102 here ne vit | 70 here ne vit | 1 here ne vit | 32 here ne vit | 102 here ne vit | | | 24 here ne vit |
| 5 | Pranim Urgjenca | 24- here ne vit | 4- here ne vit | 1 here ne dite | 1 here ne dite | 1 here dite | 2- here ne vit | 1 here ne dite | 1 here ne dite | | | 24 here ne vit |
| 6 | Pediatria Infektive | 24- here ne vit | 4- here ne vit | 102 here ne vit | 102 here ne vit | | | 32 here ne vit | 102 here ne vit | | | 24 here ne vit |

| | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | 70 here ne vit | 1 here ne vit | | | | | |
| 7 | ORL | 12- here ne vit | 4 here ne vit | 51here ne vit | 51 here ne vit | 35 here ne vit | 1 here ne vit | 16 here ne vit | 51 here ne vit | 51 here ne vit | 2- here ne vit | 4 here ne vit |
| 8 | okulistika | 12- here ne vit | 4 here ne vit | 51 here ne vit | 51 here ne vit | 35 here ne vit | 1 here ne vit | 16 here ne vit | 51 here ne vit | 51 here ne vit | 2 here ne vit | 4 here ne vit |
| 9 | Gjinekologji | 24 here ne vit | 4 here ne vit | 102 here ne vit | 102 here ne vit | 70 here ne vit | 1 here ne vit | 32 here ne vit | 102 here ne vit | | 2 here ne vit | 24 here ne vit |
| 10 | Obsetrika | 24 here ne vit | 4 here ne vit | 102 here ne vit | 102 here ne vit | 70 here ne vit | 1 here ne vit | 32 here ne vit | 102 here ne vit | | 2 here ne vit | 24 here ne vit |

| **SALLAT E OPERACIONIT** | **Frekuence** |
|---|---|
| Kostume jeshile | 1 here ne dite |
| Peshqire | 1 here ne dite |
| Carcaf i poshtem pacienti | 1 here ne dite |
| Carcaf i siperm barrele | 1 here ne dite |

| **MATERIALE TE BUTA PERSONEL MJEKSOR** | Frekuence |
|---|---|

| | |
|---|---|
| Perparese mjeku, reanim, infermiere | 51-here ne vit |
| Kostume mjeku, infermieri | 51-here ne vit |
| Peshqire | 102- here ne vit |
| Pandofla personeli | 2-here ne vit |

*Tërheqja dhe dorëzimi i inventarit të materialit të butë në pavione, do të bëhet me grafik të hartuar nga Sektori i Sherbimeve te Hotelerise së Spitalit Rajonal Fier. Grafiku është i detyruar të zbatohet nga të dyja palët, dhe në rastet e ndryshimit të tij, miratimi duhet të bëhet me nënshkrim po nga të dyja palët.*

*Përdorimi i inventarit të materialit të butë brënda pavionit, bëhet dhe mbetet nën përgjegjësinë e personelit të sipërmarrësit të kontrolluar nga autoriteti kontraktor, sipas proçedurave të mëposhtme:*

**Etapat e këtij proçesi çdo ditë:**

- Çdo ditë K/infermierja e pavionit ose personi i autorizuar prej saj, përpilon, siglon dhe dorëzon, kërkesën (Fletë Forcën e Pavionit) për ditën e nesërme për material të butë, duke cilësuar numrin shtrimeve të reja, të cilën e dorëzon brënda orës 12:00 tek Sektori i Sherbimeve te Hotelerise të Spitalit.

- Sektori i Sherbimeve te Hotelerise të Spitalit, në bazë të kërkesave ditore (fletëve të forcave të pavionit) dhe grafikut të pavioneve, harton evidencën ditore përmbledhëse ne total per gjithe Spitalin, dhe ia dorëzon sipërmarrësit brënda orës 13:00 për ditën pasardhëse.

- Peshimi dhe numërimi i materialit të butë të larë, të thatë, të hekurosur, si dhe të paketuar do të bëhet çdo ditë në ambjentet që do caktohen nga Autoriteti Kontraktor në momentin e lidhjes së kontratës, çdo ditë në orën 08:00 nën prezencën e përfaqësuesve të autoritetit kontraktor dhe përfaqësuesit të sipërmarrësit, duke mbajtur proçes-verbalin përkatës të firmosur nga palët. Ky dokument do ketë vlerë financiare, pasi likuidimi i operatorit ekonomikë do të bëhet mbi bazën e proçes verbaleve të nënshkruara nga palët për çdo ditë.
- Vetëm pasi të jetë peshuar dhe numëruar, materiali i butë është gati për tu shpërndarë nga Sipërmarrësi në shërbimet përkatëse, sipas kërkesave të shërbimit të bërë një ditë më parë.

- **Shpërndarja e materialit të butë** në pavione, do të bëhet nga sipërmarrësi çdo ditë pas orës 08:00 deri në orën 15.00, sipas grafikut të përpiluar nga Sektori i Sherbimeve te Hotelerise dhe miratuar nga palët.

- Sipërmarrësi ia dorëzon materialin e butë Kryeinfermierit të pavionit në bazë të grafikut të hartuar nga Sektori i Sherbimeve te Hotelerise. Për çdo rast, dorëzimi i materialit të butë do të bëhet vetëm pasi ky material i butë të jetë peshuar, numëruar dhe në momentin e dorëzimit do të mbahet proçesverbali i dorëzimit (ne kilograme) i firmosur nga të dyja palët, nga grupi i pritjes se mallit si dhe nga Kryeinfemieri i Pavionit/Shërbimit përkatës, në 3 (tre) kopje. Kryeinfermieri i pavionit dhe Grupi i pritjes se mallit bën kontrollimin për larjen,hekurosjen, cilësinë e materialit të butë dhe në rast konstatimi të materialit të butë difektoz ose të papastër, e kthen mbrapsht duke e pasqyruar në proçesverbal. Ky proçesverbal duhet të ketë të saktësuar numrin e materialit të butë të marrë në dorëzim nga Krye/infermieri i pavionit.

- K/infermierja e pavionit ose personi i autorizuar prej saj se bashku me grupin qe pret mallin, do të evidentojnë dhe konfirmojnë në mënyrë të vazhdueshme lidhur me shërbimin që kryhet, cilësinë dhe sasinë e kërkuar, si dhe për çdo parregullsi do të konfirmojne dhe informojne me shkrim në Sektorin eSherbimeve te Hotelerise te Spitalit.

- Tërheqja e materialeve të buta të ndotura nga pavioni, do të bëhet nga sipërmarrësi deri në orën 15.00, duke iu referuar rregullores në parandalimin e infeksioneve spitalore.

- Shërbimi do të ofrohet gjatë gjithë javës, prej ditës së hënës deri ditën e dielë, (operatori ekonomik duhet të sigurojë edhe materialin e butë për mbulimin e nevojave në pavion, dhe shtrimin e shtratit të pacientit, gjatë fundjavës) gjatë 8 orëve, ndersa per Sherbimet e Urgjences e Reanimacionit do te jete 24-oresh , edhe sipas kërkesës së Kryeinfermierit të pavionit në rast të ndryshimit të materialit të butë bëhet i domosdoshëm për pacientë të veçantë.

- Në të gjitha rastet, kur shërbimet kanë nevoja për material të butë shtesë, vetëm pas miratimit të kërkesës së shefit të shërbimit nga Sektori i Sherbimeve te Hotelerise, Sipërmarrësi do të proçedojë me dorëzimin e materialit të butë shtesë, të kërkuar nga shërbimi.

- Në raste të konstatimit të mungesave dhe/ose dëmtimit të materialit të butë për periudhën e lënë nën administrim e personelit të Spitalit , do të mbahet një procesverbal, të firmosur nga të dyja palët, një kopje e të cilit do të dorëzohet në sektorin e Sherbimeve te Hotelerise dhe sipërmarrësi do të bëjë menjëherë zëvendësimet përkatëse.

- Riparimi i materialit të butë të dëmtuar, bëhet nga sipërmarrësi duke ruajtur përmasat, dimensionet, përbërjen fillestare (të gjitha specifikimet teknike të materialit të butë).

- Sipërmarrësi detyrohet të zëvendësojë materialin e butë të vjetëruar në përdorim me material të butë të ri sipas jetëgjatësisë së çdo materiali të butë dhe sipas nevojes.

- Në të gjitha rastet kur sipërmarrësi dhe/ose autoriteti kontraktor konstatojnë material të butë të dëmtuar, të dy palët mbajnë një proçes verbal dhe më pas proçedohet me nxjerrjen nga përdorimi të këtij materiali të butë.

- Për raste të gjendjes së jashtëzakonshme, epidemive apo pandemive, lavanderia do të funksionojë sipas kushteve që do te vendos Drejtoria e Spitalit të Fier.

- Autoriteti kontraktor ka të drejtë të kontrollojë në prani të përfaqësuesit të sipërmarrësit, dhe të përpilojë akt kontrolle nga sektorë të ndryshëm të saj, në bazë të programeve të punës, për të evidentuar çdo parregullsi në lidhje me kryerjen e shërbimit, sasinë e materialit të butë të dorëzuar duke rakorduar dhe mbajtur procesverbale përkatëse të shërbimit.

- I gjithë materiali i butë në përdorim, me përfundimin e kontratës, i dorëzohet Spitalit Rajonal Fier pa kundërpagesë.

- Të gjitha kostot për ofrimin e shërbimit të lavanderisë dhe hotelerisë në Spitalin e Fier do të sigurohen nga vetë sipërmarrësi.

- Marrëdhëniet financiare midis palëve, do të përcaktohen në momentin e lidhjes së kontratës.
- Spitali i Fierit likujdon çdo muaj Sipërmarrësin, bazuar në sasinë e materialit të butë të thatë në kilogramë sipas proçesverbaleve ditore të peshimit,permbledheses mujore te larjes ne kilograme te hartuar nga grupi i punes ,si edhe përmbledhëses mujore te kerkesave te krye/infermiereve sipas forcës së pavionit, të hartuar nga Sektori i Sherbimeve te Hotelerise dhe të miratuar nga të dyja palët.

- Kur sipërmarrësi nuk bën ndërrimet e materialit të butë të shtratit të pacientit sipas afateve të përcaktuara, me ankesën me shkrim të shërbimit/pavionit, përfaqësuesi i Spitalit përpilon informacionin përkatës duke i bashkëngjitur një proçes – verbal, në bazë të të cilit vërtetohet se nuk është kryer shërbimi. Për çdo ditë, shtrati që nuk është ndërruar në afat, sipërmarrësi i mbahet vlefta e llogaritur e materialit të butë të thatë që nuk është ndërruar. Në rastet kur mungesa e shërbimit përsëritet, sipërmarrësi i paguan gjobë Spitalit , sa dhjetëfishi i vlerës së shërbimit të munguar të llogaritur në shërbim.

- Proces – verbalet për ndalesat dhe gjobat, i mbahen sipërmarrësit në pagesën mujore të radhës. Ato mund të kundërshtohen nga sipërmarrësi në Drejtorinë e Spitalit të Fier brënda muajit (30 ditë) vijues. Jashtë këtij afati, këto proçese do të quhen të pranuara nga palët.

- Personeli që punësohet nga sipërmarrësi në shërbimin e lavanderisë, brenda territorit të Spitalit, është i detyruar të zbatojë protokollet e kujdesit të higjienës, të kujdesit infermieror, si dhe rregulloren e Spitalit. Në rastet kur kjo shkelet, punonjësi përkatës largohet nga puna nga sipërmarrësi me kërkesën me shkrim të Drejtorisë së Spitalit, informacionit dhe proçes verbalit përkatës.

**Tabela : Sasia ne kg e kerkuar per tu prokuruar**

| Nr. | Pershkrimi i sherbimeve | Njesia | Sasia e larjeve te kerkuara per 36 muaj (kg) |
|---|---|---|---|
| I | Sherbimi i Lavanterise dhe Hotelerise ne Spitalin Rajonal Fier (**larja,dezinfektimi,tharja,paketimi ,transporti si edhe ndrimi i shtratit te pacientit .)** | Kg | **456 000** |

Pervec larjes operatori duhet te riperterije menjehere me lidhjen e kontrates materialin ekzistues sipas tabeles se meposhtme:

**II- Blloku Operator**

| Nr. | Emertimi | Njesia | Sasia | Frekuenca e zevendesimit (Jetegjatesia) |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Kostume ekipi **(**salla**)** | cope | 140 | 1 vit |
| 2 | Peshqire | cope | 140 | 1 vit |
| 3 | Çarçaf i poshtem pacienti | cope | 1100 | 6 muaj |
| 4 | Çarçaf i siperm barrele | cope | 1100 | 6 muaj |

**III - Sherbimet e tjera te Spitalit ne sasite e meposhtme :**

| Nr. | Emertimi | Njesia | Sasia | |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Kellefe jasteku | cope | 700 | 1 vit |
| 2 | Çarçaf shtrati i siperm | cope | 700 | 6 muaj |
| 3 | Çarçaf shtrati i poshtem | cope | 700 | 6 muaj |
| 4 | Çarçaf per femije | cope | 200 | 6 muaj |
| 5 | Mbulese e gomuar | cope | 350 | 1 vit |
| 6 | Mbulese e gomuar per krevate te vegjel | cope | 20 | 1 vit |
| 7 | Çarçaf zarf | cope | 250 | 1 vit |
| 8 | Çarçaf zarf per femije | cope | 100 | 1 vit |
| 9 | Peshqire (urgjence dhe kabineti ) | cope | 260 | 1 vit |
| 10 | Pizhama pacienti | cope | 150 | 1 vit |
| 11 | Perparese mjeku (mjek ne salle+reanimator+ farmaciste ) | cope | 190 | 1 vit |
| 12 | Kostume infermieri | cope | 410 | 1 vit |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 13 | Kostum Fizioterapeut | cope | 6 | 1 vit |
| 14 | Teknik imazherie | cope | 16 | 1 vit |
| 15 | Arketar + Reçepsionist | cope | 14 | 1 vit |
| 16 | Kordinator me Pacientin | cope | 10 | 1 vit |
| 17 | Psikolog+ punonjes social | cope | 4 | 1 vit |
| 18 | Kostume sanitare/kuzhiniere | cope | 145 | 1 vit |
| 19 | Pandofla personeli/pacienti | cope | 400 | 1 vit |
| 20 | Batanije per te rritur | cope | 250 | 2 ne 4 vjet |
| 21 | Batanije per te vegjel | cope | 100 | 2 ne 4 vjet |
| 22 | Jorgane me vatine | cope | 250 | 3 vjet |
| 23 | Jorgane me vatine te vegjel | cope | 100 | 3 vjet |

- **Normativat baze per sherbimin e lavanterise sipas udhezimit nr.141 date 08.03.2024 te MSHMS**
- Referuar standarteve dhe protokolleve per sherbimet spitalore ,ne vijim jane te detajuar lloji i materialit te bute qe do te kete per secilin pacient dhe qe do te lahet,materiali i bute per personelin mjekesor si edhe materiali i bute per bllokun operator .

1. **Material i bute i pacientt:**
- Carcafe shtrati (i poshtem, i siperm,zarf)
- Kellef jasteku
- Jastek krevati
- Pizhama pacienti
- Jorgan me vatine
- Kellef dysheku i gomuar
- Carcaf femijesh
- Batanije femijesh
- Batanije per te rritur
- Dyshek tek
- Dyshek per femije
- Dyshek per bebe
- Jorgane me vatine per te vegjel
- Pantofla pacienti

2. **Materiali i bute per sallat e operacionit:**
- Carcaf pacienti i poshtem
- Carcaf i siperm barrele
- Kostume ekipi (salle)
- Peshqire
- Pantofla

3. **Materiali i bute i personelit shendetesor:**
- Perparese mjeku (te bardha )
- Kostumet e personelit Mjekesor (infermier/ndihmes)
- Kostume te stafit
- Pantofla

**Ne zbatim te udhezimit nr.141 date 08.03.2024 me nr.1334/1 Prot. te MSHMS *nderrimi i shtratit te pacientit do te behet çdo tre dite ose dy here ne jave ,si dhe ne çdo rast qe kerkohet***

***nga kryeinfermieri i pavionit/sherbimit,si pasoje e shtrimit te pacienteve te rinj (me hapjen e karteles klinike ),ose ne rastet kur ndryshimi i shtratit behet i domosdoshem per te ruajtur dhe mbrojtur shendetin e pacientit .***

Ne tabelen ne vijim ,jepet e detajuar shpeshtesia e nderrimit te çarçafeve ne sherbimet e Spitalit :

| **Nr.** | ***Sherbimi*** | ***Shpeshtesia e Nderrimit te Çarçafeve*** |
|---|---|---|
| 1 | Patologji | 1x3 dite |
| 2 | Kirurgji | 1x dite te operuarit<br>1x3 dite &para operacionit dhe pas dites se dyte te operacionit |
| 3 | Reanimacioni | 1xdite |
| 4 | Pediatria | 1x3 dite |
| 5 | Reaminacioni i Pediatrise . | 1x dite |
| 6 | Infektivi | 1x3 dite |
| 7 | Urgjenca | Sa here te jete e nevojshme |
| 8 | Orl+ Okulistike | 1x3 dite |
| 9 | Gjinekologji | 1x3 dite |
| 10 | Obsetrike | 1x dite te operuarit<br>1x3 dite &para operacionit dhe pas dites se dyte te operacionit |
| 11 | Neonatologji | Sa here te jete e nevojshme |

**Baza materiale** (*Materiali i bute*)

| **Nr.** | **Emertimi** | **Komente** |
|---|---|---|
| 1 | Dysheke | Per te gjithe shtreterit |
| 2 | Dysheke femijesh | Per te gjithe shtreterit e vegjel |
| 3 | Dysheke bebesh | Per te gjithe shtreterit |
| 4 | Kllefe dysheku (mbulese e gomuar ) | Per te gjithe shtreterit |
| 5 | Kllefe dysheku per krevate te vegjel | Per te gjithe shtreterit e vegjel |

| | | |
|---|---|---|
| 6 | Çarçaf per shtratin i poshtem | Per çdo shtrat |
| 7 | Çarçaf per shtratin i siperm | 15 Maj deri ne 15 Shtator (Periudha pranvere – vere) |
| 8 | Jasteke | Per çdo shtrat |
| 9 | Kellefe jasteku | Per çdo shtrat |
| 10 | Çarçaf per femije | Per çdo shtrat te vogel |
| 11 | Jorgane me vatine | 16 Shtator- 14 Maj |
| 12 | Jorgane vatine te vegjel | 16 Shtator- 14 Maj |
| 13 | Çarçaf zarf | Per çdo shtrat 16 Shtator – 14 Maj (Periudha vjeshte – dimer ) |
| 14 | Çarçaf zarf per femije | Per çdo shtrat 16 Shtator – 14 Maj (Periudha vjeshte – dimer) |
| 15 | Batanije per te rritur | Vetem per postoperatoret dhe urgjencat |
| 16 | Batanije per te vegjel | Per bebet e porsalindura |
| 17 | Pizhama pacienti | Per te gjithe pacientet |
| 18 | Pandofla pacienti per adultet | Per te gjithe pacientet(Pa perfshire pacientet pediatrik) |
| 19 | Pandofla pacienti per Pediatrine | Per te gjithe pacientet e Pediatrise . |

| **SALLAT E OPERACIONIT** | **Shpeshtesia e nderrimit** |
|---|---|
| Kostume ekipi (salla) | 1 here ne dite |
| Peshqire urgjence dhe kabineti | 1 here ne dite |
| Carcaf i poshtem pacienti | 1 here ne dite |
| Carcaf i siperm barrele | 1 here ne dite |

| **MATERIALE TE BUTA PERSONEL MJEKSOR** | **Shpeshtesia e nderrimit** |
|---|---|
| Perparese mjeku, | 51-here ne vit |
| Kostume mjeku, infermieri | 51-here ne vit |
| Peshqire | 102- here ne vit |
| Pandofla personeli | 2-here ne vit |

- Nga tabela e përqindjes së zënies së shtreterve dhe nga koeficenti i përdorimit të shtratit të pacientit mbi te cilën eshte percaktuar edhe nr. e shtreterve qe duhet te kompletohen, operatori ekonomik duhet te ketë në gjëndje inventarin e materialit te butë sipas tabeles se treguar me poshte:

| **Nr.** | **Emertimi** | **Njesia** | **Inventar ne Perdorim** |
|---|---|---|---|
| 1 | Kostume jeshile | cope | 106 |
| 2 | Peshqire (personeli,pacienti) | cope | 337 |
| 3 | Carcaf i poshtem pacienti | cope | 261 |
| 4 | Carcaf i siperm barrele | cope | 260 |
| 5 | Dysheke | cope | 250 |
| 6 | Dyshek femijesh | cope | 33 |
| 7 | dyshek bebesh | cope | 46 |
| 8 | Jastek | cope | 353 |
| 9 | Kellefe jasteku | cope | 353 |
| 10 | Carcaf shtrati i siperm | cope | 694 |
| 11 | Carcaf shtrati i poshtem | cope | 694 |
| 12 | Carcaf per femije | cope | 164 |
| 13 | Mbules e gomuar | cope | 347 |
| 14 | Mbulese e gomuar per krevat te vegjel | cope | 0 |
| 15 | Jorgane me vatine | cope | 246 |
| 16 | Jorgan vatin te vegjel | cope | 67 |
| 17 | Carcaf zarf | cope | 213 |
| 18 | carcaf zarf per femije | cope | 34 |
| 19 | Pizhama pacienti | cope | 0 |
| 20 | Perparese mjeku /reanimator/farmacist | cope | 90 |

| | | | |
|---|---|---|---|
| 21 | Kostume mjeku/infermier/laborant | cope | 440 |
| 22 | Kostume sanitare/guzhinjere | cope | 80 |
| 23 | Pandofla personeli / pacienti | cope | 381 |
| 24 | Batanije per te rritur | cope | 206 |
| 25 | Batanije per te vegjel | cope | 61 |

- Përzgjedhja e jorganëve me vatinë, bën të domosdoshme përdorimin e çarçafëve zarf. Një fakt i tillë, gjatë sezonit të verës, lind domosdoshmërinë e mbulimit vetëm me çarçafë. Në këto kushte, është menduar që çarçafët zarfë të përdoren për 8 (tetë) muaj, ndërsa për periudhën nga 15 Maj deri në 15 Shtator(periudha pranvere – vere), të përdoren çarçafë per shtratin i siperm , pra 4 (katër) muaj, për pasojë çarçafët e poshtem për shtratin do të përdoren për 12 muaj, ndërsa çarçafët e sipërm do të përdoren për 4 muaj, ndersa çarçafët zarf për 8 muajt e tjerë.
- Po keshtu batanijet do te perdoren vetem per postoperatoret dhe urgjencat (sipas nevojave) .

**Nevojat per inventar per materialin e bute per Sallat operative**

Nevoja per inventar per sallat e operacionit eshte vleresuar duke u bazuar ne numrin total te operacioneve te kryera ne vitin 2022- 2023, sipas te dhenave te sherbimit te statistikes te ndare ne sherbime, si dhe historikut te qarkullimit te materialit te bute per periudhen 2020 – 2022 ne keto salla.

Duhet te mbahet parasysh qe cdo ekip operacioni duhet te kete gjithmone komplete rezerve per cdo mundesi te shtimit te fluksit te paparashikueshem.Per bllokun operator (ku operacione kryhen nga e hena ne te premte pra 5 dite te javes) per cdo operacion (mesatarisht 5 cope ne dite) sasia e inventarit te parashikuar eshte bere ne kete forme: nje komplet te jete ne perdorim nje komplet te jete rezerve per cdo event dhe nje te jete ne lavanteri.

Perllogaritja e numrit mesatar te operacioneve eshte bere mbi bazen e te dhenave te statistikes se SRF-se per vitin 2022-2023.

Nisur nga numri total i operacioneve si dhe perberjen e ekipeve qe kryejne nderhyrjet kirurgjikale (5 persona nga te cilet 3 mjeke dhe 2 infermiere) dhe frekuencen e daljes nga perdorimi i materialit qe do te perdoret ne keto salla, nevojat per inventaret ne sallat e operacionit do te jete:

| **Nr** | **Emertimi** | **Njesia** | **sasia per ekip per operacion** | **Frekuenca e zvendesimit** | **Sasia totale ne vit( bllok operator)** |
|---|---|---|---|---|---|

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Kostume ekipi (salla) | cope | 5 per ekip salle (mjek+infermier) | 1- vit | **140** |
| 2 | Peshqire | cope | 5 per ekip salle (mjek+infermier) | 1- vit | **140** |
| 3 | Carcaf i poshtem pacienti | cope | 1 | 6 - muaj | **1100** |
| 4 | Carcaf i siperm barrele | cope | 1 | 6 - muaj | **1100** |

**Nevojat per inventar per materialin e bute per personelin mjeksore dhe personelin ndihmes**

Nevojat per inventare per materialin e bute per personelin mjekesor (mjek, kryeinfermiere,infermier etj), jane llogaritur mbi bazen e numrit qe ka sot Spitali sipas struktures analitike te miratuar me shkresen nr.366 prot. urdher nr.32, date 23.01.2023 te miratuar nga MSHMS. Duke patur parasysh qe personelit shendetesor do i jepen 2 perparese, 2 kostume dhe 2 peshqire, 1 pale shapka me nje norme zvendesimi nje here ne vit, operatori ekonomik duhet te plotesoje nevojat per inventare te materialit te bute te personelit shendetesore.

| **Nr** | **Emertimi** | **Njesia** | **Inventare ne perdorime** | **Frekuenca e zvendesimit** | **Sasia totale ne vit** |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Perparese mjeku | cope | 90 | 1- vit | **190** |
| 2 | Kostume infermieri | cope | 427 | 1- vit | **410** |
| 3 | Kostume fizioterapeut | cope | 3 | 1- vit | **6** |
| 4 | Kostum teknik imazherie | cope | 8 | 1- vit | **16** |
| 5 | Kostum kordinator me pacientin | cope | 0 | 1- vit | **10** |
| 6 | Psikolog +punonjes social | cope | 2 | 1- vit | **4** |
| 7 | Kostum reçepsionist/arketar | cope | 0 | 1- vit | **14** |
| 8 | Kostume sanitare/guzhiniere | cope | 80 | 1- vit | **145** |
| 9 | Peshqire | cope | 250 | 1- vit | **260** |
| 10 | Pandofla personeli/pacienti | cope | 381 | 1 - vit | **400** |

**Shenim : Perparese mjeku (mjeke ne salle+reanimator+farmaciste )**

| SPECIFIKIMET TEKNIKE TË MATERIALIT TË BUTË PËR PACIENTIN | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Emërtimi** | **Njësia** | **Specifikimet Teknike** | **Dimensionet** | **Lloji i materialit** |
| **Çarçafe shtrati i poshtem** | copë | 160-180gr/m², Me qepje nga të katërta anët. Ngjyrë sipas kerkeses se autoritetit kontraktor. Logoja e Spitalit të SRF-së me emërtesën me ngjyrë sipas kërkesës së autoritetit kontraktor, datën e futjes në materialit të butë në përdorim në shërbimin mjekësor. | 260x160 cm | 100 % pambuk |
| **Çarçafe shtrati i Siperm** | copë | 160-180gr/m²,, Me qepje nga të katërta anët. Ngjyrë sipas kerkeses se autoritetit kontraktor. Logoja e Spitalit të SRF-së me emërtesën me ngjyrë sipas kërkesës së autoritetit kontraktor, datën e futjes në materialit të butë në përdorim në shërbimin mjekësor. | 240x160 cm | 100 % pambuk |
| **Carcaf fanellat per femije** | | Te jete material fanellat 100% pambuk ngjura sipas kerkeses se auorittit kontraktor Logoja e Spitalit të SRF-së me emërtesën me ngjyrë sipas kërkesës së autoritetit kontraktor, datën e futjes në materialit të butë në përdorim në shërbimin mjekësor. | 150*100 | 100% pambuk |
| **Këllëf dysheku (mbulesë e gomuar)** | copë | Material nga njera ane pambuk dhe nga ana tjeter e gomuar impermeable (e papershkueshem nga uji) me permasa 200 x90 cm qepje me llastik per te futur dyshekun , te datën e futjes në materialit të butë në përdorim në shërbimin mjekësor. Logo SRF.. me emërtesën sipas kërkesës së autoritetit kontraktor, | 200x90 | 100 % pambuk + material i gomuar |
| **Kellefe dysheku per femije (mbulese e gomuar per krevate te vegjel )** | cope | Material nga njera ane pambuk dhe nga ana tjeter e gomuar impermeable (e papershkueshem nga uji) me permasa 200 x90 cm qepje me llastik per te futur dyshekun , te datën e futjes në materialit të butë në përdorim në shërbimin mjekësor. Logo SRF.. me emërtesën sipas kërkesës së autoritetit kontraktor, | 100x50 | 100 % pambuk + material i gomuar |
| **Këllëf Jastëku** | copë | Mbulesë dyshe, ku nga njëra anë ka një të çarë si xhep, për të lejuar futjen e jastëkut. Ngjyrë e bardhë. 160 – 180 gr/m2. Logo SRF me emërtesën sipas kërkesës së autoritetit kontraktor, datën e futjes në materialit të butë në përdorim në shërbimin mjekësor. | 50x80 cm | 100 % pambuk |
| **Carcaf Zarf** | cope | Ngjyrë e sipas kerkeses se autoritetit kontraktor. Logoja SRF me emërtesën me ngjyrë sipas kërkesës së autoritetit kontraktor, datën e futjes në materialit të butë në përdorim në shërbimin mjekësor. | 220 x 160 cm | 100 % pambuk |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Carcaf zarf per te vegjel** | cope | Ngjyrë e sipas kerkeses se autoritetit kontraktor. Logoja SRF me emërtesën me ngjyrë sipas kërkesës së autoritetit kontraktor, datën e futjes në materialit të butë në përdorim në shërbimin mjekësor. | 120x190cm | 100% pambuk |
| **Pizhama Pacienti** | copë | Pizhama komplet (bluze +pantallona) , material i trikotuar i plote njëngjyrëshe ,pesha 350 gr/m2 , pantallonat me llastik , xhaketa me jake kemishe ose jake V, me mëngë të gjata të gjëra, masat (XS, S,M, L, XL, XXL) me kopsa perpara dhe dy xhepa. Specifikat e me siperme - sipas kërkesës së autoritetit kontraktor. Me logon e Spitalit te SRF si dhe datën e futjes në materialit të butë në përdorim në shërbimin mjekësor. | Gjatësia sipas kërkesës së autoritetit kontraktor. | Materiali i trikotuar |
| **Pandofla Personeli dhe Pacienti** | copë | Pandofla për përdorim spitalor, material plastic, me gome poroze me ngjyra te ndryshme, e mbyllur nga përpara dhe me vrima për ajrosje, e paisur me një shtresë ortopedike për të lehtësuar qëndrimin për kohë të gjatë në këmbë. Materiali të jetë antirrëshkitës, rezistentë ndaj gërryerjes dhe vajit, si dhe i padepërtueshëm nga uji.Ngjyra sipas kërkesës së autoritetit kontraktor. | Numrat e pandoflave sipas kërkesës së autoritetit kontraktor. | Materiali të jetë plastic, antirrëshkitës, rezistentë ndaj gërryerjes dhe vajit, si dhe i padepërtueshëm nga uji |
| **Batanije per te rritur** | cope | Duhet te sigurojne ngrohtesi dhe rehati .Batanijet duhet te jene higjenike ,te buta,te rehatshme qe te lahen e sterilizohen lehtesisht. | 220x140 cm | Te jete material 60% lesh dhe 40% akrilik . |
| **Batanije per te vegjel** | cope | Duhet te sigurojne ngrohtesi dhe rehati .Batanijet duhet te jene higjenike ,te buta te rehatshme qe te lahen e sterilizohen lehtesisht. | 120x100cm | Te jete material 60 % lesh dhe 40 % akrilik |
| **Jorgane me vatine** | cope | Me mbushje me vatine ,me tegela ndarese ne forme kuadrati,veshja e jashtme me material pambuku ,ngjyre sipas kerkeses se Autoritetit Kontraktor | 140x180cm | |
| **Jorgane me vatine per te vegjel** | cope | Me mbushje me vatine ,me tegela ndarese ne forme kuadrati ,veshja e jashtme me material pambuku ,ngjyre sipas kerkeses se Autoritetit Kontraktor. | 100x150cm | |
| **Peshqire personeli / pacienti** | cope | Material pambuku, ngjyre e bardhe me logon e SRF-se si si dhe datën e futjes në materialit të butë në përdorim në shërbimin mjekësor. | 80x50cm | 100% pambuk, |
| **Dysheke tek spitalor** | cope | Dysheku te jete njetrajtshem (pa ndarje),perberja nga brenda me dy shtresa vatine te forte ku nga njera ane te kete porozitet per qarkullim e ajrit dhe I veshur nga jashte me mbulese te forte te padepertueshme injifugo(kunder zjarrit ) antibakteriale dhe antialergjike .Te kete te shenuar daten e futjes se materialit ne | 190x90x10cm | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | perdorim ,ngjyra sipas kerkeses se autoritetit Kontraktor. | | |
| **Dyshek per femije** | cope | Dysheku te jete njetrajtshem (pa ndarje),perberja nga brenda me dy shtresa vatine te forte ku nga njera ane te kete porozitet per qarkullim e ajrit dhe I veshur nga jashte me mbulese te forte te padepertueshme injifugo(kunder zjarrit ) antibakteriale dhe antialergjike .Te kete te shenuar daten e futjes se materialit ne perdorim ,ngjyra sipas kerkeses se autoritetit Kontraktor. | 100x50x10 cm | |
| **Dysheke per bebe** | cope | Dysheku te jete I njetrajtshem (pa ndarje),perberja nga brenda me dy shtresa vatine te forte ku nga njera ane te kete porozitet per qarkullim e ajrit dhe I veshur nga jashte me mbulese te forte te padepertueshme injifugo(kunder zjarrit ) antibakteriale dhe antialergjike .Te kete te shenuar daten e futjes se materialit ne perdorim ne sherbimin mjekesor ,ngjyra sipas kerkeses se autoritetit kontraktor. | 72x42x5cm | |
| **Jastek** | cope | Mbushje uniforme me fibra sintetike ,ngjyre e bardhe ,daten e futjes se materialit te bute ne perdorim ne sherbimin mjekesor. | 40x80cm | Fibra sintetike |

| **Uniformat e standartizuara per personelin mjekesor sipas udhezimit nr. 1334/1 prot me nr. 141 date 08.04.2024 te MSHMS.** | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Emërtimi** | **Njësia** | **Specifikimet Teknike** | **Dimensionet** | **Lloji i materialit** |
| **Përparëse Mjeku (Unisex)Ngjyra e bardhe** | copë | Me menge te gjata ,me kopsa me perçina ,dhe dy xhepe anash ,me ngjyren e bardhe ,me logon MSHMS dhe emertesen e institucionit (sipas modelit ),pjesa e mbrapme me te çare . | S,M,L,XL,XXL | Perzierje 65% pambuk dhe 35 % polyester. |
| | | | | Larje ne $60^0$ |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Kostume Infermieri** *(Bluze me pantallona unisex)* *(Gjate dimrit vishet bluze e bardhe me menge te gjata poshte kostumit )* | copë | Bluze me jake V te trashe, me menge te shkurtra ( treçerekshe ) dhe dy xhepa anesore poshte me ngjyren sipas llojit te sherbimit dhe me logon MSHMS dhe emertesen e institucionit(sipas modelit)<br><br>**Infermier Pavioni** :Ngjyra boje qielli e hapur<br><br>**Mjek dhe infermier urgjence ,mjek dhe infermier blloku operator,** Ngjyra blu e erret.<br><br>**Mjek dhe infermier reanimacioni** : ngjyre jeshile e erret .<br><br>**Infermier Pediatrie** : Bluze me kukulla dhe pantallona ngjyre boje qielli.<br><br>**Infermier Urgjence ,reanimacion Pediatrie** : bluza me kukulla dhe pantallona ngjyre lejla e erret.<br><br>**Teknik laboratori:** Bluza ngjyre e bardhe dhe pantallonat ngjyre blu e erret.<br><br>**Teknik imazherie** : Bluza dhe Pantallonat Ngjyre Gri. | S, M, L, XL,XXL | Perzierje 65% pambuk dhe 35 % polyester. |
| **Kostume Sanitare** (Bluze dhe pantallona unisex ) (*Gjate dimrit vishet bluze e bardhe me menge te gjata poshte kostumit )* | **copë** | Bluza me jake V te trashe, me menge te shkurtra ( treçerekshe ) dhe dy xhepa anesore poshte, me logon MSHMS dhe emertesen e institucionit.<br><br>Bluza dhe pantallonat me ngjyren vishnje te erret (sipas modelit) | S,M, L, XLXXL . | Perzierje 65% pambuk dhe 35 % polyester. |
| **Kostume personeli ndihmes (Barrelambajtes )bluze dhe pantallona unisex(***gjate dimrit vishet bluze e bardhe me menge te gjata poshte kostumit )* | **cope** | Bluza me jake V te trashe, me menge te shkurtra ( treçerekshe ) dhe dy xhepa anesore poshte 180gr.m$^2$ me logon MSHMS dhe emertesen e institucionit.Bluza dhe pantallonat me ngjyren e bardhe . | S,M, L, XLXXL | Perzierje 65% pambuk dhe 35 % polyester. |

## Kostum Fizioterapeut

Perzierje 65% pambuk dhe 35 % polyester .Bluza me 3 komça (Tshirt- polo), me menge te shkurtra,me logon MSHMS ne te djathte te tshirt dhe emertesen e institucionit ne ngjyren e bardhe .Pantallonat (tuta)ngjyre blu e erret ose e zeze.

(*Gjate dimrit vishet bluze tute me menge te gjata*)

## Kostum Reçepsionist /Informacioni

Pantallona te zeza ,kemishe e bardhe me shalle me logon e MSHMS.

(*Gjate dimrit vishet xhakete e zeze ose triko e zeze*)

## Kordinator me Pacientin

Pantallona te zeza,Tshirt polo ngjyre gri ,me tre komça,me logon e MSHMS ne te majte .

(*Gjate dimrit vishet xhakete e zeze ose triko e zeze)*

## Badge

Perveç larjes operatori duhet te riperterije materialin ekzistues sipas tabeles se meposhtme :

| Nr. | Emertimi | Njesia | Sasia e inventarit gjendje ne SRF | Sasia ndihme | Sasia qe duhet te blihet vitin e pare | Sasia qe duhet te blihet vitin e dyte | Sasia qe duhet te blihet vitin e trete | Frekuenca e zevendesimit |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Kostume ekipi **(**salle**)** | cope | 106 | 0 | 140 | 140 | 140 | 1-vit |
| 2 | Peshqire (urgjence dhe kabineti ) | cope | 337 | 0 | 400 | 400 | 400 | 1-vit |
| 3 | Çarçaf i poshtem pacienti | cope | 261 | 0 | 1100 | 1100 | 1100 | 6 - muaj |
| 4 | Çarçaf i siperm barrele | cope | 260 | 0 | 1100 | 1100 | 1100 | 6- muaj |
| 5 | Dysheke | cope | 250 | 0 | 0 | 300 | 0 | 5- vjet |
| 6 | Dysheke femijesh | cope | 33 | 0 | 0 | 20 | 0 | 5-vjet |
| 7 | Dysheke bebesh | cope | 46 | 0 | 0 | 45 | 0 | 5-vjet |
| 8 | Jasteke | cope | 353 | 0 | 300 | 0 | 0 | 5-vjet |
| 9 | Kellefe jasteku | cope | 353 | 0 | 700 | 700 | 700 | 1-vit |
| 10 | Çarçaf shtrati i siperm | cope | 694 | 0 | 700 | 700 | 700 | 6- muaj |
| 11 | Çarçaf shtrati i poshtem | cope | 694 | 0 | 700 | 700 | 700 | 6- muaj |
| 12 | Çarçaf per femije | cope | 164 | 0 | 200 | 200 | 200 | 6- muaj |
| 13 | Mbulese e gomuar | cope | 347 | 0 | 350 | 350 | 350 | 1-vit |
| 14 | Mbulese e gomuar per krevate te vegjel | cope | 0 | 0 | 20 | 20 | 20 | 1-vit |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 15 | Jorgane me vatine | cope | 246 | 0 | 250 | 0 | 0 | 3-vit |
| 16 | Jorgane vatine te vegjel | cope | 67 | 0 | 100 | 0 | 0 | 3-vit |
| 17 | Çarçaf zarf | cope | 213 | 0 | 250 | 250 | 250 | 1-vit |
| 18 | Çarçaf zarf per femije | cope | 34 | 0 | 100 | 100 | 100 | 1-vit |
| 19 | Perparese mjeku | cope | 90 | 0 | 190 | 190 | 190 | 1-vit |
| 20 | Kostume infermieri | cope | 427 | 0 | 410 | 410 | 410 | 1-vit |
| 21 | Kostume sanitare/kuzhiniere | cope | 80 | 0 | 145 | 145 | 145 | 1-vit |
| 22 | Kostume fizioterapeut | cope | 3 | 0 | 6 | 6 | 6 | 1-vit |
| 23 | Kostum teknik imazherie | cope | 8 | 0 | 16 | 16 | 16 | 1-vit |
| 24 | Kostum Koordinator me pacientin | cope | 0 | 0 | 10 | 10 | 10 | 1-vit |
| 25 | Psikolog +punonjes social | cope | 2 | 0 | 4 | 4 | 4 | 1-vit |
| 26 | Kostum reçepsionist/arketar | cope | 0 | 0 | 14 | 14 | 14 | 1-vit |
| 27 | Pandofla personeli/pacienti | cope | 381 | 0 | 400 | 400 | 400 | 1-vit |
| 28 | Batanije per te rritur | cope | 206 | 50 | 250 | 0 | 0 | 2 ne 4 vjet |
| 29 | Batanije per te vegjel | cope | 61 | 0 | 100 | 0 | 0 | 2 ne 4 vjet |
| 30 | Pizhama pacienti | cope | 0 | 0 | 150 | 150 | 150 | 1-vit |

**V -Numri total i shtreterve sipas urdherit te Drejtorise se Spitalit Rajonal Fier nr.5029/1 date 07.10.2022 qe duhen te pajisen me baze materiale dhe qe duhet te jene te mbuluar nga sherbimi i lavanderise eshte si me poshte :**

| NR. | EMERTIMI I SHERBIMIT | Numri i shtreterve |
|---|---|---|
| 1 | SHERBIMI URGJENCE-PRANIMI NE SPITAL | 15 |
| 2 | SHERBIMI I KIRURGJISE | 37 |
| 3 | PAVIONI I REAMINACIONIT TE KIRURGJISE | 7 |
| 4 | SHERBIMI I PATOLOGJISE | 39 |
| 5 | PAVIONI I INFEKTIVIT TE TE RRITURVE | 27 |
| 6 | OKULISTIKE | 7 |
| 7 | ORL | 6 |
| 8 | REPARTI I PEDIATRISE SE PERGJITHSHME +RNM PEDIATRI | 64 |
| 9 | PAVIONI I PEDIATRISE INFEKTIVE | 20 |
| 10 | PAVIONI I GJINEKOLOGJISE | 16 |
| 11 | PAVIONI I OBSETRIKES | 57 |
| 12 | PAVIONI I NEONATIT | 45 |
| 13 | SHERBIMI PALIATIV | 5 |

| | | |
|---|---|---|
| | **TOTALI** | **345** |

**Shërbimi që kërkohet: Sherbimi i Lavanterise dhe Hotelerise ne Spitalin Rajonal Fier**

Operatori ekonomik privat që do të kontra ktohet, duhet të ofrojë një shërbim i cili do të përfshijë:

- Grumbullimin e materialit të butë të papastër në të gjitha pavionet e Spitalit Rajonal Fier, sipas grafikëve të përcaktuar, rregullave dhe protokolleve të higjenës dhe manualeve të kujdesit spitalor;
- Larjen e materialit të butë;
- Hekurosjen dhe Paketimin e materialit të butë;
- Shpërndarjen e materialit të butë në të gjithë shërbimet e Spitalit Rajonal Fier, sipas grafikëve të përcaktuar;
- Shtrimin e shtratit të pacientit;
- Sigurimin e materialit të butë për shtratin e pacientit, personelin shëndetësor si dhe për sallat operatore sipas specifikimeve përkatëse

Shërbimi do të ofrohet 24 ore gjatë 7 (shtate) diteve te javës, (operatori ekonomik duhet të sigurojë edhe materialin e butë për mbulimin e nevojave në pavion, dhe shtrimin e shtratit të pacientit) sipas grafikut të përcaktuar për ndryshimin periodik të materialit të butë në shërbimet përkatëse, dhe sipas kërkesës së Kryeinfermiereve të pavionit në rast të ndryshimit të materialit të butë kur bëhet i domosdoshëm për pacientë të veçantë.

**Shtojca 8**

## LOTI 1 ME OBJEKT: "SHËRBIM I LAVANDERISË PËR PACIENTËT E HOSPITALIZUAR NË PAVIONET E SPITALIT MEMORIAL FIER"

(*Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)*

*(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit*)

## FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

**Shërbimi që kërkohet:**

| ***1*** | ***2*** | ***3*** |
|---|---|---|
| **Artikulli** | **Përshkrimi i shërbimit** | **Sasia totale e materialit te butë (në kg) per 24 muaj** |
| 1. | Shërbimi i lavanderisë dhe hotelerisë për pacientët e hospitalizuar në pavionet e Spitalit Memorial Fier | **241,000** |

**Afatet e ekzekutimit:** 24 (njëzet e katër) Muaj, nga data e lidhjes së Kontratës, brenda afatit të marreveshjes kuadër.

**Shtojca 8**

**LOTI 2 ME OBJEKT: "SHERBIMI I LAVANDERISË DHE HOTELERISË PËR SPITALIN RAJONAL FIER"**

(*Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)*

*(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit*)

**FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT**

Shërbimi që kërkohet:

| ***1*** | ***2*** | ***3*** |
|---|---|---|
| **Artikulli** | **Përshkrimi i shërbimit** | **Sasia totale e materialit te butë (në kg)** |
| 1. | Shërbimi i lavanderisë dhe hotelerisë për Spitalin Rajonal Fier. | **456,000** |

**Afatet e ekzekutimit:** 36 (tridhjete e gjashte) Muaj, nga data e lidhjes së Kontratës, Brenda afatit të marreveshjes kuadër.

**Shtojca 9**

## LOTI 1 ME OBJEKT: "SHËRBIM I LAVANDERISË PËR PACIENTËT E HOSPITALIZUAR NË PAVIONET E SPITALIT MEMORIAL FIER"

## TERMAT E REFERENCËS

- **Rregullat për qarkullimin e materialit të butë në pavionet e SRMF-së, për parandalimin, eliminimin e infeksioneve spitalore.**

Rregullat për eleminimin e infeksioneve spitalore, mbështeten në manualet e kujdesit spitalor, në manualet e parandalimit të infeksionit nozokomial, në rregullat e higjenës, në ligjin e inspektoriatit sanitar shtetëror, në protokollet e kujdesjeve infermierore si dhe në praktikat më të mira të spitaleve te bashkimit europian, në shërbimin dhe kujdesin spitalor.

- **Përshkrimi:**

Personeli i sipërmarrësit, që kryen proçedurat si në shtrimin e shtratit të pacientit ashtu dhe në tërheqjen e materialeve të ndotura, duhet të ketë veshje identifikuese, të njohur nga autoriteti kontraktor. Ai duhet të zbatojë protokollin e kujdesit infermieror në shtrimin e shtratit të pacientit, si dhe rregullat e higjenës.

Ndarja e materialeve bëhet mbas çdo ndërrimi të shtratit, gjatë proçesit të larjes apo kujdesit ndaj pacientit.

Materiali i butë duhet të manipulohet me doreza josterile një përdorimshe, ai nuk duhet transportuar duke e mbajtur në dorë nga personeli apo lënë në tokë.

Mbledhja e materialeve të papastra, do të bëhet në një vend të përcaktuar nga shërbimi, autoriteti kontraktor, në thaset identifikues me ngjyrën dhe siglën përkatëse të llojit të materialit të ndotur, të cilët do të qëndrojnë aty deri në momentin e dorëzimit.

Thasët e rrobave mbushen deri në 2/3, mbyllen krejtësisht dhe vendosen në dhomën apo vendin e parashikuar në shërbim për depozitimin e materialeve. Evakuimi duhet të bëhet sa më shpejt të jetë e mundur.

Thasët nuk duhet të tërhiqen mbi dysheme.

Karroca e materialeve, shërben për mbajtjen e thasëve me ngjyra, për depozitimin e materialeve të ndotura nga një shtrat në tjetrin. Karroca është e paisur me rrota dhe e ndarë me thasët specifike me ngjyrë me siglën përkatëse identifikuese.
Karroca e materialeve, nuk futet në dhomën e të sëmurit. Në momentin e ndërrimit të pacientit, largo çdo objekt duke bërë kujdes për aparatet dentare, auditiv, stilolaps apo tjeter material prerës.

Sipërmarrësi tërheq nga pavioni inventarin e mbyllur me thasët me ngjyra të percaktuara sipas zonave dhe normave higjeno-sanitare, për larje dezinfektim nga personi i autorizuar klinika - k/infermieri/ja, dhe në të njëjtën kohë dorëzon në pavion inventarin e pastër të hekurosur dhe të paketuar. Inventari që merret ose dorëzohet, është gjithmonë i palosur dhe i paketuar.

- **Veshjet e punës së personelit shëndetësor:**

Veshjet e personelit shëndetësor të ndotura, me xhepat e zbrasur vendosen në thesin që ndodhet tek dhoma e zhveshjes së personelit.

- **Rast i veçantë i materialit të kontaminuar "me rrezik mikrobiologjik":**

Ky material vendoset fillimisht në një qese plastike dhe më pas në një thes rrobash të verdhë: material i kontaminuar me gjak apo lëngje biologjike.

E njëjta procedurë do të zbatohet edhe per materialin e kontaminuar (salmonela, shigela, viruse intestinale, chlostridium difficile) apo kur vihet re prania e  paraziteve si cimka, morra etj.

- **Rast i veçantë i materialit të kontaminuar nga një pacient pas ekzaminimit në mjeksinë nukleare:**

Vendosni materialin e kontaminuar në qese plastike, ruajeni në tualetin e pacientit, lajmëroni shërbimin e radiombrojtjes (nëpërmjet QKU), për të kostatuar nivelin e uljes së radioaktivitetit, përpara eleminimit në një thes të verdhë.

Materialet e tjera do të vendosen në thes blu, me siglën **"material i pisët".**

- **Qarkullimi:**

Mbledhja e materialit të ndotur kryhet nga një punëtor/sanitar i shërbimit çdo mëngjes.

Shpërndarja e materialit të pastër për hospitalizim dhe veshjet e punës, bëhet në çdo shërbim nga personeli i autorizuar nga sipërmarrësi.

Në asnjë rast materialet nuk hidhen nga shërbimet.

- **Përkujdesje:**

Lani duart në çdo ndërrim shtrati nëpërmjet kësaj proçedure: Kryeni një larje të thjeshtë dhe më pas një fërkim hidroalkolik të duarve, pasi të keni manipuluar me materialet e pista.
Lani çdo ditë karrocat e mbajtjes së thasëve të materialit të ndotur, mos lani asnjëherë materialet në shërbim, si dhe mos merrni asnjëherë material për t'a larë në shtëpi.

• Thasët e thurrur, me ngjyrat e poshtëshënuara dhe me siglën përkatëse, vendosen në një mbajtës me rrota (karrocë), dhe administrohen nga **Sipërmarrësi**.

• Thasët e Verdhë "**material i kontaminuar**"-vendoset çarçafët, këllëfat e jastëkut, pizhamkëmishat e të sëmurëve.

• Thasët Blu- **materiali i kontaminuar, nga një pacient pas ekzaminimit në mjeksinë nukleare.**

• Thasët Jeshilë- **material i konsideruar "me rrezik mikrobiologjik"**

• Thastët Gri – veshjet e personelit shëndetësor ndihmës (sanitare, barrelambajtës, etj), pantallona dhe bluza.

- Thasët Vishnje (Bordeaux) – mbulesa, mbrojtëse dysheku, bluza pambuku.
- Thasët Blu – “**material i pisët**”

Shperndarja: SRMF FIER

Vendi dhe dorëzimi i shërbimeve: **SRMF FIER**

**Shtojca 9**

## LOTI 2 ME OBJEKT: “SHERBIMI I LAVANDERISË DHE HOTELERISË PËR SPITALIN RAJONAL FIER”

### FORMULARI I TERMAVE TË REFERENCËS

**Rregullat per Qarkullimin e materialit te Bute ne pavionet e Spitalit Rajonal Fier, per parandalimin, eliminimin e infeksioneve Spitalore.**

Rregullat per eleminimin e infeksioneve spitalore, mbeshteten ne manualet e kujdesit spitalor, ne manualet e parandalimit te infeksionit nozokomial, ne rregullat e higjenes, ne ligjin e inspektoriatit sanitar shteteror, ne protokollet e kujdesjeve infermierore si dhe ne praktikat me te mira te spitaleve te bashkimit europian, ne sherbimin dhe kujdesin spitalor.

**Pershkrimi:**

Personeli i sipermarresit, qe kryen procedurat si ne shtrimin e shtratit te pacientit ashtu dhe ne terheqjen e materialeve te ndotura, duhet te kete veshje identifikuese, te njohur nga autoriteti kontraktor. Ai duhet te zbatoje protokollin e kujdesit infermieror ne shtrimin e shtratit te pacientit, si dhe rregullat e higjenes.

Në rastet kur kjo shkelet, punonjësi përkatës largohet nga puna nga sipërmarrësi me kërkesën me shkrim të Drejtorisë së Spitalit Rajonal Fier, informacionit dhe proçes verbalit përkatës

Ndarja e materialeve behet mbas cdo nderrimi te shtratit, gjate procesit te larjes apo kujdesit ndaj pacientit.

Materiali i bute duhet te manipulohet me doreza josterile nje perdorimshe, ai nuk duhet transportuar duke e mbajtur ne dore nga personeli apo lene ne toke.

Mbledhja e materialeve te papastra, do te behet ne nje vend te percaktuar nga sherbimi, autoriteti kontraktor, ne thaset identifikues me ngjyren dhe siglen perkatese te llojit te materialit te ndotur, te cilet do te qendrojne aty deri ne momentin e dorezimit.

Thaset e rrobave mbushen deri ne 2/3, mbyllen krejtesisht dhe vendosen ne dhomen apo vendin e parashikuar ne sherbim per depozitimin e materialeve. Evakuimi duhet te behet sa me shpejt te jete e mundur.

Thaset nuk duhet te terhiqen mbi dysheme.

Karroca e materialeve, sherben per mbajtjen e thaseve me ngjyra, per depozitimin e materialeve te ndotura nga nje shtrat ne tjetrin. Karroca eshte e pajisur me rrota dhe e ndare me thaset specifike me ngjyre me siglen perkatese identifikuese.

Karroca e materialeve, nuk futet ne dhomen e te semurit. Ne momentin e nderrimit te pacientit, largo cdo objekt duke bere kujdes per aparatet dentare, auditiv, stilolaps apo tjeter material preres.

Sipermarresi terheq nga pavioni inventarin e mbyllur me thaset me ngjyra te percaktuara sipas zonave dhe normave higjeno-sanitare, per larje dezinfektim nga personi i autorizuar klinika-k/infermieri/ja, dhe ne te njejten kohe dorezon ne pavion inventarin e paster te hekurosur dhe te paketuar. Inventari qe merret ose dorezohet, eshte gjithmone i palosur dhe i paketuar.

**Veshjet e punes se personelit shendetesor:**

Veshjet e personelit shendetesor te ndotura, me xhepat e zbrasur vendosen ne thesin qe ndodhet tek dhoma e zhveshjes se personelit.

**Rast i vecante i materialit te kontaminuar "me rrezik mikrobiologjik":**

Ky material vendoset fillimisht në një qese plastike dhe më pas në një thes rrobash të verdhë: material i kontaminuar me gjak apo lëngje biologjike.

E njëjta procedurë do të zbatohet edhe per materialin e kontaminuar (salmonela, shigela, viruse intestinale, chlostridium difficile) apo kur vihet re prania e ekto paraziteve si cimka, morra etj.

**Rast i vecante i materialit te kontaminuar nga nje pacient pas ekzaminimit ne mjeksine nukleare:**

Vendosni materialin e kontaminuar ne qese plastike, ruajeni ne tualetin e pacientit, lajmeroni sherbimin e radiombrojtjes (nepermjet QKU), per te kostatuar nivelin e uljes se radioaktivitetit, perpara eleminimit ne nje thes te verdhe.

Materialet e tjera do te vendosen ne thes blu, me siglen **"material i piset".**

**Qarkullimi:**

Mledhja e materialit te ndotur kryehet nga nje punetor/sanitar i sherbimit cdo mengjes.

Shperndarja e materialit te paster per hospitalizim dhe veshjet e punes, behet ne cdo sherbim nga personeli i autorizuar nga sipermarresi.

Ne asnje rast materialet nuk hidhen nga sherbimet.

**Përkujdesje:**

Lani duart ne cdo nderrim shtrati nepermjet kesaj procedure: kryeni nje larje te thjeshte dhe me pas nje ferkim hidroalkolik te duarve, pasi te keni manipuluar me materialet e pista.

Lani cdo dite karrocat e mbajtjes se thaseve te materialit te ndotur, mos lani asnjehere materialet ne sherbim, si dhe mos merrni asnjehere material per t'a lare ne shtepi.

Thasët , me ngjyrat e poshtëshënuara dhe me siglën përkatëse, vendosen në një mbajtës me rrota (karrocë), dhe administrohen nga Sipërmarrësi.

Thasët e Verdhë “**material i kontaminuar**”-vendoset çarçafët, këllëfat e jastëkut, pizham-këmishat e të sëmurëve.

Thasët Blu- **materiali i kontaminuar, nga një pacient pas ekzaminimit në mjeksinë nukleare.**

Thasët Jeshilë- **material i konsideruar “me rrezik mikrobiologjik”**

Thastët Gri – veshjet e personelit shëndetësor ndihmës (sanitare, barrelambajtës, etj), pantallona dhe bluza.

Thasët Vishnje (Bordeaux) – mbulesa, mbrojtëse dysheku, bluza pambuku.

Thasët Blu – “**material i pisët**”

Shperndarja: Spitali Rajonal Fier *(godina qendrore; godina e maternitetit; godina e pediatrise se pergjithshme; godina e poliklinikes se specialisteteve)*

Vendi dhe dorëzimi i shërbimeve: Spitali Rajonal Fier.

**Shtojca 10**

## LOTI 1 ME OBJEKT: "SHËRBIM I LAVANDERISË PËR PACIENTËT E HOSPITALIZUAR NË PAVIONET E SPITALIT MEMORIAL FIER"

[*Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor*]

## FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

### 1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

a)është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);

c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;

ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;

d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;

dh nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;

e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;

gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.

i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 11.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

**Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.**

Në çdo rast, Autoriteti/Enti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

**2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. **Ofertuesi duhet të paraqesë:**

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 11*

*b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 5 ;*

**2. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

**2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:**

**2** Sipas kritereve të përgjithshme të kualifikimit të përcaktuara në pikën 1, të shtojcës 10 të DST.

**2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

2.2.1 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2021, 2022,2023), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale sa vlera e fondit limit, në të paktën 1 (një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve: (2021, 2022,2023) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori

ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivit dhe pasivit.

**2.3 Kapaciteti teknik:**

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 39 % të vlerës së fondit të limit të marrëveshjes kuadër.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

**a)** për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

**b)** për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara**.**

2.3.2 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të ketë në pronësi, qira ose në përdorim **të paktën 1 (një) ambient, ku shtron veprimtarinë për kryerjen e shërbimit lavanderisë objekt prokurimit.**

Për të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- dokumentacionin që vërteton pronësinë, ose qiramarrjen, ose huapërdorjen (certifikatë pronësie/ kontrata qiraje/ kontrata huapërdorje/ çdo dokument tjetër të vlefshëm, me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë ose përdorimit sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë).
- akt miratimi higjeno – sanitar për këtë ambient, lëshuar nga organi kompetent i ngarkuar me ligj.

Të dhënat për ambientin e kërkuar, që do të deklarohet detyrimisht do t'i paraqiten Autoritetit Kontraktor për të qenë pjesë e planit të zbatimit të kontratës.

2.3.3 Operatori ekonomik ofertues, duhet të jetë i pajisur me leje mjedisore të Tipit B "Pastrim kimik", lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB), për vendin ku ushtron këtë aktivitet, në fushën e objektit të prokurimit.

2.3.4 Operatori ekonomik ofertues duhet të dëshmojë dhe të paraqesë çertifikatë, e cila të përfshijë objektin e prokurimit, dhe të jetë e vlefshme, si më poshtë si më poshtë:

- **SSH EN 14065:2016** mbi "Sistemin e kontrollit të Biokontaminimit", ose ekuivalente/ të barazvlefshme;

2.3.5 Operatori/ët ekonomik pjesëmarrës për të realizuar shërbimin objekt prokurimi, duhet të ketë minimalisht 13 (trembëdhjetë) persona të punësuar, në profilet sipas tabelës si mëposhtme:

| **NR.** | **Stafi** | **Nr.** |
|---|---|---|
| **1** | Drejtues Teknik/Përgjegjës Shërbimi | 1 (një) |
| **2** | Punëtore në Lavanderi | 5 (pesë) |
| **3** | Punonjës Shërbimi në Reparte në AK | 7 (shtatë) |
| | **Totali i punonjësve** | **13 (trembëdhjete)** |

a) Drejtuesi Teknik/ Përgjegjës Shërbimi duhet të ketë eksperiencë pune të ngjashme të paktën 2 (dy) vite.

Për Drejtuesin Teknik/ Përgjegjës Shërbimi, OE duhet të paraqesë:

- Kontratë individuale pune (e vlefshme),
- Diplomë;
- Librezë pune/deklarata e kontributeve të sigurimeve shoqërore individuale e lëshuar nga e – albania/ cv dhe/ose çdo dokumentacion tjetër që vërteton ekpseriencën e kërkuar.

**b)** Për punonjësit Punëtor në Lavanderi, dhe punonjësit e shërbimit në Reparte të AK të paraqitet kontratë individuale pune (e vlefshme) përkatëse.

*Kriteri konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 11 të DT. Dokumentet provuese të kërkuar më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit,ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.*

Të dhënat për punonjësit e kërkuar, që do të deklarohen detyrimisht, do t'i paraqiten Autoritetit Kontraktor, për të qenë pjesë e planit të zbatimit të kontratës.

2.3.6 Operatorët ekonomikë ofertues duhet të deklarojnë se punonjësit e deklaruar për këtë procedurë prokurimi: Drejtuesi Teknik/ pergjegjesi i sherbimit dhe Punonjës Shërbimi në Reparte në AK nuk do të jenë të angazhuar në kontrata të tjera gjatë periudhës së vlefshmërisë së marrëveshjes kuadër.

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të deklaroje se disponon, makinerite, dhe pajisjet, si më poshtë:

| **Nr** | **Emri i mjetit** | **Njësia** | **Sasitë minimale** | **Statusi** |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Makinë larëse profesionale(me kapacitet mbi 60 kg secila) | copë | 2 (dy) ose me kombinim pajisjesh, per plotesimin e sasise se | Në pronësi ose me qira |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | percaktuar nga AK. | |
| 2 | Barriera larese profesionale (për larjen e materialeve të kontaminuara) me kapacitet mbi 60 kg secila. | copë | 1 (nje) ose me kombinim pajisjesh, per plotesimin e sasise se percaktuar nga AK. | Në pronësi ose me qira |
| 3 | Makinë pastrimi kimik profesionale (për jorgan<br>Vatine dhe jastëk, me kapacitet mbi 20 kg) | copë | 1 (nje) ose me kombinim pajisjesh, per plotesimin e sasise se percaktuar nga AK. | Në pronësi ose me qira |
| 4 | Makinë tharëse profesionale (me kapacitet mbi 20 kg secila) | cope | 2 (dy) ose me kombinim pajisjesh, per plotesimin e sasise se percaktuar nga AK. | Në pronësi ose me qira |
| 5 | Trasportuesa (karrela për transport<br>Rrobash) profesionale | copë | 30 | Në pronësi ose me qira |
| 6 | Kosha metalik/plasike/ekuivalente (karrela për mbajtje Material i butë) (brenda ambientit të lavanderisë, me kapacitete të ndryshme për të përballuar volumin e punës) | cope | 10 (dhjetë) | Në pronësi ose me qira |
| 7 | Makineri hekurosëse (rul) profesional | cope | 1 (një) | Në pronësi ose me qira |
| 8 | Kukullat hekurosje uniformash<br>Profesional me avull ( për uniformat e personelit ndihmës dhe mjekëve), | Cope | 1 (një) | Në pronësi ose me qira |
| 9 | Makina paketimi profesionale për paketim<br>Inventari i butë | Cope | 1 (një) | Në pronësi ose me qira |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 10 | Karroca shërbimi stacionare profesionale Në pavione (me ndarje - me kapak, të pajisur me thasë me ngjyra per vendosjen e materialeve) | Cope | 10 (dhjetë) | Në pronësi ose me qira |
| 11 | Çanta higjenike për trasport materiali butë (për transportin e materialeve) | Cope | 50 (pesëdhjete) | Në pronësi ose me qira |
| 12 | Pompa dizinfektante në karrocat shërbimi në pavione | Cope | 5 (pesë) | Në pronësi ose me qira |
| 13 | Peshore elektronike mbi 100 kg e cila duhet te jete kalibruar dhe te shoqerohet me akt kolaudimi te leshuar nga autoritetet perkatese( Drejtoria e Pergjithshme e Metrologjise) | Cope | 2 (dy) | Në pronësi ose me qira |

Për të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri, duhet të paraqitet:

dokumentacion për pajisjet dhe instrumentet e mësipërme, që vërtetojnë se, këto pajisje dhe instrumente i ka në pronësi, ose me qera, ose me huapërdorje (fatura blerje / dokumente zhdoganimi / kontrata qiraje / kontrata huapërdorje / kontratë dhurimi / çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë ose përdorimit sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë).

*Ky Kriter konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 11 të DT. Dokumentet provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit,ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.*

Te dhenat e kerkuara qe do te deklarohen detyrimisht do ti paraqitet Autoritetit Kontraktor per te qene pjese e planit te zbatimit te kontrates.

2.3.8 Operatori ekonomik ne lidhje me materialin e bute te percaktuar ne specifikimet teknike, qe do te paraqese skeden teknike ose katalogun e mallit, duhet te plotësoje tabelën e mëposhtme duke specifikuar vendin e origjinës si dhe certifikimet te leshuara nga nje organ i autorizuar.

| **Materialet e Buta** | | | | **SRMF** |
|---|---|---|---|---|
| Nr. | Emertimi i produktit | Vendi i origjinës | Skede teknike/katalog | Certifikatë konformiteti ose cilësie CE/**ekuivalent** akredituar |
| **1** | Çarçaf shtrati i sipërm | | | |
| **2** | Batanie | | | |
| **3** | Pizhama pacienti | | | |
| **4** | Pandofla pacienti për | | | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **5** | Peshqirë personeli/pacienti | | | |
| **6** | Jastëkë /kllëf jastëku | | | |
| **7** | Kllëfë dysheku | | | |
| **8** | Jorgan | | | |
| **9** | Çarçaf | | | |
| **10** | Përparëse mjeku | | | |
| **11** | Përparëse personeli | | | |
| **12** | Përparëse sanitare | | | |
| **13** | Përparëse, uniforma ekipi | | | |

Te dhenat qe do te deklarohen, detyrimisht do ti paraqiten Autoritetit Kontraktor per te qene pjese e planit te zbatimit te kontrates.

Me nenshkrimin e kontrates dhe dorezimin e materialeve te buta operatori ekonomik krahas mallrave objekt prokurimi te paraqes prane AK edhe raport testimet perkatese per cdo produkt. Per kete te paraqes detyrimisht nje deklarate se cdo produkt do te shoqerohet me raportin perkates i cili duhet te jete sipas kerkesave / specifiimeve teknike te AK.

2.3.9 Operatori Ekonomik duhet te dorëzojë dokumentacion teknik mbi produktin lares që do të përdoren për larjen e materialeve të buta “me ndotje spitalore” sipas klasifikimit ne Termat e References shtojca 9 e DST:

-Material i kontaminuar”-

-Materiali i kontaminuar, nga një pacient pas ekzaminimit në mjeksinë nukleare.

-Material i konsideruar “me rrezik mikrobiologjik”

-Material i pisët”

Për detergjentet e pastrimit Operatori Ekonomik duhet të paraqesë :

I. Skedat teknike ose katalog të lëshuar nga prodhuesi i produktit, shoqëruar me Certifikatën e Konformiteti ose Cilesia CE për keto lloj produktesh.
II. Autorizim/Dokument ekuivalent lëshuar nga prodhuesi ose distributori i autorizuar nga prodhuesi, me anë të cilit vërtetohet se ofertuesi ka siguruar furnizim të rregullt të detergjentëve që do të përdoren për larjen e materialeve të buta “me ndotje spitalor”
III. Tabelen me produktet dhe emertimet që do të përdoren si me poshte vijon:

| Materialet e pastrimit | | | | SRMF |
|---|---|---|---|---|
| **Nr.** | **Emërtimi i produktit që do të lahet** | **Vendi i origjines së produktit të pastrimit** | **Lloji/Emertimi I detergjentit** | **Certifikatë konformiteti ose cilësie CE/ekuivalent akredituar** |
| 1 | Material i kontaminuar | | | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 2 | Materiali i kontaminuar, nga një pacient pas ekzaminimit në mjeksinë nukleare | | | |
| 3 | Material i konsideruar "me rrezik mikrobiologjik" | | | |
| 4 | Material i pisët" | | | |

<u>Te dhenat qe do te deklarohen, detyrimisht do ti paraqiten Autoritetit Kontraktor per te qene pjese e planit te zbatimit te kontrates.</u>

2.3.10 Operatori ekonomik duhet të disponojë minimumi 1 (një) mjet transport, me qëllim transportin e materialit të butë.Për të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri, duhet të paraqitet:

- dokumentacion për pajisjet dhe instrumentet e mësipërme, që vërtetojnë se, këto pajisje dhe instrumente i ka në pronësi, ose me qera, ose me huapërdorje (fatura blerje / dokumente zhdoganimi / kontrata qiraje / kontrata huapërdorje / kontratë dhurimi / çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë ose përdorimit sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë).
- lejen e qarkullimit të mjetit

<u>Mjetet qe do te deklarohen, detyrimisht do ti paraqiten Autoritetit Kontraktor per te qene pjese e planit te zbatimit te kontrates</u>**.**
*Ky Kriter konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 11 të DT.* *<u>Dokumentet provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit,ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.</u>*

2.3.11 Operatori ekonomik, duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës merr përsipër kryerjen e shërbimeve, nga punonjës të pajisur me uniformën e punës, me materiale/ pajisje mbrojtëse personale për shëndetin dhe sigurinë teknike në punë.

***<u>Shënim:</u>*** *Operatori ekonomik ofertues në më shumë se një Lot, duhet të ketë kapacitetet ekonomike – financiare (nënpika 1 e seksionit 2.2, të kritereve të veçanta për kualifikim) si dhe kapacitetet teknike ( nënpika 1 e seksionit 2.3, të kritereve të veçanta për kualifikim), sa shuma e loteve për të cilat ka ofertuar, të marra së bashku. Në këtë rast, operatori ekonomik ofertues në më shumë se një Lot, duhet të paraqesë një deklaratë ku të listohen dokumentet e paraqitura në përmbushje të kritereve kumulative për Lotin konkret. Në rast se dokumentacioni i deklaruar dhe i dorëzuar në përmbushje të kritereve kumulative nuk plotëson kapacitetet ekonomike - financiare dhe kapacitetet teknike për të gjitha Lotet ku operatori ekonomik ka ofertuar, do të kualifikohet vetëm në atë Lot ku oferta e tij është ekonomikisht më e favorshme.*

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.**

**Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

**Shtojca 10**

## LOTI 2 ME OBJEKT: "SHERBIMI I LAVANDERISË DHE HOTELERISË PËR SPITALIN RAJONAL FIER"

[*Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor*]

## FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

### 2. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

a)është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);

c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;

ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;

d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;

dh nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;

e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;

gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.

i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 11.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

**Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.**

Në çdo rast, Autoriteti/Enti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

**2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. **Ofertuesi duhet të paraqesë:**

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 11*

*b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 5 ;*

**2. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

**2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:**

Sipas kritereve të përgjithshme të kualifikimit të përcaktuara në pikën 1, të shtojcës 10 të DST.

**2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

2.2.1 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2021, 2022,2023), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale sa vlera e fondit limit, në të paktën 1 (një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve: (2021, 2022,2023) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivit dhe pasivit.

**2.3 Kapaciteti teknik:**

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 39 % të vlerës së fondit të limit të marrëveshjes kuadër.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

**c)** për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

**d)** për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara**.**

2.3.2 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të ketë në pronësi, qira ose në përdorim **të paktën 1 (një) ambient, ku shtron veprimtarinë për kryerjen e shërbimit lavanderisë objekt prokurimit.**

Për të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- dokumentacionin që vërteton pronësinë, ose qiramarrjen, ose huapërdorjen (certifikatë pronësie/ kontrata qiraje/ kontrata huapërdorje/ çdo dokument tjetër të vlefshëm, me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë ose përdorimit sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë).
- akt miratimi higjeno – sanitar për këtë ambient, lëshuar nga organi kompetent i ngarkuar me ligj.

<u>Të dhënat për ambientin e kërkuar, që do të deklarohet detyrimisht do t'i paraqiten Autoritetit Kontraktor për të qenë pjesë e planit të zbatimit të kontratës</u>

2.3.3 Operatori ekonomik ofertues, duhet të jetë i pajisur me leje mjedisore të Tipit B "Pastrim kimik", lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB), për vendin ku ushtron këtë aktivitet, në fushën e objektit të prokurimit.

2.3.4 Operatori ekonomik ofertues duhet të dëshmojë dhe të paraqesë çertifikatë, e cila të përfshijë objektin e prokurimit, dhe të jetë e vlefshme, si më poshtë si më poshtë:

- **SSH EN 14065:2016** mbi "Sistemin e kontrollit të Biokontaminimit", ose ekuivalente/ të barazvlefshme;

2.3.5 Operatori/ët ekonomik pjesëmarrës për të realizuar shërbimin objekt prokurimi, duhet të ketë minimalisht 20 (njezet) persona të punësuar, në profilet sipas tabelës si mëposhtme:

| **NR.** | **Stafi** | **Nr.** |
|---|---|---|
| **1** | Drejtues Teknik/ Pergjegjes sherbimi | 1 (një) |
| **2** | Punëtore në Lavanderi | 9 (nente) |
| **3** | Punonjës Shërbimi në Reparte në AK | 10 (dhjete) |
| | **Totali i punonjësve** | **20 (njezet)** |

a) Drejtuesi Teknik/Pergjegjes Sherbimi duhet të ketë eksperiencë pune të ngjashme të paktën 2 (dy) vite.Për Drejtuesin Teknik/ pergjegjesin e sherbimit , OE duhet të paraqesë:

- Kontratë individuale pune (e vlefshme),
- Diplomën;
- Librezë pune/deklarata e kontributeve të sigurimeve shoqërore individuale e lëshuar nga e – albania/cv/ ose çdo dokumentacion tjetër që vërteton ekpseriencën e kërkuar.

b)Për punonjësit Punëtor në Lavanderi, dhe punonjësit e shërbimit në Reparte të AK të paraqitet vetëm kontratë individuale pune (e vlefshme) si punonjës në lavanderi.

*Kriteri konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 11 të DT. Dokumentet provuese të kërkuar më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit,ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.*

Të dhënat për punonjësit e kërkuar, që do të deklarohen detyrimisht, do t'i paraqiten Autoritetit Kontraktor, për të qenë pjesë e planit të zbatimit të kontratës.

2.3.6 Operatorët ekonomikë ofertues duhet të deklarojnë se punonjësit e deklaruar për këtë procedurë prokurimi: Drejtuesi Teknik/Pergjegjes sherbimi dhe Punonjës Shërbimi në Reparte në AK nuk do të jenë të angazhuar në kontrata të tjera gjatë periudhës së vlefshmërisë së marrëveshjes kuadër.

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të deklaroje se disponon, makinerite, dhe pajisjet, si më poshtë:

| **Nr** | **Emri i mjetit** | **Njësia** | **Sasitë minimale** | **Statusi** |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Makinë larëse profesionale(me kapacitet mbi 50 kg secila) | copë | 2 (dy) ose me kombinim pajisjesh, per plotesimin e sasise se | Në pronësi ose me qira |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | percaktuar nga AK. | |
| 2 | Makinë tharëse profesionale (me kapacitet mbi 50 kg secila) | copë | 2 (dy) ose me kombinim pajisjesh, per plotesimin e sasise se percaktuar nga AK. | Në pronësi ose me qira |
| 3 | Makineri hekurosëse (rul) professional | copë | 2 (dy) | Në pronësi ose me qira |
| 4 | Makineri Paketimi Profesionale per paketim rrobash | cope | 1 (nje) | Në pronësi ose me qira |
| 5 | Makineri barriera larese profesionale (minimalisht 50 kg) | copë | 1 (nje) ose me kombinim pajisjesh, per plotesimin e sasise se percaktuar nga AK. | Në pronësi ose me qira |
| 6 | Kosha metalik (karrela për mbajtje Material i butë) (brenda ambientit të lavanderisë, me kapacitete të ndryshme për të përballuar volumin e punës) | cope | 10 (dhjetë) | Në pronësi ose me qira |
| 7 | Karrela karroca (karrela sherbimi ne pavion per rrobat) | cope | 10 (dhjetë) | Në pronësi ose me qira |
| 8 | Peshore elektronike mbi 100 kg e cila duhet te jete kalibruar dhe te shoqerohet me akt kolaudimi te leshuar nga autoritetet perkatese( Drejtoria e Pergjithshme e Metrologjise) | Cope | 1 (nje) | Në pronësi ose me qira |

Për të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri, duhet të paraqitet:

dokumentacion për pajisjet dhe instrumentet e mësipërme, që vërtetojnë se, këto pajisje dhe instrumente i ka në pronësi, ose me qera, ose me huapërdorje (fatura blerje / dokumente zhdoganimi / kontrata qiraje / kontrata huapërdorje / kontratë dhurimi / çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë ose përdorimit sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë).

*Ky Kriter konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 11 të DT. Dokumentet provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit,ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.*

Të dhënat për punonjësit e kërkuar, që do të deklarohen detyrimisht, do t'i paraqiten Autoritetit Kontraktor, për të qenë pjesë e planit të zbatimit të kontratës.

2.3.8 Operatori ekonomik ne lidhje me materialin e bute te percaktuar ne specifikimet teknike, qe do te paraqese skeden teknike ose katalogun e mallit, duhet te plotësoje tabelën e mëposhtme duke specifikuar vendin e origjinës si dhe certifikimet te leshuara nga nje organ i autorizuar.

| **Materialet e Buta** | | | | **SRF** |
|---|---|---|---|---|
| Nr. | Emertimi i produktit | Vendi i origjinës | Skede teknike/katalog | Certifikatë konformiteti ose cilësie CE/**ekuivalent** akredituar |
| **1** | Kellefe jasteku | | | |
| **2** | Çarçaf shtrati i siperm | | | |
| **3** | Çarçaf shtrati i poshtem | | | |
| **4** | Çarçaf per femije | | | |
| **5** | Mbulese e gomuar | | | |
| **6** | Mbulese e gomuar per krevate | | | |
| **7** | Çarçaf zarf | | | |
| **8** | Çarçaf zarf per femije | | | |
| **9** | Peshqire (personeli,pacienti) | | | |
| **10** | Pizhama pacienti | | | |
| **11** | Perparese | | | |
| **12** | Kostume | | | |
| **13** | Kostume sanitare/kuzhiniere | | | |
| **14** | Pandofla personeli/pacienti | | | |
| **15** | Batanije per te rritur | | | |
| **16** | Batanije per te vegjel | | | |
| **17** | Jorgane me vatine | | | |
| **18** | Jorgane me vatine te vegjel | | | |

Te dhenat qe do te deklarohen, detyrimisht do ti paraqiten Autoritetit Kontraktor per te qene pjese e planit te zbatimit te kontrates.

Me nenshkrimin e kontrates dhe dorezimin e materialeve te buta operatori ekonomik krahas mallrave objekt prokurimi te paraqes prane AK edhe raport testimet perkatese per cdo produkt. Per kete te paraqes detyrimisht nje deklarate se cdo produkt do te shoqerohet me raportin perkates i cili duhet te jete sipas kerkesave / specifiimeve teknike te AK.

2.3.9 Operatori Ekonomik duhet te dorëzojë dokumentacion teknik mbi produktin lares që do të përdoren për larjen e materialeve të buta “me ndotje spitalore” sipas klasifikimit ne Termat e References shtojca 9 e DST:

-Material i kontaminuar”-

-Materiali i kontaminuar, nga një pacient pas ekzaminimit në mjeksinë nukleare.

-Material i konsideruar “me rrezik mikrobiologjik”

-Material i pisët”

Për detergjentet e pastrimit Operatori Ekonomik duhet të paraqesë :

IV. Skedat teknike ose katalog të lëshuar nga prodhuesi i produktit, shoqëruar me Certifikatën e Konformiteti ose Cilesia CE për keto lloj produktesh.
V. Autorizim/Dokument ekuivalent lëshuar nga prodhuesi ose distributori i autorizuar nga prodhuesi, me anë të cilit vërtetohet se ofertuesi ka siguruar furnizim të rregullt të detergjentëve që do të përdoren për larjen e materialeve të buta “me ndotje spitalore”
VI. Tabelen me produktet dhe emertimet që do të përdoren si me poshte vijon:

| **Materialet e pastrimit** | | | | **SRF** |
|---|---|---|---|---|
| **Nr.** | **Emërtimi i produktit që do të lahet** | **Vendi i origjines së produktit të pastrimit** | **Lloji/Emertimi I detergjentit** | **Certifikatë konformiteti ose cilësie CE/ekuivalent akredituar** |
| 1 | Material i kontaminuar | | | |
| 2 | Materiali i kontaminuar, nga një pacient pas ekzaminimit në mjeksinë nukleare | | | |
| 3 | Material i konsideruar “me rrezik mikrobiologjik” | | | |
| 4 | Material i pisët” | | | |

Te dhenat qe do te deklarohen, detyrimisht do ti paraqiten Autoritetit Kontraktor per te qene pjese e planit te zbatimit te kontrates.

2.3.10 Operatori ekonomik duhet të disponojë minimumi 1 (një) mjet transport, me qëllim transportin e materialit të butë. Për të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri, duhet të paraqitet:

- dokumentacion për pajisjet dhe instrumentet e mësipërme, që vërtetojnë se, këto pajisje dhe instrumente i ka në pronësi, ose me qera, ose me huapërdorje (fatura blerje / dokumente

zhdoganimi / kontrata qiraje / kontrata huapërdorje / kontratë dhurimi / çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë ose përdorimit sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë).

- lejen e qarkullimit të mjetit

*Ky Kriter konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 11 të DT. Dokumentet provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit,ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.*

Mjetet qe do te deklarohen, detyrimisht do ti paraqiten Autoritetit Kontraktor per te qene pjese e planit te zbatimit te kontrates.

2.3.11 Operatori ekonomik, duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës merr përsipër kryerjen e shërbimeve, nga punonjës të pajisur me uniformën e punës, me materiale/ pajisje mbrojtëse personale për shëndetin dhe sigurinë teknike në punë.

***Shënim:*** *Operatori ekonomik ofertues në më shumë se një Lot, duhet të ketë kapacitetet ekonomike – financiare (nënpika 1 e seksionit 2.2, të kritereve të veçanta për kualifikim) si dhe kapacitetet teknike ( nënpika 1 e seksionit 2.3, të kritereve të veçanta për kualifikim), sa shuma e loteve për të cilat ka ofertuar, të marra së bashku. Në këtë rast, operatori ekonomik ofertues në më shumë se një Lot, duhet të paraqesë një deklaratë ku të listohen dokumentet e paraqitura në përmbushje të kritereve kumulative për Lotin konkret. Në rast se dokumentacioni i deklaruar dhe i dorëzuar në përmbushje të kritereve kumulative nuk plotëson kapacitetet ekonomike - financiare dhe kapacitetet teknike për të gjitha Lotet ku operatori ekonomik ka ofertuar, do të kualifikohet vetëm në një Lot.*

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.**

**Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

**Shtojca 11**

*(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)*

## FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

I. Unë i nënshkruari _______________ në cilësinë e _________________ të operatorit ekonomik ______________________ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

PJESA I: A. **INFORMACION NË LIDHJE ME OPERATORIN EKONOMIK**

| **Identifikimi** | **Përgjigjja** |
|---|---|
| Emri i operatorit ekonomik:<br>(Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE | ------------------------------------------------- |
| Numri NIPT/et: | ---------------------------------------------------- |
| Adresa postare:<br>Qyteti / qyteti; Kodi postar | ------------------------------------------------------- |
| Përfaqësuesi (emri): | --------------------------------------------- |
| Telefoni: | ------------------------------------------------------ |
| E-mail: | --------------------------------------------------------<br>--- |

**B: DEKLARATË**

**Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)**

| |
|---|
| Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:<br>• **Informacione për nënkontraktorin** |

| **Emri i nënkontraktorit të propozuar** | **NIPT –i** | **Përqindja e nënkontraktimit** | **Shërbimet/ Mallrat e lidhura me to për t'u nënkontraktuar** |
|---|---|---|---|
| | | | |
| | | | |
| | | | |

- **Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik**

| **Emri (at) e subjekteve** | **NIPT-i** | **Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik** | **Specifiko konkretisht kapacitetin/et** |
|---|---|---|---|
| | | | |
| | | | |
| | | | |

**Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit**

**A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT**

| |
|---|
| Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.<br>*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* ___________________________________________________ |
| Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.<br>*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* ___________________________________________________ |
| Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë: |

| |
|---|
| etj.<br>nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.<br>*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* ________________________________________________ |
| Operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.<br>*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* ________________________________________________ |
| Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).<br>*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* ________________________________________________ |
| Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së.<br>*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* ________________________________________________ |
| Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.<br>Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.<br>*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* ________________________________________________ |
| Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi.<br>*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* ________________________________________________ |
| Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.<br>Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.<br>*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* ________________________________________________ |

**B: DEKLARATA "Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura"**

| |
|---|
| Ne cilësinë e përfaqësuesit të operatorit ekonomik, në mbështetje të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", si dhe në mbështetje të Ligjit Nr.9121/2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës", bëj këtë deklarim dhe garantoj se deklaratat e mëposhtme janë të vërteta dhe të plota në çdo aspekt: |

1. Unë kam lexuar dhe kuptuar përmbajtjen e kësaj Deklarate;

2. Unë kuptoj që oferta e paraqitur do të s'kualifikohet dhe/ose përjashtohet nga fitimi i kontratave publike, nëse kjo Deklaratë vërtetohet se nuk është e plotë dhe / ose e saktë në çdo aspekt;

3. Unë jam i autorizuar nga Ofertuesi të firmos këtë Deklaratë dhe të paraqes ofertë në interes të Ofertuesit;

4. Çdo person, firma e të cilit shfaqet në dokumentacionin e ofertës, është i autorizuar nga Ofertuesi për të përgatitur dhe për të nënshkruar ofertën në interes të Ofertuesit;

5. Për qëllim të kësaj deklarate dhe ofertës së paraqitur, unë kuptoj që fjala "konkurrentë" nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, të ndryshëm nga Ofertuesi, të paraqitur ose jo si bashkim operatorësh ekonomik, që:

   a) paraqesin një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë, të bërë nga Autoriteti Kontraktor;
   b) është një ofertues i mundshëm, i cili bazuar në kualifikimin, aftësitë ose përvojat e tij, mundet të dorëzojë një ofertë në përgjigje, të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë.

6. Ofertuesi deklaron se: (kliko një nga alternativat e mëposhtme):

   a) Ofertuesi ka përgatitur ofertën e tij në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, pa komunikuar dhe pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër;
   ☐
   b) Ofertuesi është konsultuar, ka komunikuar, ka bërë marrëveshje me një ose më shumë konkurrentë në lidhje me këtë procedurë prokurimi. Ofertuesi deklaron se në dokumentet bashkangjitur, në detajet e kësaj oferte, janë përfshirë emrat e konkurrentëve, natyra dhe shkaqet e konsultimit, komunikimit, marrëveshjes apo angazhimit (rasti i bashkimit të operatorëve ekonomikë ose nënkontraktimit).

   ☐

7. Në veçanti, pa kufizuar paragrafët 6. a) dhe 6. b), të përmendur më lart, nuk ka pasur konsultime, komunikime, kontratë apo marrëveshje me ndonjë konkurrent në lidhje me:

   a) çmimet ;
   b) metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;
   c) qëllimin apo vendimin për të paraqitur apo jo një ofertë; ose,
   d) paraqitjen e një oferte që nuk i plotëson specifikimet e kërkesës për ofertë.

8. Përveç kësaj, nuk ka pasur konsultime, komunikime, marrëveshje apo kontrata me ndonjë konkurrent në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet apo dërgesa të veçanta të produkteve apo shërbimeve të cilat lidhen me prokurimin në fjalë, përveç se kur janë deklaruar sipas paragrafit të mësipërm 6. b).

9. Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të njohura dhe as nuk do t'u bëhen të njohura me qëllim nga Ofertuesi konkurrentëve të tjerë, në çdo mënyrë qoftë, para datës dhe kohës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes fitues dhe lidhjes së kontratës, vetëm nëse kërkohet me ligj ose nëse deklarohen në mënyrë specifike sipas paragrafit 6.b).

**C: DEKLARATA "Mbi Konfliktin e Interesit"**

| **Deklarata** |
|---|
| Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se jemi të vetëdijshëm për sa vijon:<br><br>Konflikti i interesit është një situatë e konfliktit midis detyrës publike dhe interesit privat të një zyrtari, në të cilën ai / ajo ka interesa private direkte ose indirekte që ndikojnë, ose që mund të ndikojë ose që duket se ndikojnë në kryerjen e padrejtë të detyrave dhe detyrimeve publike.<br><br>Në përputhje me nenin 21, paragrafi 1, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve siç parashikohen në Kapitullin III, Seksioni II, që janë absolutisht të ndaluara të përfitojnë drejtpërdrejt ose indirekt nga nënshkrimi i kontratave midis një pale dhe institucionit publik janë:<br><br>- Presidenti i Republikës, Kryeministri, Zëvendës Kryeministri, Ministrat, ose Zëvendësministrat, Deputetët, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kreu i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Gjyqtarët dhe Prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë dhe Gjykatës së Apelit, Avokati i Popullit, Anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit, Anëtarët e Enteve Rregullatore (Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zëvendësguvernatorin; konkurrenca; telekomunikacioni; energjia elektrike; furnizimi me ujë; sigurimi; bonot; autoritetet e medias), sekretarët e përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar publik në çdo institucion publik pozicioni i të cilit është i barabartë me atë të Drejtori i Përgjithshëm, drejtuesit e organeve të administratës publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil.<br>- Për nëpunësit civilë të nivelit të mesëm, sipas nenit 31 dhe zyrtarët sipas nenit 32 të kreut III, seksionit 2 të këtij ligji, ndalimi në paragrafin 1 të këtij neni, për shkak të interesave private të zyrtarit, siç përcaktohet këtu të zbatohet vetëm në rast të lidhjes së kontratave brenda fushës dhe territorit të institucionit dhe juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim do të zbatohet edhe kur pala në kontratë është një institucion varësie.<br>- Kur zyrtari është kryetar bashkie ose nënkryetar i një bashkie ose komune, ose kryetar i një këshilli rajonal, anëtar i këshillit përkatës, ose një zyrtar i lartë i menaxhimit të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave private të zyrtarit, specifikuar këtu, do të zbatohet vetëm në rastin e lidhjes së kontratave, nëse ka, me bashkinë, komunën ose rajonin ku zyrtari ushtron një detyrë të tillë. Ky ndalim do të zbatohet gjithashtu kur pala në kontratë është një institucion publik në varësi të kësaj njësie (neni 21, paragrafi 2, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005).<br><br>Ndalimet e parashikuara në nenin 21, paragrafët 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, do të zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin, d.m.th. **bashkëshortin, bashkëjetuesin, fëmijët madhorë e prindërit e zyrtarit dhe të bashkëshortit dhe bashkëjetuesit**.<br><br>Unë jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të parashikuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksioneve Publike", të ndryshuar, dhe aktet nënligjore të miratuara në bazë të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimi dhe Kontrolli i Pasurive, si dhe Ligji Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik".<br><br>Në përputhje me to, unë deklaroj këtu se asnjë zyrtar publik, siç përcaktohet në Kapitullin III, Seksioni II të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk ka ndonjë interes privat, direkt ose indirekt, me personin juridik që unë përfaqësoj këtu. |

**D: DEKLARATA "Për zbatimin e dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës"**

| **Deklarata** |
|---|
| Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time se: |
| • Operatori ekonomik ________________________garanton mbrojtjen e të drejtës së punësimit dhe profesionit nga çdo formë diskriminimi, të parashikuar nga legjislacioni i punës në fuqi.<br><br>• Operatori ekonomik___________________lidh me punëmarrësit kontratat përkatëse të punës dhe garanton masat në drejtim të sigurisë dhe shëndetit në punë për të Gjithë dhe, në mënyrë të veçantë, për grupet e rrezikuara, bazuar në legjislacionin e punës në fuqi.<br><br>• Operatori ekonomik ________________nuk ka masë Ligjore në fuqi, të vendosur nga Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH). Në rastet kur janë konstatuar shkelje ligjore, operatori ekonomik ka marrë masat e nevojshme për adresimin e tyre, brenda afateve të përcaktuara nga ISHPSHSH.<br><br>*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* ___________________________________________________ |

**Pjesa III Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit**

**A: DEKLARATË "Në përputhje me specifikimet teknike dhe grafikun e realizimittë objektit të kontratës"**

| **Deklarata** | **Përgjigje** |
|---|---|
| Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se plotësojnë të gjitha specifikimet teknike, siç udhëzohet në dokumentet e tenderit, dhe këtë e provojmë përmes certifikatave dhe dokumenteve të paraqitura me këtë deklaratë (nëse kërkohet nga Autoriteti/Enti Kontraktor), dhe marrim përsipër të realizojmë objektin në përputhje me Listën e shërbimeve dhe grafikun ekzekutimit të përcaktuar nga Autoriteti/Enti kontraktor. | Po [ ] Jo [ ] |

**B: DEKLARATË "Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)"**

| **Deklarata** | **Përgjigje** |
|---|---|
| Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time se:<br><br>Unë kam punonjësit e nevojshëm si dhe mjetet dhe makineritë për ekzekutimin e kontratës, siç | <u>Punonjës</u><br><br>Po [ ] Jo [ ] |

| | |
|---|---|
| përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar, nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti/enti kontraktor. | Nëse, po, numri i punonjësve: ___ Profili i punonjësve ___ – Makineri e mjete Po [ ] Jo [ ] Nëse po, të listohen me të dhënat konkrete: ___ |
| **Emri, Mbiemri**___ **Firma** ___ **Vula**___ **Data e dorëzimit të deklaratës** ___ | |

**Ju lutemi sigurohuni që:**

- **Secili pjesëmarrës i renditur në një bashkim operatorësh ekonomikë të paraqesë një Formular të veçantë të Vetëdeklarimit.**

- **Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, një Formular i veçantë i Vetëdeklarimit duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.**

- **Çdo vetdeklarim i pavërtetë/pasaktë nga ana e operatorëve ekonomikë jo vetëm që përbën shkak për skualifikimin nga procedura konkrete, por përbën shkak dhe për përjashtimin e tyre nga e drejta për të fituar kontrata publike deri në 3 vjet, sipas parashikimeve të ligjit për prokurimin publik.**

- **Operatorët ekonomikë që ofertojnë në procedurat e prokurimit të vetdeklarojnë në çdo rast informacionin e saktë që i korrespondon gjendjes së tyre faktike.**

**Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik për sa më sipër.**

- ***Në çdo rast, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor duhet t'i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e***

***paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.***

- ***Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.***

**Shtojca 12**

**Formulari i Njoftimit të Skualifikimit**2

[Vendndodhja dhe data]

[Emri dhe adresa e Autoritetit/Entit Kontraktor]

[Adresa e Ofertuesit]

I nderuar, Z. / Znj. <Emri i kontaktit >

Ju falënderojmë për pjesëmarrjen tuaj në procedurën e sipërpërmendur të prokurimit publik. Procedura u zhvillua në përputhje me Ligjin Nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik".

Oferta juaj u vlerësua me kujdes në bazë të kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në Njoftimin e Kontratës dhe dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informojmë se jeni skualifikuar pasi oferta e paraqitur nga ju është refuzuar për arsyen (et) e mëposhtme:

______________________________________________________________________

______________________________________________________________________

______________________________________________________________________

______________________________________________________________________

Nëse mendoni se autoriteti/enti kontraktor ka shkelur LPP-në ose RPP-në gjatë procedurës së prokurimit publik, ju keni të drejtë të inicioni një procedurë rishikimi pas publikimit te njoftimit te fituesit sipas parashikimeve të Kapitullin XIV të Ligjit të Prokurimit Publik.

Megjithëse nuk mund t'i përdorim shërbimet tuaja në këtë rast, ne besojmë se do të mbeteni të interesuar për iniciativat tona të prokurimit.

Me respekt,

**Titullari i Autoritetit/Entit Kontraktor**

---

[2] *Ky njoftim do të përdoret në rastin e procedurave të prokurimit të zhvilluara në rrugë shkresore*

**Shtojca 13**

*[Shtojcë për tu plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]*

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT (PARAPRAK)**

*[Data]*

Drejtuar: *[Emri dhe adresa e Ofertuesit fitues]*

Procedura e prokurimit/lotit:

Numri i procedurës / referenca e Lotit: Përshkrimi i shkurtër i kontratës: *[Objekti, sasitë dhe kohëzgjatja e kontratës]*

Publikimet e mëparshme (*nëse është rasti*): Buletini i Njoftimeve Publike *[Data] [Numri]*

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto □

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim □

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1.___________________________________ _____________________________________________

*Emri i plotë i shoqërisë* *Numri i NIPT-t*

Vlera ___________________________________________________*(e shprehur në shifra dhe fjalë)*

2.___________________________________

_____________________________________________

*Emri i plotë i shoqërisë* *Numri i NIPT-it*

Vlera ______________________________________________*(e shprehur në shifra dhe fjalë)*

Etj.___________________________________________________________________________________

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1.___________________________________ ____________________________

*Emri i plotë i shoqërisë* *Numri i NIPT-it* *arsyet e mëposhtme*

2.___________________________________ ______________ ____________________

*Emri i plotë i shoqërisë* *Numri i NIPT-it* *arsyet e mëposhtme*

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [*emri dhe adresa e ofertuesit fitues*], se oferta e paraqitur me vlerë totale prej _____________ [*shuma përkatëse e shprehur me fjalë dhe shifra*] / totali i pikëve të marra [_____] është identifikuar si fitues (paraprak) i procedurës së prokurimit.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik".

**Shtojca 14**

[Shtojcë për tu plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT 3**

***(NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT)***

*[Data]*

Drejtuar: *[Emri dhe adresa e Ofertuesit fitues]*

Procedura e prokurimit/lotit

Numri i procedurës / referenca e Lotit:

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: *[Objekti,* S*asitë dhe kohëzgjatja e kontratës]* Publikimet e mëparshme (*nëse është rasti*): Buletini i Njoftimeve Publike *[Data] [Numri]*

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto □

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim □

Me anë të kësaj ju informojmë se Ofertuesit e mëposhtëm kanë marrë pjesë në këtë procedurë me këto vlera përkatëse të ofruara:

1.______________ _________________ _________________________________

*Emri i plotë i shoqërisë* *Numri i NIPT-t* Vlera *(e shprehur në shifra dhe fjalë)*

2.____________________ _________ _____________________________________

*Emri i plotë i shoqërisë* *Numri i NIPT-it* Vlera *(e shprehur në shifra dhe fjalë)*

Etj.______________________________________________________________________________

Janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1.__________________________________ ________________ _____________

*Emri i plotë i shoqërisë* *Numri i NIPT-it* *arsyet*

2.__________________________________ _____________________ _________________

*Emri i plotë i shoqërisë* *Numri i NIPT*-it arsyet

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë *[emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]* se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej *[shuma përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]*/pikët totale të marra *[_____]* është identifikuar si oferta e suksesshme.

[3] *Ky Formular është i aplikueshëm nëse ka Ankime*

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë *[emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor dhe referenca e kontaktit]* sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentet e tenderit, brenda ____________ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzon sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej *[vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]*, siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik".

Ankesa pas Njoftimit të Fituesit (Paraprak)

PO □ JO□

Nëse Po (*vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë*)___________________

Ankesa pas Njoftimit të Anullimit të procedurës:

PO □ JO□

Nëse Po (*vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë*)___________________

**[Titullari i Autoritetit /Entit kontraktor]**

**Shtojca 15**

*[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor në rastin e Marrëveshjes Kuadër]*

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË MARRËVESHJEN KUADËR (PARAPRAK)**

*[Data]*

Drejtuar: [Emri dhe adresa e operatorëve ekonomikë të suksesshëm]

1.__________________________________________
*2.* __________________________________________
*3.*__________________________________________

* * *

Procedura e prokurimit/Loti
Numri i procedurës / referenca e Lotit

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: [shuma, objekti, kohëzgjatja e kontratës, etj.]

Publikimet e mëparshme (nëse aplikohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:
oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto □
oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim □

Me anë të kësaj bëjmë me dije se, në këtë procedurë /lot kanë marrë pjesë operatorët ekonomikë të mëposhtëm me vlerat përkatëse si më poshtë:

1.__________________________________ ______________________________
*Emri i plotë i shoqërisë* *Numri i NIPT-it*

Vlera e ofruar/ Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave (nëse është e zbatueshme______________________________________________________________________
*(e shprehur në shifra dhe në fjalë)*

2.__________________________________ ______________________________
*Emri i plotë i shoqërisë* *Numri i NIPT-it*

Vlera e ofruar/ Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave (nëse është e zbatueshme) ______________________________
*e shprehur në shifra dhe në fjalë)*

Etj.____________________________

Janë skualifikuar Operatorët ekonomikë e mëposhtëm:

1.__________________________________ ______________
__________________

*Emri i plotë i shoqërisë* *Numri i NIPT-it* *arsyet*

2.________________________________ ________________ ______________

*Emri i plotë i shoqërisë* *Numri i NIPT-it* *arsyet*

* * *

Duke iu referuar procedurës së mësipërme, ju informojmë se operatorët ekonomikë të mëposhtëm janë identifikuar si fitues (paraprak) të procedurës së prokurimit:

1.________________________________ ____________________________

*Emri i plotë i shoqërisë* *Numri i NIPT-it*

Vlera / Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave (nëse është e zbatueshme ) ____________________________

*(e shprehur në shifra dhe në fjalë)*

Totali i pikëve të marra ______________

2.________________________________ ____________________________
*Emri i plotë i shoqërisë* *Numri i NIPT-it*

Vlera e ofruar/ Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave (nëse është e zbatueshme ) ____________________________

*(e shprehur në shifra dhe në fjalë)*

Totali i pikëve të marra ______________

Etj.____________________________

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik".

**Shtojca 16**

[*Shtojcë për tu plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor në rastin e Marrëveshjes Kuadër*]

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË MARRËVESHJEN KUADËR**

**(NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT[4])**

*[Data]*

Drejtuar: [Emri dhe adresa e operatorëve ekonomikë të suksesshëm]
1.________________________________________
*2.* ________________________________________
*3.*________________________________________

* * *

Procedura e prokurimit/Loti:_______________________
Numri i procedurës / referenca e Lotit_________________
Përshkrimi i shkurtër i kontratës: [shuma, objekti, kohëzgjatja e kontratës, etj.]_____________________
Publikimet e mëparshme (nëse aplikohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]_____________

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:
oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto ☐
oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim ☐

Me anë të kësaj bëjmë me dije se në këtë procedurë /lot kanë marrë pjesë operatorët ekonomikë me vlerat përkatëse si më poshtë:

1.__________________________________ ______________________________
*Emri i plotë i shoqërisë* *Numri i NIPT-it*

Vlera/ Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave (nëse është e zbatueshme)________ _______________________________________________________
*(e shprehur në shifra dhe në fjalë)*
2.__________________________________ ______________________________
*Emri i plotë i shoqërisë* *Numri i NIPT-it*
Vlera/ Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave (nëse është e zbatueshme)_____________________________________

*(e shprehur në shifra dhe në fjalë)*

Etj.____________________________

Janë skualifikuar Operatorët ekonomikë e mëposhtëm:

1.__________________________________ ________________ ____________

*Emri i plotë i shoqërisë* *Numri i NIPT-it* *arsyet*

[4] Ky Formulari është i aplikueshëm nëse ka ankime

2.__________________________________ ______________ _______________

*Emri i plotë i shoqërisë* *Numri i NIPT-it* *arsyet*

* * *

Duke iu referuar procedurës së mësipërme, ju informojmë se operatorët ekonomikë të mëposhtëm janë identifikuar si të suksesshëm:

1.__________________________________ ______________________________

*Emri i plotë i shoqërisë* *Numri i NIPT-it*

Vlera/ Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave (nëse është e zbatueshme)______________________________________*(e shprehur në shifra dhe në fjalë)*

Totali i pikëve të marra _______________

2.__________________________________ ______________________________

*Emri i plotë i shoqërisë* *Numri i NIPT-it*

Vlera/ Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave (nëse është e zbatueshme)______________________________________*(e shprehur në shifra dhe në fjalë)*

Totali i pikëve të marra _______________

Etj.______________________________

Si pasojë, nga ju kërkohet të paraqisni tek [*emri dhe adresa e Autoritetit/Entit Kontraktor* ] sigurimin e kontratës brenda ____________ ditëve nga data e marrjes të këtij njoftimi për të lidhur draft marrëveshjen.

Ankesat: (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr dhe datë)________________________________________

**[Titullari i Autoritetit /Entit Kontraktor]**

# Seksioni III Termat dhe Kushtet e Kontratës (TKK)

Ky Seksion përmban :

Shtojca 17: Kushtet e Përgjithshme të Kontratës

Shtojca 18: Kushtet e Veçanta të Kontratës

Shtojca 19: Formulari i Sigurimit të Kontratës

Shtojca 20: Draftmarrëveshja kuadër ku përcaktohen të gjitha kushtet

Shtojca 21: Draftmarrëveshja kuadër ku nuk përcaktohen të gjitha kushtet

**Shtojca 17**

# Kushtet e Përgjithshme të Kontratës (KPK)

Këto Kushte të Përgjithshme të Kontratës (KPK), së bashku me Kushtet e Veçanta dhe dokumentet e tjera të renditura në to, përbëjnë një dokument të plotë që shpreh të drejtat dhe detyrimet e palëve.

**Neni 1 Dispozitat e përgjithshme**

**1.1 Përkufizimet**

Në Kushtet e Kontratës ("këto Kushte"), të cilat përfshijnë Kushtet e Veçanta dhe këto Kushte të Përgjithshme, fjalët dhe shprehjet e mëposhtme kanë këto kuptime:

**1.1.1 Kontrata**

**1.1.1.1** "Kontrata" do të thotë kontrata me shpërblim, e lidhur me shkrim, ndërmjet një apo më shumë operatorëve ekonomikë dhe një ose më shumë autoriteteve ose enteve kontraktore, që kanë si objekt kryerjen e punimeve, furnizimin e mallrave dhe shërbimeve, në përputhje me LPP.

**1.1.1.2** "Dokumentet e Kontratës" do të thotë dokumentet e renditura në Kontratë, përfshirë çdo ndryshim të saj.

**1.1.1.3** "Çmimi i Kontratës" do të thotë çmimi që i paguhet Furnizuesit siç specifikohet në kontratë.

**1.1.1.4** "Përfundimi" do të thotë përmbushja e të gjitha detyrimeve, me ose pa penalitet, nga Furnizuesi në përputhje me termat dhe kushtet e përcaktuara në Kontratë.

**1.1.1.5** "Ndërprerje e Kontratës" do të thotë mosvijimi i ekzekutimit të Kontratës sipas përcaktimeve në Nenin 23.

**1.1.1.6** "Specifikime teknike" do të thotë karakteristikat e Shërbimeve objekt kontrate dhe çdo shtesë dhe modifikim i këtyre karakteristikave në përputhje me Kontratën.

**1.1.1.7** "Termat e Referencës" shprehin objektin dhe qëllimin e kontratës, përcaktojnë detyrat, kërkesat, objektivat, shpërndarjen, vendin dhe dorëzimin e Shërbimeve që do të sigurohen.

**1.1.1.8** "Listat" do të thotë dokumenti (et) me titull Listat të plotësuara nga Furnizuesi dhe të dorëzuara me ofertën, siç janë të përfshira në Kontratë . Dokumente të tilla mund të përfshijnë Listat e Çmimeve të dhëna, Listat e tarifave dhe / ose çmimeve.

**1.1.1.9** "Ofertë" do të thotë oferta ekonomike dhe të gjitha dokumentet e tjera që Furnizuesi ka dorëzuar me ofertën ekonomike, siç janë përfshirë në Kontratë.

**1.1.1.10** "KPK" do të thotë Kushtet e Përgjithshme të Kontratës.

**1.1.1.11** "KVK" do të thotë Kushtet e Veçanta të Kontratës.

**1.1.2 Palët e Kontratës**

**1.1.2.1** "Palë" do të thotë nënshkruesit e kontratës, në cilësinë e Blerësit dhe Furnizuesit sipas kontekstit.

**1.1.2.2** "Blerës" do të thotë Autoriteti/Enti Kontraktor përfituesi i Shërbimeve objekt kontrate.

**1.1.2.3** "Furnizues" do të thotë operatori (ët) ekonomik që kryen furnizimine Shërbimeve objekt kontrate.

**1.1.2.4** "Nënkontraktor" do të thotë çdo subjekt i caktuar si nënkontraktor për kryerjen e një pjese të Shërbimeve.

**1.1.3 Llogaritja e afateve**

**1.1.3.1** "Ditë" do të thotë një ditë kalendarike.

**1.1.4 Shërbimet**

**1.1.4.1** "Shërbime" do të thotë të gjitha detyrat që do të kryhen nga Furnizuesi sipas Kontratës.

**1.1.5 Përkufizime të tjera**

**1.1.5.1** "Adresa e Blerësit" është adresa e specifikuar në KVK.

**1.1.5.2** "Forca Madhore" është përcaktuar në Nenin 20“Forca Madhore”.

**1.1.5.3** "Sigurimi i Kontratës" është sipas përcaktimeve të Nenit 11 “Sigurimi i Kontratës”.

**1.1.5.4** “Vendi i kryerjes së Shërbimeve", do të thotë vendi i përcaktuar në KVK.

**1.1.5.5** “E paparashikueshme" ose "E paparashikuar" do të thotë një ngjarje objektivisht e pamundur të parashikohet në momentin e publikimit të Njoftimit të Kontratës në SPE.

**1.1.5.6** Modifikimi i kontratës" është sipas përcaktimeve në Nenin 21.

**1.1.5.7** “Legjislacioni në fushën e prokurimit" do të thotë LPP-ja, Rregullat e Prokurimit Publik dhe akte të tjera nënligjore në bazë dhe për zbatim të LPP –së siç specifikohet në KVK.

**1.1.5.8** "Praktikat e Ndaluara" kanë kuptimin e përcaktuar në LPP.

**1.2 Interpretimi**

**1.2.1** Interpretimi i Kontratës, përveç kur konteksti kërkon ndryshe:

(a) fjalët që tregojnë një gjini përfshijnë të gjitha gjinitë;

(b) fjalët që tregojnë njëjësin përfshijnë edhe shumësin dhe fjalët që tregojnë shumësin përfshijnë edhe njëjësin;

(c) dispozitat që përfshijnë fjalën "bie dakord", "rënë dakord” ose "marrëveshje" kërkojnë që marrëveshja të dokumentohet me shkrim;

(d) "i shkruar" ose "me shkrim" do të thotë i shkruar me dorë, i shkruar me makinë, printuar ose i bërë në mënyrë elektronike.

**1.2.2 Modifikimi**

Çdo modifikim i Kontratës i cili nuk kryhet me shkrim, dhe nuk përmban datën, apo nuk i referohet shprehimisht Kontratës dhe nuk nënshkruhet nga një përfaqësues i autorizuar rregullisht i secilës Palë është i pavlefshëm. Palët nuk mund të bëjnë modifikime të asnjë elementi të kontratës që do të sillnin ndryshime thelbësore në kushtet mbi bazën e të cilave është përzgjedhur Furnizuesi.

**1.2.3 Heqja dorë**

Çdo heqje dorë nga të drejtat, kompetencat ose mjetet ligjore të një Pale sipas Kontratës duhet të bëhet me shkrim, me datë dhe e nënshkruar nga një përfaqësues i autorizuar i Palës që bën këtë doreheqje, dhe duhet të specifikojë të drejtën dhe masën nga e cila po hiqet dorë.

**1.2.4 Ndikimi i pavarur i dispozitave të kontratës**

Nëse ndonjë dispozitë ose kusht i Kontratës është i ndaluar ose bëhet i pavlefshëm ose i pazbatueshëm, një ndalim, pavlefshmëri apo pazbatueshmëri e tillë nuk ndikon në vlefshmërinë ose zbatueshmërinë e ndonjë dispozite dhe kushti tjetër të Kontratës.

**1.3 Komunikimet**

Kurdo këto Kushte parashikojnë dhënien ose lëshimin e miratimeve, certifikatave, pëlqimeve, përcaktimeve, njoftimeve, kërkesave dhe shlyerjeve këto komunikime do të jenë:

(a) me shkrim dhe të dorëzuara dorazi (kundrejt marrjes), dërguar me postë ose korrier, ose transmetuar duke përdorur ndonjë nga sistemet e rëna dakord të transmetimit elektronik siç përshkruhet në KVK;

Dhe

(b) dorëzuar, dërguar ose transmetuar në adresën për komunikimet e marrësit siç përshkruhet në KVK. Sidoqoftë:

(i) nëse marrësi njofton një adresë tjetër, komunikimet do të dorëzohen në përputhje me rrethanat; dhe

(ii) nëse marrësi nuk ka deklaruar ndryshe kur kërkon një miratim ose pëlqim, mund të dërgohet në adresën nga e cila është lëshuar kërkesa.

Miratimet, pëlqimet dhe përcaktimet nuk do të mbahen ose vonohen pa arsye.

**1.4 Ligji dhe gjuha**

Kontrata do të rregullohet dhe interpretohet sipas legjislacionit Shqiptar në fuqi.

Gjuha e Kontratës do të jetë ajo e deklaruar në KVK.

Gjuha për komunikime do të jetë ajo e deklaruar në KVK. Nëse aty nuk përcaktohet asnjë gjuhë, gjuha për komunikime do të jetë gjuha e përcaktuar e Kontratës.

Dokumentet mbështetëse dhe literatura e shtypur që janë pjesë e Kontratës mund të jenë në një gjuhë tjetër me kusht që ato të shoqërohen nga një përkthim zyrtar i fragmenteve përkatëse dhe, për qëllime të interpretimit të Kontratës, ky përkthim do të mbizotërojë.

Furnizuesi do të përballojë të gjitha kostot e përkthimit dhe të gjitha risqet e saktësisë së një përkthimi të tillë, për dokumentet e siguruara nga Furnizuesi.

**1.5 Prioriteti i Dokumenteve**

Dokumentet që formojnë Kontratën duhet të konsiderohen reciprokisht shpjeguese të njëri-tjetrit. Nëse në dokumente gjendet një paqartësi ose mospërputhje, Blerësi lëshon çdo sqarim ose udhëzim të nevojshëm.

**1.6 Hartimi i Kontratës**

**1.6.1** Njoftimi i ofertës fituese në përfundim të afateve të ankimit do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të parashikuar në Dokumentat e Tenderit.

**1.6.2** Ekzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës.

**1.7 E drejta e autorit**

**1.7.1** Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, e drejta e autorit në të gjitha dokumentet dhe materialet e tjera që përmbajnë të dhëna dhe informacione të dhëna Blerësit nga Furnizuesi këtu do t'i mbeten Blerësit, edhe nëse ato i janë furnizuar Blerësit drejtpërdrejt ose përmes Furnizuesit nga ndonjë pale të tretë, përfshirë furnizuesit e materialeve.

**1.8 Detaje Konfidenciale**

Furnizuesi dhe personeli i Blerësit do të zbulojnë çdo informacion të tillë konfidencial dhe informacione të tjera që mund të kërkohen në mënyrë të arsyeshme për të verifikuar pajtueshmërinë e Furnizuesit me Kontratën dhe për të lejuar zbatimin e duhur të saj.

Secili prej tyre do t'i trajtojë të dhënat e kontratës në mënyrë konfidenciale, deri në masën e nevojshme për të kryer detyrimet e tyre përkatëse sipas Kontratës ose për të qenë në përputhje me ligjet në fuqi. Asnjë prej tyre nuk do të publikojë ose zbulojë të dhëna të veçanta të Shërbimeve të përgatitura nga Pala tjetër pa marrëveshjen paraprake të Palës tjetër. Sidoqoftë, Furnizuesit lejohen të zbulojnë çdo informacion publikisht të disponueshëm, ose informacion që kërkohet për të provuar kualifikimet e tij për të konkurruar në procedura të tjera.

Pavarësisht nga sa më sipër, Furnizuesi mund t'i sigurojë Nënkontraktorit (eve) të tij dokumente, të dhëna dhe informacione të tjera që merr nga Blerësi në masën e kërkuar që Nënkontraktori (ët) të kryejë punën e tij sipas Kontratës. Në rast të tillë, Furnizuesi duhet të përfshijë në kontratën e tij me Nënkontraktorin/ët një dispozitë që parashikon ruajtjen e konfidencialitetit sikurse parashikohet në adresë të Furnizuesit sipas këtij neni.

**1.9 Pajtueshmëria me ligjet**

Gjatë realizimit të Kontratës Furnizuesi respekton ligjet në fuqi.

Nëse nuk përcaktohet ndryshe në Kushtet e Veçanta:

(a) Blerësi siguron dhe paguan të gjitha lejet, miratimet dhe / ose licencat nga të gjitha autoritetet lokale, shtetërore ose kombëtare ose ndërmarrjet e shërbimeve publike në vendin e Blerësit që (i) autoritete ose ndërmarrje të tilla i kërkojnë Blerësit të sigurojë në emër të tij dhe (ii) janë të domosdoshëm për ekzekutimin e Kontratës, përfshirë ato që kërkohen për përmbushjen e detyrimeve përkatëse si nga Furnizuesi ashtu dhe Blerësi sipas Kontratës;

(b) Furnizuesi siguron dhe paguan të gjitha lejet, miratimet dhe / ose licencat nga të gjitha autoritetet lokale, shtetërore ose kombëtare ose ndërmarrjet e shërbimeve publike në vendin e Blerësit që autoritete ose ndërmarrje të tilla i kërkojnë Furnizuesit të sigurojë në emër të tij dhe që janë të nevojshme për kryerjen e Kontratës, duke përfshirë, pa u kufizuar, vizat për personelin e Furnizuesit dhe Nënkontraktorit dhe lejet e hyrjes për të gjitha pajisjet e importuara të Furnizuesit. Furnizuesi siguron të gjitha lejet, miratimet dhe / ose licencat e tjera që nuk janë përgjegjësi e Blerësit sipas pikës (a) te ketij neni këtu dhe që janë të nevojshme për ekzekutimin

e Kontratës. Furnizuesi do të dëmshpërblejë dhe zhdëmtojë Blerësin nga dhe kundër çdo dhe të gjitha detyrimeve, dëmeve, pretendimeve, gjobave, penaliteteve dhe shpenzimeve të çfarëdo natyre që lindin ose rezultojnë nga shkelja e ligjeve të tilla nga Furnizuesi ose personeli i tij, duke përfshirë Nënkontraktorët dhe personelin e tyre, por pa cënuar Nenin 9.1.

**1.10 Përgjegjësia e përbashkët dhe solidare**

Nëse Furnizuesi është një bashkim i Operatorëve Ekonomikë, të gjithë këta Operatorë Ekonomikë do të jenë bashkërisht dhe solidarisht përgjegjës ndaj Blerësit për përmbushjen e dispozitave të Kontratës.

**1.11 Inspektimet dhe Auditimi nga Blerësi**

Furnizuesi i përgjigjet pyetjeve dhe i jep Blerësit çdo informacion ose dokument të nevojshëm për (i) hetimin e pretendimeve të Praktikave të Ndaluara, ose (ii) ) monitorimin dhe vlerësimin nga ana e Blerësit të Kontratës dhe për t'i dhënë mundësi Blerësit të shqyrtojë dhe adresojë çdo problematikë në lidhje me Kontratën.
Furnizuesi mban të gjithë dokumentacionin në lidhje me zbatimin e Kontratës në përputhje me legjislacionin në fuqi.

**Neni 2 Praktikat e Ndaluara**

**2.1** Furnizuesi nuk do të autorizojë ose lejojë asnjë nga punonjësit ose përfaqësuesit e tij, të angazhohen në Praktika të Ndaluara në lidhje me prokurimin, dhënien ose ekzekutimin e Kontratës.

**2.2** Nëse Blerësi konstaton se dhënia e kontratës është bërë në kushtet e konfiktit të interesit dhe ky fakt nuk ka qenë i mundur të identifikohej më parë, i kërkon Komisionit të Prokurimit Publik të deklarojë kontratën absolutisht të pavlefshme.

Nëse Blerësi gjatë zbatimit të kontratës ka informacion për veprime korruptive informon organet kompetente.

**Neni 3 Njoftimet**

**3.1** Çdo njoftim i dhënë nga njëra Palë tek tjetra, në përputhje me Kontratën, do të bëhet me shkrim në adresën e specifikuar në KVK.

**3.2** Njoftimi do të ketë efekt sapo të dorëzohet.

**Neni 4 Objekti i Furnizimit**

**4.1** Shërbimet që do të furnizohen duhet të jenë sipas termave të referencës dhe kushteve të përcaktuara në Dokumentet e Tenderit.

**4.2** Kushtet e kontratës nuk ndryshojnë nga ato të përshkruara në dokumentet e tenderit dhe në ofertën fituese, me përjashtim të rasteve kur Furnizuesi, për arsye objektive dhe të pavarura prej tij në kohën e ofertimit ofron, me të njëjtin çmim, kushte më të mira se ato të tenderuara.

**Neni 5 Dorëzimi**

**5.1** Dorëzimi i Shërbimeve do të jetë në përputhje me kërkesat e specifikuara në Dokumentet e Tenderit.

**Neni 6 Përgjegjësitë e Furnizuesit**

**6.1** Furnizuesi do të jetë përgjegjës për kryerjen e e të gjitha Shërbimeve në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Dokumentet e Tenderit.

**Neni 7 Detyrimet e Përgjithshme të Furnizuesit**

**7.1** Furnizuesi duhet t'i kryejë Shërbimet dhe përmbushë detyrimet e tij me të gjitha përpjekjet, eficiente dhe ekonomike në pajtim me teknikat dhe praktikat profesionale të pranuara në përgjithësi.

**7.2** Furnizuesi duhet të ndjekë praktika të shëndosha të biznesit dhe të përdorë teknologji të avancuar dhe të përshtatshme si dhe metoda të sigurta.

**7.3** Nëse kontrata kërkon kryerjen e shërbimeve këshillimore profesionale, Furnizuesi duhet të veprojë gjithmonë si një këshillues besnik i Blerësit, në pajtim me rregullat dhe kodin e sjelljes të profesionit të tij dhe duhet që të mbështesë dhe ruajë gjithmonë interesin publik.

**7.4** Nëse kontrata kërkon kryerjen e shërbimeve këshillimore profesionale, Furnizuesi duhet të ushtrojë kujdes të plotë në marrëdhëniet me palët e treta duke përfshirë median dhe nuk duhet të marrë pjesë në veprime që janë jashtë kompetencës së tij në përfaqësimin e Blerësit.

**Neni 8 Detyrimet e Veçanta të Furnizuesit**

Furnizuesi duhet të kryejë të gjitha Shërbimet siç specifikohet tek Termat e Referencës.

**8.18.2**

Furnizuesi duhet t'i paraqesë Blerësit të gjitha shërbimet, në sasitë e përcaktuara, siç kërkohen nga kontrata duke përfshirë, por jo të kufizuara nga, të gjitha raportet, dokumentat, studimet, skicimet dhe planimetritë.

**8.3** Furnizuesi duhet të sigurojë raportet e lidhura me zbatimin e Shërbimeve siç kërkohet në kontratë.

**Neni 9 Çmimi i Kontratës**

**9.1** Çmimi i kontratës do të jetë i pandryshueshëm përgjatë kohëzgjatjes së realizimit të Kontratës, përveç rasteve të parashikuara në Nenin 19.

**Neni 10 Kushtet e Pagesës**

**10.1** Çmimi i Kontratës do të paguhet siç specifikohet në KVK.

Furnizuesi duhet të paguhet nga Blerësi për Shërbimet e kryera, në përmbushjen e të gjitha detyrimeve të parashikuara në Kontratë.

**10.2** Pagesat do të kryhen menjëherë nga Blerësi, jo më vonë se periudha kohore e specifikuar në KVK pas dorëzimit të një fature ose kërkese për pagesë nga Furnizuesi, dhe pasi Blerësi ta ketë pranuar atë.

**10.3** Nëse nuk përcaktohet ndryshe në KVK, pagesa duhet bërë në monedhë Shqiptare. Kursi i këmbimit të monedhave të ndryshme do të jetë kursi i Bankës së Shqipërisë i fiksuar në ditën e dërgimit për publikim të njoftimit të kontratës.

**10.4** Në rast të verifikimit të vonesave në kryerjen e pagesave nga ana e Blerësit, megjithëse Furnizuesi ka përmbushur të gjitha detyrimet e tij në përputhje me kushtet e kontratës, detyrimet e prapambetura dhe kamatëvonesat përkatëse do të kryhen në përputhje me parashikimet e Ligjit Nr. 48/2014 "Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare".

**Neni 11 gurimi i Kontratës**

**11.1** Furnizuesi, brenda afatit të caktuar nga Blerësi në njoftimin e fituesit, paraqet Sigurimin e Kontratës në shumën e specifikuar në KVK.

**11.2** Në përputhje me Nenin 11.1, Sigurimi i Kontratës do të shprehet në monedhën e Kontratës dhe do të jetë në formën e përcaktuar nga Blerësi në KVK.

**11.3** Shuma nga Sigurimi i Kontratës do t'i paguhet Blerësit si kompensim për çdo humbje të rezultuar nga mospërmbushja e detyrimeve sipas Kontratës nga ana e Furnizuesit.

**11.4** Sigurimi i Kontratës do t'i kthehet Furnizuesit jo më vonë se tridhjetë (30) ditë pas datës së përmbushjes së detyrimeve së Furnizuesit sipas Kontratës, përfshirë çdo detyrim garancie, përveç rasteve kur specifikohet ndryshe në KVK.

**Neni 12 Nënkontraktimi**

**12.1** Nënkontraktimi nuk duhet të bëhet pa aprovimin paraprak me shkrim të Blerësit dhe jo më shumë se 50% të vlerës së kontratës.

**12.2** Blerësi lejohet të bëjë pagesa drejtpërsëdrejti tek nënkontraktori për shërbimet që do të kryejë, me miratimin paraprak me shkrim të Furnizuesit.

**12.3** Parashikimet e Nenit 2 zbatohen edhe për nënkontraktimin.

**Neni 13 Specifikime dhe Skicime**

**13.1** Nëse kontrata kërkon shërbime skicimi, Furnizuesi duhet të përgatisë të gjitha specifikimet dhe skicimet duke përdorur sisteme të pranuara dhe të njohura në përgjithësi të pranueshme për Blerësin dhe të marrë parasysh standartet më të fundit.

**13.2** Nëse kontrata kërkon shërbime skicimi, Furnizuesi duhet të sigurojë se të gjitha specifikimet, skicimet dhe kërkesat e tjera janë përgatitur në bazë asnjanëse përsa i përket nxitjes së konkurrencës në prokurimin e objekteve të skicimit.

**Neni 14 Siguracioni i Përgjegjësisë Profesionale**

**14.1** Furnizuesi duhet të mbajë siguracion për përgjegjësi profesionale sipas rregullave dhe praktikave të njohura në përgjithësi për profesionin për ta zhdëmtuar Blerësin për dëme të rezultuara nga neglizhenca, gabimet ose mangësitë, në kryerjen e Shërbimeve.

**14.2** Nëse nuk është përcaktuar në kontratë shuma minimale e siguracionit, Furnizuesi duhet të sigurojë siguracion në shumën e njohur në përgjithësi si të mjaftueshme nën rrethanat e Shrbimeve që po sigurohen.

**Neni 15 Dëmet e likujduara**

**15.1** Dëmet e likujduara për kryerjen e vonuar të shërbimeve do të llogariten me tarifat e mëposhtme ditore:

a) Për kontratat me periudhë zbatimi, jo më shumë se 6 muaj, tarifa ditore do të jetë 4/1000 e vlerës përkatëse të mbetur, nga çmimi i përgjithshëm i Kontratës, por jo më pak se 25% e vlerës së Kontratës.

b) Për kontratat me periudhë zbatimi, jo më shumë se 12 muaj, tarifa ditore do të jetë 2/1000 e vlerës përkatëse të mbetur, nga çmimi i përgjithshëm i Kontratës, por jo më pak se 25% e vlerës së kontratës.

c) Për kontratat me periudhë zbatimi më shumë se 12 muaj, tarifa ditore do të jetë 1/1000 e vlerës përkatëse të mbetur, nga çmimi i përgjithshëm i Kontratës, por jo më pak se 25% e vlerës së kontratës.

**Neni 16 Heqja dhe Zëvendësimi i Personelit Kryesor**

**16.1** Furnizuesi duhet të sigurojë aprovim paraprak me shkrim nga Blerësi përpara heqjes ose zëvendësimit të personelit kryesor siç përshkruhet në ofertën e Furnizuesit.

**16.2** Furnizuesi do të zëvendësojë çdo punonjës nëse Blerësi zbulon se personi ka kryer veprime të jashtëligjshme ose Blerësi është mjaft i pakënaqur nga puna e personit.

**16.3** Nëse bëhet e nevojshme të zëvendësohet ndonjë nga personeli kryesor, Furnizuesi duhet të sigurojë si zëvendësues një person me kualifikime ekuivalente ose më të mira.

**16.4** Furnizuesi do të paguajë kosto shtesë për zëvendësimin e personelit kryesor me përjashtim kur shkaku i zëvendësimit ka ardhur nga neglizhenca ose mungesa e kujdesit të Blerësit.

**Neni 17 Zhdëmtimi i Patentës**

**17.1** Furnizuesi dëmshpërblen dhe zhdëmton Blerësin dhe zyrtarët e tij nga dhe kundër padive, veprimeve ose procedurave administrative, pretendimeve, kërkesave, humbjeve, dëmeve, kostove dhe shpenzime të çdo natyre, përfshirë tarifat e avokatit dhe shpenzimet, të cilat Blerësi mund të pësojë si rezultat i çdo shkelje ose shkelje të pretenduar të ndonjë patente, modeli, skice të regjistruar, marke tregtare, të drejte autori ose një të drejte tjetër të pronësisë intelektuale të regjistruar ose që përndryshe ekzistonte në datën e kontratës për shkak të:

(a) ofrimit të shërbimeve nga Furnizuesi ose përdorimit të shërbimeve në vendin e dorëzimit të Shërbimeve;

dhe

(b) shitjen në çdo vend të produkteve të prodhuara nga Shërbimet.

Një zhdëmtim i tillë nuk aplikohet nëse Shërbimet ose ndonjë pjesë e tyre përdoren përtej kushteve të kontratës ose përdorimi i tyre ose i një pjese të tyre bëhet në kombinim me ndonjë pajisje, impiant ose material tjetër që nuk është furnizuar nga Furnizuesi, në përputhje me Kontratën.

**17.2** Nëse është nisur ndonjë procedurë apo ngritur ndonjë kërkesë kundër Blerësit që del nga çështjet e përmendura në Nenin 15.1, Blerësi do të njoftojë menjëherë Furnizuesin, dhe Furnizuesi mundet me shpenzimet e tij dhe në emër të Blerësit të ndërmarrë të gjitha veprimet për zgjidhjen e ndonjë procedure apo pretendimi të tillë.

**17.3** Nëse Furnizuesi nuk e njofton Blerësin brenda tridhjetë (30) ditëve pas marrjes së një njoftimi të tillë, atëherë Blerësi do të jetë i lirë të kryejë të njëjtën gjë në emër dhe për llogari të tij.

Blerësi, me kërkesën e Furnizuesit, do ti japë Furnizuesit të gjithë ndihmën në dispozicion në kryerjen e procedurave të tilla dhe do të rimbursohet nga Furnizuesi për të gjitha shpenzimet e arsyeshme të kryera në këtë mënyrë.

Blerësi dëmshpërblen dhe zhdëmton Furnizuesin dhe punonjësit, dhe nënkontraktorët e tij nga dhe kundër çdo padie, veprimi apo procedure administrative, që Furnizuesi mund të pësojë si rezultat i çdo shkelje ose shkelje të pretenduar të ndonjë patente, modeli, skice të regjistruar, marke tregtare, të drejte autori ose një të drejte tjetër të pronësisë intelektuale të regjistruar ose që ekzistonte në datën e kontratës që lind nga ose në lidhje me çdo skicim, të dhënë, vizatim, specifikim apo dokument apo materiale të tjera të ofruara apo skicuara nga ose në emër të Blerësit.

**Neni 18 Kufizimi i Përgjegjësisë**

**18.1** Me përjashtim të rasteve të neglizhencës së rëndë ose shkelje me dashje:

(a) Furnizuesi nuk do të jetë përgjegjës ndaj Blerësit, për ndonjë humbje apo dëm indirekt ose që ka si pasojë, humbje të përdorimit, humbje të prodhimit, ose humbje të fitimeve ose kostove të interesit, me kusht që ky përjashtim të mos zbatohet për asnjë detyrim të Furnizuesit për t'i paguar Blerësit dëmet e likujduara; dhe

(b) përgjegjësia e përgjithshme e Furnizuesit ndaj Blerësit, nuk duhet të kalojë Çmimin e Kontratës, me përjashtim të rasteve për koston e dëmeve të rezultuara nga gabimet ose mangësitë në kryerjen e shërbimeve, ose çdo detyrim të Furnizuesit për të zhdëmtuar Blerësin në lidhje me shkeljen e patentës.

**Neni 19 Ndryshime në aktet ligjore dhe nënligjorë**

**19.1** Nëse pas datës së dorëzimit të ofertave ose datës së nënshkrimit të kontratës, ndonjë ligj ose akt nënligjor në Republikën e Shqipërisë hyn në fuqi ose ndryshon dhe ndikon kushtet, duke përfshirë datën e dorëzimit ose çmimin e kontratës, kushtet ose çmimi i kontratës do të rregullohen në atë masë sa Furnizuesi është ndikuar në përmbushjen e detyrimeve të tij sipas kontratës.

**Neni 20 Forca madhore**

**20.1** Mos kryerja apo kryerja me vonesë nga ana e një Pale të ndonjë prej detyrimeve të saj sipas kësaj Kontrate nuk do të konsiderohet shkelje e kësaj Kontrate nëse një mospërmbushje apo vonesë e tillë vjen drejtpërdrejt për shkak të ndonjë ngjarje të Forcës Madhore.

**20.2** Për qëllime të këtij neni, "Ngjarja e Forcës Madhore" do të thotë një ngjarje ose situatë përtej kontrollit të një Pale që nuk është e parashikueshme, është e pashmangshme dhe nuk shkaktohet nga neglizhenca ose mungesa e kujdesit nga njëra Palë. Ngjarje të tilla mund të përfshijnë, por nuk kufizohen në,

veprime të një Pale qoftë në kapacitetin e tij sovran ose kontraktual, luftërat ose revolucionet, zjarret, përmbytjet, epidemitë/pandemitë, kufizimet e karantinës dhe embargo e mallrave.

**20.3** Nëse ndodh një Ngjarje e Forcës Madhore, Pala e prekur do të njoftojë menjëherë Palën tjetër me shkrim për gjendjen e tillë dhe shkakun e saj. Në qoftë se nuk udhëzohet ndryshe nga Pala tjetër me shkrim, Pala e prekur do të vazhdojë të kryejë detyrimet e saj sipas Kontratës për aq sa është e arsyeshme e praktikueshme dhe do të kërkojë të gjitha mjetet e arsyeshme alternative për realizimin që nuk pengohen nga Ngjarja e Forcës Madhore

**Neni 21 Modifikimi i Kontratës**

**21.1** Palët mund të modifikojnë kontratën gjatë afatit të saj, vetëm nëse ndodhen në ndonjë nga rastet e parashikuara në LPP.

**21.2** Kur modifikimi shoqërohet me rritje të vlerës së Kontratës, vlera totale e modifikimeve nuk duhet të tejkalojë 20% të vlerës së kontratës fillestare. Kur kryhen disa modifikime të njëpasnjëshme, ky kufizim duhet të aplikohet për vlerën e përgjithshme të të gjitha modifikimeve. Kur kontrata përmban një klauzolë të rishikimit të çmimit, baza për përllogaritjen e vlerës maksimale të lejuar për modifikimet do të jetë vlera e kontratës me çmimin e përditësuar.

**21.3** Asnjë modifikim i Kontratës nuk do të bëhet pa miratimin paraprak të Blerësit, shoqëruar me një marrëveshje me shkrim dhe të nënshkruar nga një përfaqësues i autorizuar i Furnizuesit dhe Blerësit.

**Neni 22 Zgjatja e afatit**

**22.1** Nëse në çdo kohë gjatë ekzekutimit të Kontratës, Furnizuesi ose nënkontraktorët e tij hasin kushte që pengojnë kryerjen në kohë të Shërbimeve në përputhje me Nenin 5, Furnizuesi njofton menjëherë Blerësin me shkrim për vonesën, kohëzgjatjen e mundshme dhe shkakun e saj. Sa më shpejt që të jetë e mundur pas marrjes së njoftimit të Furnizuesit, Blerësi vlerëson situatën dhe në bazë të diskrecionit të tij mund të zgjasë kohën e realizimit nga ana e Furnizuesit. Në këtë rast zgjatja miratohet nga Palët dhe reflektohet në modifikimin e Kontratës.

**22.2** Me përjashtim të rastit të Forcës Madhore, siç parashikohet në Nenin 20, një vonesë nga Furnizuesi në kryerjen e detyrimeve të Dorëzimit dhe Përfundimit do ta bëjë Furnizuesin përgjegjës për pagesën e dëmeve të likujduara në përputhje me parashikimet në kontratë.

**Neni 23 Ndërprerja e Kontratës**

**23.1** **Njoftim për të korrigjuar**

Nëse Furnizuesi nuk përmbush ndonjë detyrim sipas Kontratës, Blerësi mund ti kërkojë me Njoftim që Furnizuesi të ndreqë mospërmbushjen brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve.

**23.2** **Ndërprerja për mospërmbushje**

Blerësi, pa cenuar ndonjë mjet tjetër ligjor në lidhje me shkeljen e Kontratës, mundet me anë të një Njoftimi me shkrim për mospërmbushje që i dërgohet Furnizuesit, ta përfundojë Kontratën në tërësi ose pjesërisht:

(i) nëse Furnizuesi nuk ka përmbushur detyrimin edhe pas Njoftimit të bërë sipas pikës 23.1 të këtij neni;

(ii) Nëse Furnizuesi nuk ka arritur të kryejë Shërbimet brenda periudhës së specifikuar në Kontratë, ose brenda ndonjë zgjatjeje të dhënë nga Blerësi në përputhje me Nenin 22; ose

(iii) Nëse provohet se Furnizuesi është angazhuar në Praktika të Ndaluara, siç përcaktohet në Nenin 2, gjatë konkurrimit për Kontratën apo ekzekutimit të saj.

**23.3 Ndërprerja për paaftësi paguese**

Blerësi ndërpret në çdo kohë Kontratën duke njoftuar Furnizuesin nëse Furnizuesi falimenton. Furnizuesi ndërpret në çdo kohë Kontratën nëse Blerësi nuk ka aftësi paguese. Në një rast të tillë, ndërprerja do të bëhet pa kompensim për Furnizuesin, me kusht që kjo ndërprerje nuk do të cenojë ose ndikojë në ndonjë të drejtë padie apo mjeti ligjor që ka lindur apo do të lindë më pas për Blerësin.

**23.4 Ndërprerja për Shkak të Interesit Publik**

a) Blerësi mund të ndërpresë kontratën në çdo kohë nëse gjykon se ky veprim duhet ndërmarrë për t'i shërbyer sa më mirë interesit publik.

b) Blerësi duhet të njoftojë me shkrim Furnizuesin për ndërprerjen.

c) Blerësi duhet të paguajë Furnizuesin për të gjitha Shërbimet e kryera përpara ndërprerjes dhe duhet t'i paguajë Furnizuesit dëmet e shkaktuara për kryerjen e pjesshme të Shërbimeve. Në llogaritjen e shumës së dëmeve, Furnizuesit do t'i kërkohet të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për të minimizuar dëmet.

**Neni 24 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

**24.1** Blerësi dhe Furnizuesi do të bëjnë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur në mënyrë miqësore përmes bisedimeve të drejtpërdrejta çdo mosmarrëveshje që lind midis tyre gjatë ekzekutimit të Kontratës.

**24.2** Nëse, palët nuk arrijnë të zgjidhin mosmarrëveshjen e tyre me një konsultim të tillë të ndërsjellë, atëherë secila Palë mund t'i njoftojë Palës tjetër për qëllimin e saj për të shkuar në Gjykatë.

**Shtojca 18**

# Kushtet e Veçanta të Kontratës

Kushtet e mëposhtme të veçanta të Kontratës do të plotësojnë KPK. Nëse ka një konflikt, dispozitat e KVK do të mbizotërojnë mbi ato në KPK.

**Neni 1 Dispozitat e Përgjithshme**

**1.1** Blerësi është: ***[vendos emrin e Blerësit ]***

Adresa: ______________________________________________________________

Telefoni: _____________________________________________________________

Numri i faksit: _________________________________________________________

E-mail: _______________________________________________________________

**1.2** Furnizuesi është: ***[vendos emrin e Furnizuesit]***

Adresa: ______________________________________________________________

Telefoni: _____________________________________________________________

Numri i faksit: _________________________________________________________

E-mail: _______________________________________________________________

*Të dhënat e mësipërme duhet të jenë të sakta për qëllime të komunikimeve gjatë zbatimit të kontratës*.

**1.3** Gjuha për komunikimet është ***[specifiko gjuhën për komunikime]****:*

Gjuha është: ***[specifiko gjuhën]***

**Neni 2 Sigurimi i Kontratës**

**2.1** Sigurimi i Kontratës në shumën prej (10% të vlerës së saj) duhet të ofrohet nga Furnizuesi për të siguruar ekzekutimin e detyrimeve të tij sipas kontratës.

**2.2** Monedha do të jetë: [specifikoni monedhën]

**2.3** Sigurimi i Kontratës do t'i lëshohet ose kthehet, menjëherë Furnizuesit sipas formularit të mëposhtëm

**2.4**

Nëse parashikohet një ulje periodike e sigurimit të Kontratës, ajo kryhet si më poshtë: ___________________________________________________________________________

Nëse nuk plotësohet, sigurimi mbetet i pandryshuar.

**Neni 3 Vendodhja e Shërbimeve**

3.1 Shërbimet do të kryhen në:___________________________

**Neni 4 Informacion që duhet dhënë nga Blerësi**

4.1 Brenda 15 ditësh nga marrja e sigurimit të kontratës, Blerësi duhet t'i japë Furnizuesit informacionin dhe dokumentat e mëposhtme:

## Neni 5 Kërkesat e Raportimit

5.2 Gjatë zgjatjes së kontratës, Furnizuesi duhet të sigurojë raporte për Blerësin sipas formularit të mëposhtëm: ______________________________________________________________________________

**Neni 6 Siguracioni i Përgjegjësisë Profesionale**

6.1 Përpara fillimit të zbatimit të kontratës, Kontraktuesi duhet të sigurojë Autoritetin/entin Kontraktor me prova për siguracionin e përgjegjësisë profesionale me shumë minimale si vijon: ______________________________________________________________________________

**Neni 7 Çmimi i Kontratës**

Çmimi i Kontratës është: ________________________

**Neni 8 Kushtet e pagesës**

8.1 (a) Pagesa për Shërbimet do të bëhet brenda _________ ditëve nga data e pranimit të Shërbimeve ose nga data e marrjes së kërkesës për pagesë me shkrim, pavarësisht nga dita e ardhjes. Nëse nuk specifikohet, periudha kohore do të jetë 30 ditë

(b) Pagesa do të bëhet në monedhën ______. Nëse lihet e paplotësuar, pagesa do të bëhet në monedhën . Shqiptare.

**8.2** Të gjitha pagesat e shumave që i detyrohen Furnizuesit mund të bëhen vetëm në llogarinë bankare të Furnizuesit të detajuar në mënyrë të qartë në Kontratë.

**_Neni 9 Garancia**

Periudha e vlefshmërisë së garancisë do të jetë si më poshtë:

**Shtojca 19**

[ *Shtojcë për t'u paraqitur nga Operatori Ekonomik*]

**FORMULARI I SIGURIMIT TË KONTRATËS**

*[Data]*

Për: *[Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]*

Në emër të: *[Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]*

* * *

Procedura e prokurimit: *[lloji i procedurës]*

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[ objekti]*

Publikimi *(nëse zbatohet):* Buletini i Njoftimeve Publike *[Data] [Numri]*

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, dhe me kusht që [*emri i ofertuesit të përcaktuar fitues*] t'i jetë akorduar kontrata,

Ne vërtetojmë se [*emri i ofertuesit të përcaktuar fitues*] ka derdhur një depozitë pranë [*emri dhe adresa e bankës / kompanisë së sigurimeve*] në një shumë prej [*monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra*] si kusht për sigurimin e ekzekutimit të kontratës, që do të nënshkruhet me [*emri i autoritetit/enti kontraktor*]

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [*emri i autoritetit /entit kontraktor*] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mos-përmbushjen e kushteve të kontratës.

Ky Sigurim është i vlefshëm deri në zbatimin plotë të kontratës.

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimeve]

**Shtojca 20**

# Draft i Marrëveshjes Kuadër (Ku përcaktohen të gjitha kushtet)

**PER PUNË / MALLRA/ SHËRBIME**

[Përdorimi i kësaj drafte marrëveshje është i detyrueshëm për të gjithë autoritetet/entet kontraktore që do të përdorin Marrëveshjen Kuadër]

**Nr . __**

**datë :**

Kjo Marrëveshje është lidhur më [datë] ndërmjet [emri dhe adresa e Autoritetit /Entit Kontraktor], këtu e tutje referuar si "Autoriteti /Enti Kontraktor" dhe [emri dhe adresa e Kontraktorit] përfaqësuar nga [përfaqësuesi], këtu e më tej referuar si "Kontraktori ".

Kontraktori, përmes ofertës së tij, me datë [data] pajtohet të kryejë shërbimin, siç specifikohet në kushtet e përcaktuara në:
-Këtë Formular;
-Formularin e Deklarimit të Ofertës të paraqitur nga Ofertuesi;
-Specifikimet Teknike;
-Listën e Çmimeve të Shërbimeve.

Të gjitha këto dokumente janë të bashkangjitura, si pjesë integrale e kësaj marrëveshje.

**Neni 1 Objekti**

1.1 Objekti i Marrëveshjes Kuadër është të përcaktojë kushtet, përfshirë çmimet për njësi dhe rregullat për dërgimin e mallrave / shërbimeve / punëve të mëposhtme.

[ Përshkrim i përgjithshëm ]

1.2 Marrëveshja Kuadër do të zbatohet duke dërguar ftesa për oferta tek Operatorët Ekonomikë, palë në marrëveshje sipas nevojave të Autoritetit/entit kontraktor.

1.3 Shumat e dhëna këtu janë vetëm për qëllime orientimi dhe NUK e detyrojnë Autoritetin/Entin Kontraktor t'i blejë ato. Autoriteti/Enti Kontraktor ka të drejtë të blejë më pak ose më shumë sasi sesa ato të parashikuara.

1.4 Kontraktori nuk do të ketë të drejtë për kompensim dhe nuk do të lejohet të bëjë ndryshime në çmimet për njësi, për shembull nëse Autoriteti/enti Kontraktor vendos të blejë më pak ose më shumë sasi sesa ato të parashikuara të specifikuara dhe / ose nëse Autoriteti/enti Kontraktor vendos të mos blejë cilëndo nga këto sasi për disa artikuj.

1.5 Kohëzgjatja e Marrëveshjes Kuadër:___________________________________________________

**Neni 2 Çmimi**

2.1 Çmimet për njësi për punë / mallra / shërbime përshkruhen në Listen e Çmimit të Shërbimeve.

2.2 Çmimet për njësi do të jenë fikse dhe nuk do të ndryshojnë për porositë e bëra në bazë të kësaj Marrëveshje Kuadër.

**Nënshkrimet dhe datat**

**Për Kontraktorin** **Për Autoritetin /Entin Kontraktor**

| | | | |
|---|---|---|---|
| **Emri:** | | **Emri:** | |
| Pozicioni: | | Pozicioni: | |
| Firma: | | Firma: | |
| Data: | | Data: | |
| **Vula:** | | **Vula:** | |

## Shtojca 21

# Draft Marrëveshja Kuadër (Ku nuk përcaktohen të gjitha kushtet)

## PËR PUNËT/ MALLRAT / SHËRBIMET

Emri i Autoritetit/Enti Kontraktor,

dhe

Emri i Kontraktorit

Bien dakord si më poshtë:

**Të nënshkruajnë Marrëveshjen Kuadër për objektin**: <shëno titullin> me numrin identifikues: *<shëno numrin e prokurimit>*

**Neni 1 Objekti**.
1 Objekti i kësaj marrëveshje kuadër është të vendosë rregullat për kontratat që do të lidhen përmes procesit të Mini – konkurrimit vetëm midis Operatorëve Ekonomik që janë palë në këtë Marrëveshje Kuadër.

1.2 Kjo Marrëveshje Kuadër nuk është një kontratë në vetvete, por përcakton kushtet për kontratat që do të lidhen, bazuar në të.

1.3 Kontraktori është vetëm një prej palëve të Marrëveshjes Kuadër.

**Neni 2 Detyrimet e Palëve**

2.1 Autoriteti /Enti Kontraktor, palë në këtë marrëveshje, do t'i dërgojë Kontraktuesit një "Ftesë për Ofertë" sa herë që ka nevojë për punë / mallra / shërbime.

2.2 Kontraktori është i detyruar të paraqesë një Ofertë sa herë që kërkohet nga Autoriteti /enti Kontraktor.

**Neni 3 Kontratat në zbatimin e Marrëveshjes Kuadër**

1.1 Kontratat do të nënshkruhen vetëm pas procesit të mini-konkurrimit.

**Neni 4 Procesi i mini-konkurrimit**

4.1 Procesi i mini-konkurrimit do të zhvillohet me të gjithë operatorët ekonomik, palë në Marrëveshjen Kuadër, kurdoherë që ka nevojë për punë / mallra / shërbime nga ana e Autoritetet/entet Kontraktore.

4.2 Autoriteti/Enti Kontraktor do të rihapë konkurrimin në të njëjtat kushte ose kushte të tjera të përcaktuara në Ftesën për Oferta, siç përcaktohet në Dokumentet e Tenderit.

4.3 Sa herë që ka nevojë për punë / mallra / shërbime, Autoriteti/Enti Kontraktor përgatit Ftesat për Oferta dhe i dërgon ato te të gjithë Operatorët Ekonomik, palë në Marrëveshjen Kuadër. Vlerësimi i Ofertave do të bazohet në kriteret e përcaktuara në Ftesën për Oferta.

**Neni 5 Kohëzgjatja e Marrëveshjes Kuadër __________________________________**

**Firmat dhe Data____________________________________________________________**

**Për Kontraktorin** **Për Autoritetin/Entin Kontraktor**

| | | | |
|---|---|---|---|
| **Emri:** | | **Emri:** | |
| Pozicioni: | | Pozicioni: | |
| Firma: | | Firma: | |
| Data: | | Data: | |
| **Vula:** | | **Vula:** | |

# SEKSIONI IV

## Ankimi dhe Njoftimet për mbylljen e procesit

**Shtojca 22**: Formulari i Ankesës pranë Autoritetit/Entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik

**Shtojca23**:Formulari i paraqitjes së argumenteve nga operatorët ekonomikë të interesuar pranë Autoritetit/Entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik

**Shtojca 24** : Njoftimi i Kontratës së nënshkruar

**Shtojca:25** : Njoftimi i kontratës së nënshkruar që publikohet në Buletinin e Njoftimeve Publike

**Shtojca 26:** Formulari i anulimit te procedurës

**Shtojca 22**

**FORMULARI I ANKESËS PRANË AUTORITETIT/ENTIT KONTRAKTOR DHE KOMISIONIT TË PROKURIMIT PUBLIK**

Ankesë drejtuar: Autoriteti/Entit Kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik ☐

**Seksioni I. Identifikimi i ankimuesit**

*Ankimuesi mund të jetë një ofertues ose ofertues i mundshëm (p.sh. individ, operator ekonomik, shoqatë, bashkim operatoresh ekonomike)*

______________________________________________

Emri i plotë i ankimuesit (ju lutem shtypeni)

______________________________________________

Nuis/Nipt

______________________________________________

Adresa

______________ ______________ ______________

Qyteti Shteti Kodi Postar / Posta

______________________ ______________________

Numri i telefonit (përfshirë kodin e zonës) Numri i faksit (përfshirë kodin e zonës)

______________________________________________

E-mail

______________________________________________

Emri dhe titulli i zyrtarit të autorizuar për lëshimin e ankesës (ju lutemi shkruani)

______________________ ______________________

Nënshkrimi i zyrtarit të autorizuar Data (viti/muaji/dita)

______________________ ______________________

Numri i telefonit (përfshirë kodin e zonës) Numri i faksit (përfshirë kodin e zonës)

**Seksioni II. Informacion mbi procedurën**

1. **Numri i referencës së procedurës/Lotit**

*Plotësoni numrin e referencës se kontratës në njoftimin e kontratës ose në dokumentet e tenderit.*

______________________________________________

2. **Lloji i Procedurës**

*Plotësoni llojin e procedurës së përdorur për prokurimin në fjalë.*

| | |
|---|---|
| Procedurë e hapur ☐ | Procedurë e hapur e thjeshtuar ☐ |
| Procedurë e kufizuar ☐ | Procedurë konkurruese me negocim ☐ |
| Partneritet për inovacion ☐ | Dialog konkurrues ☐ |
| Procedurë me negocim me shpallje paraprake të njoftimit ☐ | Procedurë me negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës ☐ |
| Shërbim Konsulence ☐ | |
| Kontratë e lidhur pa zhvilluar ndonjë nga procedurat e prokurimit të parashikuara në LPP ☐ | |

3. Autoriteti /Enti Kontraktor
*Emri i autoritetit/entit kontraktor që administron procesin e prokurimit.*

____________________________________________________________

4. Vlera e përllogaritur e prokurimit
(*Vlera e përllogaritur e kontratës/marrëveshjes kuadër) (shuma në shifra dhe fjalë)*

____________________________________________________________

5. Objekti i kontratës/Marreveshjes Kuadër
(*Përshkrimi i shkurtër i punëve / mallrave / shërbimeve objekt kontrate/marreveshje kuader).*

____________________________________________________________

6. Afati i fundit për paraqitjen e ofertës
(*Data (viti/muaji/dita*)

____________________________________________________________

7. Data e publikimit te Njoftimit te Fituesit
(*Data (viti/muaji/dita) nëse është e zbatueshme*)

8. **Data e nënshkrimit të kontratës**

(*Data (viti/muaji/dita) në rastet e kërkesave për pavlefshmërinë e kontratës*)

## Seksioni III. Përshkrimi i ankesës

1.Baza ligjore (Shkelje ligjore, bazuar në vendime, akte, dokumente, etj.)

2. **Objekti i ankesës**

- Modifikim i dokumenteve të tenderit

☐

- Kundërshtim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me skualifikimin e ofertës tuaj.

☐

*(Citoni këtu arsyet e skualifikimit)*

- Kundërshtim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me kualifikimin e ofertës të një/disa operatori/ve ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit.

☐

*(Citoni operatorin/ët ekonomik për të cilin keni pretendime)*

- Pavlefshmëri kontrate

☐

*(Citoni kontratën për të cilën kërkoni pavlefshmërinë)*

- Tjetër

☐

*(Citoni këtu objektin e ankesës që nuk përfshihet më sipër)*

**3. Rrethanat dhe faktet**

*Përshkruani rrethanat e faktit.*

**4. Argumentime mbi shkeljet e pretenduara**

*Përshkruani në mënyrë koncize shkeljet e pretenduara, duke argumentuar qartë dhe saktë se përse pretendoni për paligjshmëri në veprimet e autoritetit kontraktor.*

**5. Kërkesë për ekspertizë të posaçme**

| Po | Jo |
|---|---|
| ☐ | ☐ |

*(Nëse po, specifikoni llojin e ekspertizës që kërkoni)*

___________________________________________________________________________

___________________________________________________________________________

**6. Kërkesë për përjashtim të zyrtarëve që do të merren me shqyrtimin e ankesës:**

___________________________________________________________________________

___________________________________________________________________________

7. **Lista e informacionit konfidencial**:

___________________________________________________________________________

___________________________________________________________________________

*Përcaktoni se cili informacion është konfidencial, nëse ka. Shpjegoni pse informacioni është ose një version i dokumenteve përkatëse me heqjen e pjesëve konfidenciale dhe një përmbledhje të përmbajtjes.*

***Kujdes :Ankimuesi duhet t'i bashkëlidhë ankimit, që do të paraqesë në autoritetin/ entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik, dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën pranë Komisionit të Prokurimit Publik***

Dërgojeni formularin e plotësuar të ankesës së prokurimit, të gjitha shtojcat e nevojshme dhe kopjet shtesë, pranë **Autoritetit /Enti Kontraktor dhe Komisionit te Prokurimit Publik.**

Shënim: Ankimuesi duhet ta dërgojë njëkohësisht ankesën në autoritetin/ entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit publik

**Nr. i faksit:**

**E-mail:**

**Nënshkrimi dhe vula e Ankuesit**

**Administratori/ Përfaqësuesi i autorizuar**

**Shtojca 23:**

**FORMULARI I PARAQITJES SË ARGUMENTAVE NGA OPERATORËT EKONOMIKË TE INTERESUAR PRANË AUTORITETIT/ENTIT KONTRAKTOR DHE KOMISIONIT TË PROKURIMIT PUBLIK**

**Paraqitja e argumenteve nga operatorët ekonomikë të interesuar drejtuar**:

Autoriteti/Entit Kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik ☐

**Seksioni I. Identifikimi i Operatorit/ëve Ekonomikë/Bashkimit të operatorëve ekonomikë**

Emri i plotë i Operatorit Ekonomik/Operatorëve Ekonomikë (ju lutem shtypeni)
Nuis/Nipt

Adresa

Qyteti    Shteti    Kodi Postar / Posta

Numri i telefonit (përfshirë kodin e zonës)    Numri i faksit (përfshirë kodin e zonës)

E-mail

Emri dhe titulli i zyrtarit të autorizuar për dërgimin e këtyre kundërshtimeve (ju lutemi shkruani)

Nënshkrimi i zyrtarit të autorizuar    Data (viti/muaji/dita)

Numri i telefonit (përfshirë kodin e zonës)    Numri i faksit (përfshirë kodin e zonës)

**Seksioni II. Informacion mbi procedurën**

1. Numri i referencës së procedurës/Lotit

*Plotësoni numrin e referencës se kontratës në njoftimin e kontratës ose në dokumentet e tenderit.*

**2. Lloji i Procedurës**

Procedurë e hapur ☐

Procedurë e hapur e thjeshtuar ☐

Procedurë e kufizuar ☐

Procedurë konkurruese me negocim ☐

Partneritet për inovacion ☐

Dialog konkurrues ☐

Procedurë me negocim me shpallje paraprake të njoftimit ☐

Procedurë me negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës ☐

Shërbim Konsulence ☐

3. Autoriteti /Enti Kontraktor
*Emri i autoritetit/entit kontraktor që administron procesin e prokurimit.*

______________________________________________________________________

4. Vlera e përllogaritur e prokurimit

______________________________________________________________________

*Vlera e përllogaritur e kontratës/* Marrëveshjes Kuadër *(shuma në shifra dhe fjalë)*

5. Objekti i kontratës/Marrëveshjes Kuadër

______________________________________________________________________

*Përshkrimi i shkurtër i punëve / mallrave / shërbimeve objekt kontrate/marreveshje kuader.*

6. Afati i fundit për paraqitjen e ofertës

______________________________________________________________________

Data (viti/muaji/dita)

7. Ankesa që po shqyrtohet:
(*emri i Operatorit ekonomik që ka paraqitur ankesë për këtë procedurë prokurimi*)

__________________________________________

8. Data e Publikimit të Njoftimit të Fituesit

______________________________________________________________________

Data (viti/muaji/dita)

**Seksioni III. Argumentet mbi ankesën e paraqitur nga Operatori/ët ekonomikë**

1. Baza ligjore

(Shkelje/arsyetime ligjore, bazuar në vendime, akte, dokumente, etj.)

---

2. Deklaratë e hollësishme e argumenteve mbi ankesën e paraqitur

*Jepni një deklaratë të hollësishme të fakteve dhe argumenteve që mbështesin argumentimet tuaja. Për çfarëdo arsye, specifikoni datën në të cilën u vutë në dijeni për faktet e lidhura me arsyet e këtyre argumenteve. Përmendni seksionet përkatëse të Dokumenteve të Tenderit, nëse është e zbatueshme. Përdorni faqe shtesë nëse është e nevojshme.*

3. Lista e informacionit konfidencial

*Përcaktoni se cili informacion është konfidencial, nëse ka. Shpjegoni pse informacioni është ose një version i dokumenteve përkatëse me heqjen e pjesëve konfidenciale dhe një përmbledhje të përmbajtjes.*

---

Dërgojeni formularin e plotësuar të argumentimeve tuaja, si dhe të gjitha shtojcat e nevojshme dhe kopjet shtesë, pranë **Autoritetit /Enti Kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik**

**Shënim: Nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur argumentat e tyre që kundërshtojnë ankesën, sipas parashikimeve të LPP, nuk mund të ushtrojnë më pas të drejtën e ankimit për vendimin e dhënë lidhur me ankesën për këtë procedurë prokurimi.**

**Nr. i faksit:**

**E-mail:**
**Nënshkrimi dhe vula e Operatorit /eve Ekonomikë**

**Shtojca 24**

*(Shtojcë për tu plotësuar nga autoriteti/enti kontraktor)*

## Formulari i Njoftimit të Kontratës së Nënshkruar

**Seksioni 1 Autoriteti/Enti Kontraktor**

### 1.1 Emri dhe adresa e Autoritetit /Entit Kontraktor

Emri ______________________________________________

Adresa ______________________________________________

Tel/Faks ____________________________________________

E-mail ____________________________________________

Ueb-faqe ____________________________________________

**I.2 Lloji i Autoritetit/Entit Kontraktor:**

| Institucion qendror | Institucion i pavarur |
|---|---|
| ☐ | ☐ |
| Njësia e Qeverisjes Vendore | Të tjera |
| ☐ | ☐ |

1.3 **Kategoria e Autoritetit/Entit Kontraktor:**

| Autoritet/ent kontraktor që prokuron për nevoja të veta | Organ Qendror blerës |
|---|---|
| ☐ | ☐ |
| I deleguar | Të tjera |
| ☐ | ☐ |

**<u>Seksioni 2. Objekti i Kontratës</u>**

**2.1 Numri i referencës së procedurës / Lotit**

____________________________________________

**2.2 Lloji i "Kontratave Publike për Shërbime"**

**2. Kontratë në bazë të Marrëveshjes Kuadër**

Po ☐ Jo ☐

**Nëse Po, lloji i Marrëveshjes Kuadër**

**Me një Operator Ekonomik** ☐

**Me disa operatorë ekonomik** ☐

**Të gjitha kushtet janë të vendosura** Po ☐ Jo ☐

**2.4 Përshkrimi i shkurtër i kontratës**

2. Fondi limit_______________________________________________________________________
3. Burimi i financimit
   ______________________________________________________________________
4. Objekti i Kontratës ___________________________________________________

**2.5 Kohëzgjatja e Kontratës ose afati i përfundimit:**

Kohëzgjatja në **muaj** □□□ **ose ditë** □□□□

ose

Duke nisur □□/□□/□□□□ dhe përfunduar në □□/□□/□□□□

**2.6 Ndarja në LOTE:**

Po □ Jo □

*Nëse po,* numri i LOTEVE**:** □□

**2.7 Kontrata me nënkontraktim:**

Po □ Jo □

**Seksioni 3. <u>Procedura</u>**

**3.1 Lloji i procedurës: E kufizuar**

**3.2 Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:**

**A) oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto** □

Sipas rëndësisë: Çmimi □□ **pikët** □

etj. □□ **pikë**

*ose*

**B) oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim** □

**3.3 Numri i ofertave të paraqitura:** □□□

**Numri i ofertave të rregullta:** □□□

**3.4. Gjatë procesit të prokurimit në fushën e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK) janë përdorur standardet e përgatitura nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit:**

Po □ Jo □

**3.5. Gjatë procesit të prokurimit në fushën e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK), kur standardet nuk janë të zbatueshme, aprovimi paraprak merret nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit.**

Po □ Jo □

**Seksioni 4 <u>Informacion rreth Kontratës</u>**

**4.1 Numri i kontratës: ___________________________________ Data e kontratës** □□/□□/□□□□

**4.2 Emri dhe adresa e Kontraktorit**

Emri ___________________________________________________________________

Adresa ___________________________________________________________________

Nipti ___________________________________________________________________

Tel/Faks

E-mail ___________________________________________________________________

Ueb-faqe ___________________________________________________________________

4.2.1 **Emri dhe adresa e nënkontraktorit**

Emri ___________________________________________________________________

Adresa ___________________________________________________________________

Nipti ___________________________________________________________________

Tel/Faks

E-mail ___________________________________________________________________

Ueb-faqe ___________________________________________________________________

**4.3 Vlera totale përfundimtare e Kontratës** *(përfshirë shumë, opsione dhe nënkontraktime):*

Vlera ________________ Monedha ______________________________________
*(pa TVSH)*

Vlera ________________ Monedha ______________________________________
*(me TVSH)*

**4.3.1** Vlera totale e **nënkontraktimit:** ____

Vlera ________________ Monedha ______________________________________
*(pa TVSH)*

Vlera ________________ Monedha ______________________________________
*(me TVSH)*

**4.4 Informacion Shtesë**

______________________________________________________________________________
______________________________________________________________________________
______

Data e dorëzimit të këtij njoftimi □□/□□/□□□□

**Shtojca 25**

*[ Shtojcë për tu plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor për publikim në Buletinin e Njoftimeve Publike]*

# Formulari i Njoftimit të Kontratës së Nënshkruar

**1. Emri dhe adresa e Autoritetit /Enti Kontraktor**

Emri ______________________________________________

Adresa ______________________________________________

Tel/Faks ______________________________________________

E-mail ______________________________________________

Ueb-faqe ______________________________________________

**2. Lloji i procedurës: ______________________________________________**

**3. Objekti i kontratës ______________________________**

**4. Numri i referencës së procedurës / Lotit ______________________________**

**5. Fondi Limit**

______________________________________________

**6. Vlera totale përfundimtare e kontratës (***përfshirë Lotet, opsionet dhe nënkontraktimin)*:

Vlera ______________ *(me TVSH)* Monedha ______________________

Vlera e nënkontraktimit ______________ *me TVSH* Monedha ______________________

**7. Data e nënshkrimit të kontratës**

______________________________________________

**8. Emri dhe adresa e Kontraktorit / nënkontraktorit**

Emri

______________________________________________

Adresa

______________________________________________

Numri i NIPT-it

______________________________________________

(*Shtojce  për tu plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor*)

**Shtojca 26**

# Formulari i Njoftimit të Anulimit

**1. Emri dhe adresa e Autoritetit/Entit Kontraktor**

Emri ___________________

Adresa ___________________

Tel/Faks ___________________

E-mail ___________________

Ueb-faqe________________________________

**2. Lloji i procedurës: _____________________**

**3. Numri i Referencës se procedurës/lotit:__________**

**4. Objekti i Kontratës ____________________________**

**5. Fondi Limit____________________________________________________________________**

**6. Arsyet e Anulimit:**

Bazuar në Ligjin Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", Neni 98, pika 1:

**a)**
**b)**
**c)**
**ç)**
**d)**
**Etj. __________________________________________**

**7. Informacion shtesë**

________________________________________________________________________________________

________________________________________________________________________________

Data e dorëzimit të këtij njoftimi